

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

VESHJET TRADICIONALE NË TREVAT SHQIPTARE

(Konferencë shkencore – 04.05.2020)

29



Shkup, 2020

Boton:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

Vëllimi 29 – 2020
Biblioteka: **SCUPI**

Për botuesin:
Dr. Skender Asani

Kryeredaktor:
Dr. Sefer Tahiri

Këshilli redaktues:
Dr. Izaim Murtezani
Dr. Sevdail Demiri
Mr. Rini Useini
Dr. Besnik Rameti
Mr. Isamet Bakiu

Sekretar i redaksisë:
Dr. Murtezan Idrizi

Redaktor teknik:
Naser Fera

Copyright©ITSHKSH, 2020
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

ISBN: 978–608–4897–25–5
www.itsh.edu.mk

Ky botim financohet nga:

Република Северна Македонија
Министерство за култура



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Kulturës

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

VESHJET TRADICIONALE NË TREVAT SHQIPTARE

(Konferencë shkencore – 04.05.2020)

29

SCUPI

Shkup, 2020

PËRMBAJTJA:

PARATHËNIE	7
Rini USEINI: VESHJET TRADICIONALE SHQIPTARE NË MAQEDONINË E VERIUT – VËSHTRIM ETNOLOGJIK	17
Nexhat ÇOÇAJ: FUNKSIONI INFORMATIV I VESHJEVE TRADICIONALE TË HASIT	30
Besnik RAMETI: VESHJET TRADICIONALE NË DERVERN TË SHKUPIT	49
Idaete SINANI: VESHJET TRADICIONALE TË GRAVE NË FSHATIN KRUSHOPEK TË SHKUPIT	63
Afed JASHARI: VENDBANIMET E KARSHIAKËS QË KANË RUAJTUR VESHJET POPULLORE.....	74
Minir ADEMI: VESHJA POPULLORE SHQIPTARE NË TREVËN E KARADAKUT TË KUMANOVËS.....	81
Gureta BAJRAMI BREZNICA: VESHJA – SI KULTURË MATERIALE DHE SHPIRTËRORE, TREGUES I MËNYRËS SË JETESËS SË SHQIPTARËVE NË RAJONIN E KUMANOVËS NË SHEK. XX	92
Angjelina HAMZA / Vlorë FETAJ-BERISHA: VESHJA TRADICIONALE NË RRAFSH TË DUKAGJINIT– KOSOVË ...	109
Hiriet ZIBERI: PËRPUNIMI I VESHJEVE TË GRAVE NË MALIN E THATË	147
Xhemaledin SALIHU: VESHJA E BURRAVE NË PRESHEVË	156
Bekim RAMADANI: QERIM ETEMI, MJESHTËR I PRODHIMIT TË VESHJEVE TRADICIONALE	166
Sali ISLAMI / Bunjamin XHEMAILI: VESHJE ILIRE NË DISA GJETJE ARKEOLOGJIKE PARA PUSHTIMIT ROMAK	181

PARATHËNIE

GJUHA E VESHJEVE POPULLORE

Veshjet popullore paraqesin një kod të rëndësishëm të qenies sonë kombëtare dhe njëherit një dëshmi të fuqishme të lashtësisë sonë. Ato me të gjitha vlerat që i posedojnë në përmbajtjen e tyre, jo vetëm që e begatojnë fondin e kulturës popullore, por njëherit e bëjnë atë edhe më të veçantë për shkak të larmisë së strukturës morfologjike, karakterit të elementeve të zbukurimit e kështu me radhë. Sfondi i dekoruar i veshjeve tona popullore nxjerr në sipërfaqe shijen e stërholluar të gjeniut tonë popullor i cili gjatë tërë historisë së tij asnjëherë nuk e topiti ndjenjën e kreativitetit, por në vazhdimësi krijoi vepra me cilësi të përkryera artistike. Këto artefakte popullore duke u shquar sidomos në rrafshin estetik, jorastësisht kishin mahnitur shumë studiues të huaj të cilët nuk do të ngurronin t'i paraqitnin edhe impresionet e tyre. Njëri prej tyre, përkatësisht studiuesi Cyprien Robert në vitin 1844 theksonte se veshja shqiptare është aq shumë e shkëlqyeshme, sa mund të quhet proverbiale. Të përkujtojmë edhe Bajronin e famshëm i cili gjatë vizitës së tij në pjesën jugore të Shqipërisë, e më saktësisht në Janinë në vitin 1808, mori si kujtim nga ato vise një kostum tradicional shqiptar. Do të ishte bukuria e këtij kostumi që në vitin 1813 do ta motivonte piktorin Tomas Filips që të realizonte portretin e famshëm të lordit Bajron veshur me kostumin popullor shqiptar.

Fatkeqësisht, edhe pse nga kjo kohë e sipërpërmendur kanë kaluar shumë vite, kultura popullore për shkak të rrethanave specifike

nëpër të cilat ka kaluar qenia jonë kombëtare, edhe më tej nuk është eksploruar dhe studiuar sa duhet, sidomos në trojet shqiptare jashta shtetit amë. Në këtë konteskt, edhe shqiptarët e Maqedonisë së Veriut për shkak të neglizhencës së institucioneve gjegjëse, edhe më tej nuk kanë arritur t'i grumbullojnë dhe konservojnë disa artefakte popullore të cilat kohëve të fundit vazhdimisht atakohen nga përbindëshi i globalizmit dhe një ditë, ndoshta edhe njëherë e përgjithmonë mund të zhduken nga faqja e dheut. Në datën 4 maj të vitit 2020 në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, u mbajt konferenca shkencore me temë "Veshjet tradicionale në trevat shqiptare", e mbajtur në kuadër të Javës së trashëgimisë kulturore të shqiptarëve. Nga e njëjtë konferencë botohet revista periodike "Scupi", e cila përmbledhi punimet e disa studiuesve nga hapësira gjeografike/etnike shqiptare. "Scupi" është pikërisht në funksion të këtij misioni, pra në funksion të shpëtimit të këtyre artefakteve popullore nga dhëmbi i kohës. Vlera e tij qëndron në faktin se ai ka arritur t'i sintetizoj këto artefakte në një vend dhe si të tilla të jenë në funksione reprezentative në suaza të një pjese të kulturës sonë popullore. Këta margaritarë etnografikë që u kanë përballuar shekujve dhe trysnive të ndryshme, janë dëshmia më e mirë e fuqisë krijuese të popullit tonë i cili asnjëherë nuk u zbraps në rrugën e tij drejt ruajtjes së substancës së tij kombëtare.

Nëse e shfletojmë brendinë e revistës "SCUPI" mbetemi të mahnitur nga morfologjia, ngjyrat, vezullimi i koloritit të nduarduarshëm, apo me një fjalë nga gjenialiteti i artistit popullor i cili tërë mjeshtërinë e tij e ka shkrirë në sfondin e këtyre artefakteve popullore. Në këtë drejtim, nuk ka sesi të mos magjepsesh dhe të mbetesh indiferent nga laryshia e motiveve dhe finesat elegante të

veshjeve popullore të Malësisë së Tetovës, fshatrat e Karshiakës dhe rajonit të Dërvenit të Shkupit, fshati Krushopek i Shkupit, veshjet tradicionale në rajonin e Kumanovës, në rajonet e Hasit dhe Dukagjinit të Kosovës, si dhe shumë zonave të tjera që dallohen me veçori të caktuara, por të cilat pastaj shkrihen në detin e madh të unitetit kombëtar kulturor. Të gjithë këto fshatra e rajone kanë ruajtur me xhelozinë më të madhe tiparet e një veshjeje të mirëfilltë autentike dhe me siguri me një zanafillë shumë të lashtë autoktone. Ndoshta kjo i destinohet edhe faktit se zonat e lartëpërmendura, sidomos disa fshatra duke qenë larg qendrave urbane e ruajtën me fanatizëm këtë pjesë të kulturës popullore, madje edhe në ditët e sotme. Edhe përkundër faktit se edhe këto zona u prekën nga ndikimi oriental i kostumeve popullore, megjithatë ky ndikim është shumë i vogël karshi elementeve origjinale dhe kombëtare që u ruajtën dhe u bartën gjeneratë pas gjenerate. Kjo veshje spikat me një morfologji të begatshme dhe me një shumësi zbukurimesh me vlera të nduarduarshme. Të kësaj natyre janë, sidomos veshjet e grave nga të cilat dallohen këmisha, brezi, poshi, anteria, terliku, bofçarka, çorapët, çulkat, mbulesat e kokës e kështu me radhë. Në kuadër të veshjeve të grave, dallohet sidomos veshja e nuseve të reja. Kjo veshje është njaft mbresëlënëse, madje edhe magjepëse pasi të përvetëson menjëherë nëpërmjet koloritit dhe kontrastit të harmonizuar të ngjyrave të çelura të cilat shkrihen në një tërësi unike kompozicionale. Kjo veshje, nëse i referohemi edhe logjikës tradicionale, veç tjerash, ngërthente në vetvete edhe funksionin magjik, pasi nëpërmjet koloritit të ngjyrave duhej të ndjellte pjellorinë, por njëherit edhe ta mbronte frytin e ri nga sylligët.

Në vija të përgjithshme, veshjet popullore, qofshin të botës mashkullore, ose femërore, ushtronin dy funksione kryesore.

Funksioni i parë ishte i natyrës pragmatike dhe ndërlidhej me mbrojtjen e organizmit nga ndikimet e jashtme atmosferike, kurse funksioni i dytë i tyre ndërlidhej me natyrën estetike e cila manifestohej në formë të motiveve të ndryshme që dekoronin sfondin e tyre përmbajtësor. Nga motivet e larmishme që ishin pjesë përbërëse e dekoracionit të tyre, dallohen motivet gjeometrike, kozmike, zoomorfe, fitomorfe, antropomorfe e kështu me radhë.

Motivet gjeometrike shkriheshin në përmbajtjen e tyre në trajtë të vijave të drejta (horizontale e vertikale), vijave zigzake, spiraleve e rombeve të kombinuara. Këto figura, në shumicën e rasteve, ishin dekor i pashmangshëm i këmishëve, shputave të çorapëve, pështjellakut si dhe pjesëve tjera të veshjeve. Këto motive që përfitohen me anë të vijave të ndryshme gjeometrike, konsiderohen ndër elementet më të thjeshta dekorative dhe shpiejnë gjer në artin primitiv. Një ndër figurat gjeometrike më me frekuencë ishte vija e drejtë, apo horizontale që identifikohet me këtë botë, por edhe vija vertikale e cila identifikohet edhe me këtë botë, por edhe me botën tjetër (botën nëntokësore dhe qiellore). Një figurë tjetër e rëndësishme ishte edhe trekëndëshi i cili po ashtu zbukuronte llojet e ndryshme të veshjeve, si pështjellakët, jakët dhe mëngët e këmishëve etj. Po ashtu edhe figurat gjeometrike në trajtë të rombeve, të vendosura në vija horizontale, por edhe në ato vertikale, paraqiten si element dekor, sidomos në pështjellakët e nuses. Edhe rombet simbolizojnë plleshmërinë e femrës, apo identifikohen me vulvën. Vijat zikzake, po ashtu paraqesin dekor të përhershëm të pështjellakëve dhe në të kaluarën e largët i kanë shërbyer njeriut për të paraqitur figurën e gjarprit. Studiuesit e ndryshëm kanë arritur në përfundim se një nga vatrast ku ky kult ka pasur në lashtësi një përhapje, apo një peshë të veçantë kanë qenë

trojet e ilirëve. Për më tepër, për këtë kult ka pasur vazhdimësi dhe te arbërit e Mesjetës e deri te shqiptarët. Shikuar në përgjithësi, motivet gjeometrike krijojnë tablo të bukura "duke gjarpëruar me finesë dhe elegancë mbi sipërfaqet e dekoruara. Kompozimi i tyre nuk e rëndon zbukurimin dhe pse është i dendur për sipërfaqe të vogla". Edhe motivet kozmike janë pjesë përbërse e rrafshit përmbajtësor të veshjeve popullore. Këto motive i hasim të personifikuara me diellin, hënën dhe yllin. Motivin e diellit e hasim në trajtë të rrathëve koncentrikë, rrethit ose në trajtë disku. Të gjitha këto figura si paraqitje të diellit, po ashtu janë të njohura në kulturën ilire. Për këtë dëshmojnë shkrimet e ndryshme dhe disa gjetje arkeologjike në nekropole e vendbanime të viseve jugore ilire e deri në viset e Alpeve lindore. Ky kult u bart edhe te shqiptarët të cilët diellin e konsideronin po ashtu me elemente të një hyjnie të mirëfilltë. Pra, të gjitha këto trajta të diellit që i përshkruam më lartë, sipas besimit tradicional, kishin për qëllim që t'i mbronin bartësit e tyre nga e liga, sëmundjet e ndryshme, syri i lig, etj. Edhe hëna apo më mirë thënë gjysmëhëna është pjesë përbërëse e dekoracionit të veshjeve. Ajo në cilësinë e një trupi të rëndësishëm kozmik, "paraqet fuqinë e gruas, hyjneshën nënë, mbretëreshën e qiellit. Ajo paraqet edhe simbol të ritmit të kohës ciklike. Fazat e lindjes, vdekjes dhe ringjalljes së hënës simbolizojnë pavdekësinë dhe amshimin, apo mëkëmbjen e përhershme (Kuper, 1986: 104). Ndërkaq, hëna e plotë e ndan simbolikën me rrethin dhe paraqet shenjë të tërësisë dhe të përkryerës. Po ashtu edhe yllin, ndonjëherë pesëcepësh e ndonjëherë gjashtëcepësh e hasim si motiv në veshjet popullore. Ylli paraqet dominim, amshim, pavdekshmëri, përkatësisht të arriturën më të lartë. Yjet janë attribute të të gjitha mbretëreshave qiellore. Ylli pesëcepësh paraqet simbol të mikrokozmosit njerëzor, kurse ylli gjashtëcepësh simbolizon

shpirtin dhe materien, parimin pasiv dhe aktiv, ritmin e dinamikës së tyre, etj (Chevalier: Gheerbrant, 1983: 813).

Në veshjet e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut dhe trevave shqiptare hasim motive me prapavija të nduarduarshme që mëtojnë të përfshijnë në sfondin e tyre mbarë kozmosin me të gjitha veçoritë e tij. Në këtë kontekst një vend të merituar zë edhe bota zoomorfe. Në këtë rrafsh, shqiponja si simbol kombëtar, por edhe si figurë mitologjike, zë një vend parësor. Ajo në cilësinë e motivit paraqitet e qëndisur në pështjellak, jelek e kështu me radhë. “Shqiponja ka përfutur tiparet e kultit të popullit ynë. Si motiv zbukurues është përdorur gjerësisht në artin tonë popullor. Proceset historike shoqërore të kombësisë sonë në shek. XV i dhanë përmbajtje të re dhe forma stilistike të reja simbolit të shqiponjës dykrenore. Ne sot kënaqemi shpirtërisht me larmitë pambarim të motivit të shqiponjës që e hasim në të gjithë mjeshtritë e artit të zbatuar popullor dhe çka është më e rëndësishme, ne e dallojmë atë nga stilizimet e përdorura ndër popuj të tjerë. Marrëdhëniet artistike të këtij motivi me të tjerët në artin tonë popullor janë të dallueshme (Bido, 1991: 67–68). Në artin e veshjeve popullore, një vend të konsiderueshëm zënë edhe motivet fitomorfe. Në këtë kontekst, dallohet ndonjë pemë e cila në kuadër të besimit tradicional është e ndërlidhur me paraqitjen e kozmosit në përgjithësi. Në përputhje me një besim të tillë, pema, përkatësisht rrënjët e saj kanë simbolizuar botën nëntokësore, kërcelli është ndërlidhur me këtë botë, kurse degët e saj me botën qiellore.

Veshjet popullore përveç me morfologjinë e pasur e të nduarduarshme me të cilën paraqiten, dallohen edhe me semantikën e simbolikës së tyre, sidomos në aspekt të përdorimit të ngjyrave në sipërfaqen e tyre. Duhet theksuar që në fillim se sistemi njëngjyrësh

i veshjeve, ndoshta është më i lashti, pasi sa më shumë të kthehesh në të kaluarën aq më shumë përballesh me shembuj të kësaj natyre, përkatësisht të ekzemplarëve me një ose dy ngjyra. “Nga pikëpamja historike e dokumentare, sistemi tradicional njëngjyror rezultoi i përdorur edhe në veshje të banorëve të hershëm të trojeve të sotme shqiptare. Studimet etnologjike kanë arritur në përfundime se shumë pjesë të veshjeve të sotme popullore shqiptare e kanë origjinën, pra vijnë si rudimente nga kulturat parailire, ilire, bizantine e arbërore dhe, në këtë kontekst, ato kanë bartur edhe ngjyrësinë e tyre. Është e njohur tashmë në literaturën ballkanike e mesdhetare se veshja e ilirëve është dalluar për këmishën e gjatë të quajtur dalmatika, e cila kishte ngjyrën e bardhë natyrore të lirit ose të leshit” (Bido, 1997: 36). Edhe tirqit, por edhe këmishët tradicionale të veshjeve në Maqedoni kanë ngjyrë të bardhë. Kjo ngjyrë paraqet të përkryerën transcendentë; të rëndomtën; dritën; diellin; ajrin; dliresinë, të shenjtën; autoritetin shpirtëror. Pëlhura e bardhë asocon në pastërti, ose triumf të shpirtit. E bardha është e ndërlidhur si me jetën, po ashtu edhe me dashurinë, por edhe me vdekjen dhe varrimin. Gjatë kurorëzimit të çifteve bashkëshortore, simbolizon vdekjen e jetës së vjetër dhe lindjen e jetës së re, kurse në vdekje paraqet lindje të re, në jetën e përtëjvarrit (sipas Kuper, 1986: 16). Kjo ngjyrë preferohej për djemtë dhe vajzat e reja, por e bardha kombinohej edhe me të zezën. Këto ngjyra karakterizonin edhe veshjet e grave të moshuara.

Ndërkaq, veshjet më të preferuara, sidomos për nuse të reja gjatë ndonjë solemniteti festiv, por edhe gjatë përditshmërisë ishin ato me ngjyrë të kuqe. Ngjyra e kuqe është një ndër më të rëndësishmet në besimet e të gjithë popujve të botës. Kjo veti e saj del nga fakti se ngjyra e kuqe është e njëjtë me ngjyrën e gjakut,

pastaj me lindjen dhe perëndimin e diellit. Ajo gjithashtu krahasohet me zjarrin dhe paraqet njëkohësisht parimin mashkullor dhe atë femëror – duke u ndërlidhur me zjarrin, gjakun dhe vulvën.

Ngjyra e zezë si antipod i së bardhës ishte sinonim e veshjeve për personat më të moshuar. Ajo paraqet personifikim të kaosit, vdekjes, përvuajtjes, natës e kështu me radhë.

Nga e gjithë kjo mund të përfundojmë se veshjet shqiptare në Maqedoninë e Veriut i përkasin të ashtuquajturit “tip të gunës” duke u shkrië në një njësi me variacionet e veshjeve të tjera të viseve shqiptare, përveç veshjeve popullore të Malësisë së Madhe, Dukagjinit, Nikaj e Mërturit, Shllakut e Temalit, Berishës etj., ku dominon i ashtuquajturi tip i xhubletës. Pra, tipi i gunës dhe ai i xhubletës përfaqësojnë rreth tyre të gjitha veshjet e përcaktuara si veshje autoktone në përdorim të popullit shqiptar. Çdo veshje popullore në viset shqiptare, ndërlidhet sipas kësaj ose asaj forme me njërin nga këto dy tipa. Por si veshjet e njërit tip, ashtu ato të tipit tjetër, nuk mund të mendohen si veshje identike, pa asnjë ndryshim midis tyre. Veshjet e secilit tip kanë veçoritë e veta. Këto ndryshime të lehta që vihen re brenda çdo tipi, përftojnë larminë e madhe të veshjeve popullore, të cilat, megjithëse ruajnë vija të përbashkëta, kanë veçori dhe tipare të veçanta lokale apo krahinore. Po t'i marrim në shqyrtim ndryshimet e veçanta brenda një tipi, shohim se kemi dy kategori: së pari, ndryshime që nuk e prekin formën ose vijën e përgjithshme të strukturës morfologjike të tipit, të cilat përftojnë “variantet” e tij dhe së dyti, ndryshime që transformojnë strukturën morfologjike, të cilat quhen “derivate” të atij tipit” (Zojzi, 1978: 252).

Në trajtë të epilogut mund të themi se veshjet shqiptare në Maqedoninë e Veriut ruajnë një varg karakteristikash origjinale të

cilat vijnë e shkrihen në detin e madh të pjesës tjetër të njësisë kombëtare, përkatësisht të veshjeve popullore të shqiptarëve në përgjithësi, kudo që jetojnë. Veshjet e tilla në rrafshin historik ruajnë veçori autentike të trashëguara nga një nënshtresë kulturore të fiseve ilire që kanë jetuar në trojet e sotme të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut duke përfutur në këtë mënyrë vlera të veçanta nga ato të popujve të tjerë. Pra, veshjet popullore shqiptare edhe pse dallohen me specifikat e tyre, si reportori i motiveve zbukuruese në veshje që ndërlidhet me besime të stërlashta të paraardhësve tanë, megjithatë në disa cilësi nuk mund edhe të mos përputhen edhe me veshjet e popujve të tjerë të këtij rajoni duke u integruar në njësinë ballkanike si zonë më e gjerë e ndikimeve të ndërsjella.

Veshja popullore është e ndërlidhur drejtpërdrejt me shkallën e zhvillimit historik, ekonominë, strukturën e marrëdhënieve shoqërore dhe veçoritë e mjedisit natyror dhe gjeografik. Nga ana tjetër, veshja popullore si pjesë e rëndësishme e kulturës sonë materiale, konfirmon më së miri aftësinë dhe pjekurinë krijuese të popullit shqiptar duke ndikuar dukshëm nëpër shekuj në formësimin dhe profilizimin e identitetit kombëtar. Dihet se rruga e kulturës sonë popullore është e gjatë dhe ajo ka arritur të mbijetojë edhe përkundër trysnive të ndryshme dhe robërisë së gjatë shekullore. Ndoshta, dhuntia kreative e gjeniut popullor që shpërthente veteveti dhe merrte trajtë estetike në petkun kombëtar ishte e vetnja forcë që shkëlqente nëpër shekujt e errët të robërimit dhe njëherit u bënte ballë tendencave të zhbërjes së qenies kombëtare. Në një vend, filozofi i njohur gjerman Martin Hajdeger thotë se shtëpia e qenies është gjuha. Ne do të kishim shtuar se një dhomë e madhe e kësaj shtëpie të qenies kombëtare, me siguri se

është e rezervuar për veshjen popullore, pasi ajo më së miri bën identifikimin e identitetit të qenësisë kolektive. Pra, veshja popullore si e tillë merr edhe tipare semiotike, përkatësisht të shenjës dhe shërben, mes tjerash, edhe si përcaktuese shumë e fuqishme e etnicitetit.

Redaksia e revistës "SCUPI"



Koordinatori Sefer Tahiri dhe drejtori i Institutit, Skender Asani në hapje të konferencës. Një pjesë e madhe e pjesëmarrësve të konferencës, referimet e tyre irealizuan në formatin online

RINI USEINI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të
Shqiptarëve—Shkup*

VESHJET TRADICIONALE SHQIPTARE NË MAQEDONINË E VERIUT – VËSHTRIM ETNOLOGJIK

Kostumet popullore të shqiptarëve në Maqedoni kanë një traditë shekullore. Ata janë pjesë e kulturës materiale të popullit shqiptar dhe përfaqësojnë një degë të rëndësishme të artit popullor. Krijuar si një përfitim kolektiv i të gjithë njerëzve, ata u transmetuan nga brezi në brez në periudhë të gjatë kohore. Në zhvillimin e tyre, në to janë të integruara elemente karakteristike të kulturës tradicionale shqiptare, pjesërisht të formuar dhe nën ndikimin e kulturave të tjera që lulëzuan në këtë pjesë të Ballkanit, në periudhë të gjatë kohore. Nga analiza e elementeve të veshjes, stolitë dhe terminologjia e tyre mund të shohim ndikimet e shtresës më të vjetër kulturore ballkanike dhe më vonë ajo helene, me të cilën lidhet edhe kultura e Ilirëve të vjetër.¹

Në formimin e kostumeve tradicionale, shtohen ndikimet e caktuara të kulturës bizantine, si dhe fluksi i fortë i elementeve turko-orientale, dhe rrjedhat e fundit nga Perëndimi. Në procesin e gjatë të formimit të kostumeve popullore shqiptare në Maqedonin; e Veriut, marrin pjesë të gjithë shqiptarët – krijues dhe formësues të kostumeve popullore. Gjatë formimit të tyre

¹ Bihiku, Ikbal, Për një shfrytëzim më të drejtë të motiveve tona popullore në tekstilet e artizanatit, *Etnografia shqiptare, IV*, Tiranë, 1978, f. 77

ndodhën ngjarje të ndryshme historike, sociale, ekonomike dhe kulturore. Kështu, u krijuan kostumet popullore të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, si shprehje e vlerave kolektive, estetike dhe shpirtërore.

Veshjet tradicionale janë elementi thelbësor i komunikimit të njeriut me një botë materiale të theksuar, sepse nëpërmjet tyre njerëzit kanë mundur të dallojnë nga larg përkatësinë sociale, statusore, moshën, etninë, krahinën, etj, sepse kontrolli shoqëror ka qenë shumë i ashpër me normat se si duhet të duket veshja për moshat, gjendjen civile, ekonomike etj. Tipet kryesore janë klasifikuar nga një studiuese – specialiste e veshjeve, Dr. Andromaqi Gjergji dhe si tipe më gjithpërfshirëse ka arritur ta dallojë fustanellën te meshkujt, që është mbajtur në gjithë zonat shqiptare, deri në fund të shekullit XVIII kurse tipi më i vjetër te gratë merret xhubleta e cila krahasohet dhe me dalmatikën ilire.

Përveç situatave historiko – politike dhe shpirtit krijues të popullit në formimin dhe krijimin e veshjeve popullore, rëndësi të madhe kanë edhe kushtet natyrore – gjeografike. Masivet e larta malore, shkrepat e thekura dhe luginat e pjerrëta, me të cilat veçohet relievi i rajeve shqiptare kanë dhënë kushte të caktuara për ekonominë, të cilat nga ana tjetër manifestoheshin në kulturën tradicionale të banorëve të këtyre anëve. Me forma të veçanta specifike, si në kulturën materiale, ashtu dhe në atë shpirtërore, veçohet kultura e malësorëve, veprimtaria kryesore, e të cilëve ishte blegtoria. Kultura e tyre dhe qënësia në themel dallohet nga ajo e atyre nga vendet e rrafshëta, të cilat në mënyrë bazike janë të orientuara kah bujqësia. Në shumë segmente këto dy tipe ndërthuren, duke krijuar në këtë

mënyrë një specifike të veshjes, në të cilën janë të interpretuar elementet përbërës nga të dy krahinat e veçanta.²

Të gjithë këto përbërës, që kanë marrë pjesë në formësimin e veshjeve popullore në Maqedoni, kishin rol përcaktues në formësimin e shprehjes së përgjithëshme të veshjes nga ky rajon – si në estetikë, funksion dhe ornamentikën e tyre. Në formësimin e veçorive stilistike dhe dekorative rrjedhën e tyre e gjetën edhe kulturat, që u zhvilluan në këto hapësira dhe një mori e ndikimeve të tjera bashkëkohore. Me të gjithë pasurinë e tyre, e shprehur në numrin dhe llojllojshmërinë e veshjeve, mënyra e zbukurimit të tyre, në kompozimet ornamentale dhe kolorit, veshjet popullore vijnë deri te ne nga modelet, ende të ruajtura nga fundi i shekullit XIX dhe dekadat e para të shekullit XX.³

Veshja popullore, përveç funksionit të saj themelor që ta ruajë trupin e njeriut, në kushte të ndryshme klimatike, ka dhe funksion të theksuar dekorativ dhe ritual. Përkrah funksioneve të caktuara magjiko – rituale, ajo është klasifikues që e përcakton gjendjen e individit në kuadër të bashkësisë së caktuar, sikurse dhe territorin, por dhe përkatësinë etnike dhe fetare.

Dallimi në mes Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Shqipërisë është në përdorimin e përbërësve të veshjeve dhe qëndron në përdorimin e mjeteve të ndryshme që e ndërtojnë veshjen. Në Shqipëri dhe Kosovë zakonisht përdoren veshje me përmbajtje natyrore dhe kryesisht vijnë në shprehje veshjet e pëlhurës të punuar në avlëmend dhe pa zbukurime të tepruara dhe me

² Për më shumë: Osmani-Selimi, Edibe. *Veshja autoktone e femrave të Rekës së Epërme*. Tetovë, 2012.

³ Për më shumë: Halimi – Statovci, Drita. *Veshjet shqiptare të Kosovës*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2009.

dekorime të fabrikua. Kurse në zonat shqiptare në Maqedoninë e Veriut vijnë më shumë në shprehje njetet e shumta të materialeve të fabrikua, të cilat janë pjesë e dekorit, si rruazat, pullat, dhe shumë elemente të tjera që e mbulojnë të gjithë pjesën e vendeve të dukshme të trupit, si mëngorja, grykorja, pjesa e gjoksit etj. Kjo është kur flasim për veshjen e grave kurse te burrat veshja e tirqeve është me ndryshime në nuancat e përdorimit të gajtanit. Kurse te veshjet me fustanellë dallimi është në gjatësinë e fustanellës, varësisht prej zonës ku përdoret.

Në territorin e Maqedonisë së Veriut, tek shqiptarët haset një llojllojshmëri e madhe e veshjeve, të cilët kishin specifika dalluese lokale. Secili rajon apo njësi krahinore në Maqedoninë e Veriut ka veshjen e vet të veçantë, e cila dallohej nga veshja e rajonit fqinj, me karakteristikat e veta stilistike, funksionale dhe estetike. **Kushte për formimin e kaq llojeve të ndryshme të veshjeve në reliev të ndryshëm, në lugina më të mëdha apo më të vogla, sikurse dhe në izolim komunikativ dhe gjeografik në të kaluarën në rajonet e ndara dhe zhvillimi specifik i veçorive etnike i banorëve nga krahinat e ndryshme.** Në llojllojshmërinë e veshjeve kanë ndikuar dhe lëvizjet e ndryshme migruese të cilët zhvilloheshin në krahina të caktuara në territorin e gjithë Maqedonisë së Veriut, në të kaluarën e afërt dhe të largët. Sa këto lëvizje ndikojnë, duke marrë parasysh edhe situatat e ndryshme politike, shoqërore kanë qenë më intensive dhe më të fuqishme, kështu ndikonin edhe në shprehinë e përgjithëshme estetike dhe funksionale të veshjes.⁴

Pasuria e veshjeve popullore, ndryshimet në pjesët e veshjeve, sikurse dhe e gjithë veshëmbathja popullore, shprehen si në

⁴ Për më shumë: Useini, Rini. Veshjet popullore shqiptare në trevën e Strugës, ITSHKSH, Shkup, 2018.

kompozicionin stilistik të veshjeve, ashtu dhe në numrin dhe llojloshmërinë e veshjeve dhe zbukurimin e tyre. Në këtë kuptim, veçanërisht Maqedonia Perendimore dhe ajo e Mesme, përfaqësojnë një mozaikë të vërteta nga disa lloj veshjesh të rralla popullore, ndërmjet të cilave dallohet ajo e gruas. Sipas pasurisë dhe zbukurimit të veshjeve veçanërisht dallohen veshjet festive, rituale dhe ceremoniale, në të cilët më gjatë janë ruajtur format e vjetra tradicionale, kurse shpirti krijues i popullit ka arritur shprehje të lartë.

Kultura materiale, si pjesë e krijimtarisë popullore me kalimin e kohës ka qenë nën shtresëzimin e një varg ndryshimesh dhe transformimesh. Këto ndryshime përveç që manifestoheshin në format themelore të veshjeve, mënyrën e punimit të tyre, zgjedhjen e materialeve, prerjen dhe ngjyrën, por edhe në ornamentikën e përgjithëshme tradicionale dhe zgjedhjen e motiveve. E gjithë kjo ka sjellë deri në përzierjen e pasqyrimeve të vjetra dhe qasjen e ndikimeve të reja, që ka sjellë deri te një numër i konsiderueshëm variacionesh, që u paraqitën në formësimin e veshjeve, por edhe në dekorimin e tyre. Poashtu paraqiten dhe shembuj të tillë që sjellin deri te ndryshimi i funksionit të veshjes e cila vjen direkt nga rrymat e jashtme dhe mënyra e jetesës.

Veshja origjinale po humb ngapak atë burimoren, por ka ende veshje që ruajnë elementin dallues të vendit të tyre, si psh: shalli që e mbulojnë kokën te veshja e burrave në Rugovë, përparësja e Pukës, xhubleta e Malësisë së Shkodrës, brezat e grave në veshjen e Strugës, këmisha e gjatë te veshja e Kërçovës, kollbashët e kokës te veshja e Kërçovës, zbukurimi i fytyrës me material të bardhë etj.

Shtrohet pyetja se viteve të fundit shohim shumë pak veshje tradicionale, mos do të thotë kjo se po shkojmë drejt modernizimit edhe në këtë aspekt? Ky është fakt që po përballojnë të gjithë

popujt, sepse të gjithë sikurse në çdo kohë duan t'i përshtaten kohës dhe të shkojnë me tendencat e kohës, edhe pse traditën mundohen ta mbajnë gjatë kohëve ceremoniale. Veshja tashmë shumë rrallë është veshje popullore e përditshme, por ajo mbahet vetëm nga plakati në disa zona më pak të ndikuara nga globalizmi. Por është për t'u përgëzuar që të gjithë e nderojnë veshjen e vendit apo veshjen popullore në ceremonitë e dasmës, duke i dhënë tërësisht tiparet e një veshjeje vendore. Poashtu rol të reëndësishëm në këtë aspekt luajnë dhe ahoqëritë e ndryshme kulturore, të cilët kanë në sirtaret e tyre veshje popullore, të vendit apo dhe të stilizuara.

Numri i atyre që mundohen të punojnë veshje popullore është rritur shumë. Është e nevojshme patjetër që edhe pse është i pakët numri i profesionistëve, të njëjtit të inspektohen, meqë disa prej tyre e nxjerrin veshjen jashtë kontekstit kombëtar, duke e të stilizuar dhe luajtur me ngjyra, motive, prerje jo adekuate etj. Veshje origjinale janë vetëm ato që shiten në tregje grash dhe të cilat punohen nga gratë për veshje ceremoniale dhe të cilat kuptohet shiten më shpesh.

Prandaj veshja mbetet njëra nga manifestimet më të fuqishme të kulturës popullore dhe studimi i saj sjell deri te zbardhja e disa aspekteve në interes të secilit popull. Funkcioni mbrojtës i veshjes dhe karakteri i saj praktik janë të konkretizuara në forma të ndryshme që ndikohen tek to, dhe të cilët me kalimin e kohës dhe në varësi nga popullsia e vendit i përshtateshin edhe kushteve klimatike. Veshja ndryshon jo vetëm nga mosha dhe gjinia e individit, por edhe nga statusi i tij/ saj social. Tek veshjet festive, funksioni estetik dhe ritual është më shumë i shprehur, për dallim nga veshjet, të cilat përdoren në jetën e përditshme shtëpiake, e cila ka funksion të theksuar utilitar.

Në këtë kontekst, veshjet dallohen në kostume të dedikuara për çdo ditë dhe kostume rituale, ku përfshihen ato festive (nga të cilat më tërheqëse janë ato të dasmës) dhe kostumet e zisë. Në këtë mënyrë, kostumet përcaktohen në bazë të normave shoqërore, pjesë e traditës së grupit ose bashkësisë etnike përkatëse dhe vlerave të saj normative.

Duke pasur parasysh faktin se kostumet popullore shqiptare në Maqedoninë e Veriut nuk janë hulumtuar mjaftueshëm, do të përdorim të dhënat e kostumeve popullore shqiptare nga hulumtuesja Andromaqi Gjergji, e cila sh.kruan për veshjet nga Shqipëria dhe Kosova. Sipas klasifikimit dhe tipologjisë të veshjeve shqiptare, veshjet shqiptare karakterizohen në dhjetë lloje (pesë të femrave dhe pesë të meshkujve).

Klasifikimi është bërë në bazë të zhvillimit të veshjeve popullore në vite e hershme të shekullit XX.

Veshjet e meshkujve klasifikohen në pesë lloje kryesore:

1. Veshje me fustanellë
2. Veshje me këmishë të gjatë dhe dollamë (cibunë)
3. Veshje me tirqi
4. Veshje me brekushe
5. Veshje me poture⁵

Nga këto lloje veshjesh në Maqedoninë e Veriut paraqiten veshjet me fustanellë, tirqe dhe brekushe.

⁵ Gjergji, Andromaqi. *Veshjet shqiptare në shekuj: origjina, tipologjia, zhvillimi*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 2005, f.75

II Veshjet e femrave janë të ndarë në pesë lloje:

1. Veshje me xhubletë – lloj i këmishës së gjatë, e prerë me më shumë kinde, e punuar nga pëlhura e leshtë (Kjo është njëra nga llojet më të vjetra të veshjeve dhe paraqitet ende në rajonin e Shkodrës dhe në viset shqiptare të Malit të Zi)
2. Veshje me këmishë të gjatë dhe një përparëse
3. Veshje me këmishë të gjatë dhe dy përparëse
4. Veshje me mbeshjtjellese
5. Veshje me brekushe⁶

Veshja me fustanellë

Kjo veshje përbëhej prej këmishës me mëngë të gjata, kurse nga beli e poshtë deri në gjunj paraqitej fustanella, e cila është karakteristika themelore e këtyre veshjeve. Punohej nga pëlhura e bardhë e lirit, e zgjeruar në më shumë kinda. Poshtë saj mbanin brekë të gjata, poashtu nga pëlhura e bardhë. Mbi to, prej thembrave e deri te gjunjë mbanin kalçinj, nga leshi i bardhë apo pam-buku ose kofshore këmbësh, poashtu të punuara nga zhguni i bardhë, të gjata prej thembrave e deri te beli.

Veshja me tirqe

Kostum më tipik mashkullor është veshja me tirq, në formën e pantallonave të punuara nga materiali i trashë leshi – nga leshi natyror i bardhë, dhe të zezë ose ngjyrë kafe edhe pse haset më rrallë. Skajeve janë të zbukuruar me shirita dhe gajtan. Në pjesën e sipërme, meshkujt mbanin një këmishë të gjatë me mëngë, xhaketa

⁶ Gjergji, Andromaqi. *Veshjet shqiptare në shekuj: origjina, tipologjia, zhvillimi*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 2005, f.112.

me mëngë të gjata të sipërme, xhublet me mëngë të gjata, të dyja të bëra prej materiali të shajakut. Në përbërjen e këtij kostum, ka edhe një mantel veshja e sipërme me gjatësi deri në bel dhe mëngë të gjata i quajtur xhamadan, e punuar kryesisht nga shajaku i bardhë. Në kohë dimri mbi xhamadanin vishej një tjetër veshje me mëngë të shkurtëra, e punuar nga shajaku i zi, diku e quajtur si setre, apo pallto lëkure e quajtur kaput.⁷



Veshje me tirq

Veshje me brekushe

Ky lloj i pantallonave të meshkujve janë pak më të gjera se tirqët. Sipas prerjes, ato janë të ngjashme me shallvaret, me gjatësi deri te këmbët. Ato janë punuar prej pëlhure të bardhë prej leshi, por poashtu punohen dhe të tilla prej pëlhure pambuku. Zakonisht, ata

⁷ Për më shumë: Useini, Rini. Veshjet popullore shqiptare në trevën e Strugës, ITSHKSH, Shkup, 2018.

punohen në shtëpi, të endura në vegjë. Visheshin të lidhur me një rrip të gjerë leshi, në një bazë të kuqe të zbukuruar me vija horizontale, kurse në pjesën e sipërme, një këmishë të gjatë me krahë të gjatë.

VESHJE GRASH

Veshja me këmishë të gjatë dhe një përparëse

Një pjesë karakteristike e kësaj veshjeje është një këmishë me mëngë të gjata, e cila, në varësi të elementeve të punuara me grep, mund të jetë e gjërë, e përshtatur me më shumë kinde dhe më e ngushtë. Rreth mesit gratë mbështillnin një rrip leshi me ngjyra të ndryshme, dhe në anën e jashtme të leshit ose skajin e pambukut. Flokët e saj ishin të mbuluara me një shami, e cila ishte e thurrur me gërsheta ose qetka. Ishte e zakonshme që nuset të prejnë flokët mbi ballin e tyre dhe mbi veshët e tyre të formuar me zylyfe, në varësi të statusit të tyre shoqëror. Flokët e saj ishin të mbuluara me një shami të veçantë (maroma), e cila zakonisht lidhej pas qafës së saj, në atë mënyrë që të duken flokët.⁸

⁸ Për më shumë: Mustafa, Bukuriye. Murtezani, Izaim. Useini, Rini. Gjurmëve të veshjes popullore shqiptare në Maqedoni, ITSHKSH-Shkup, 2017



Veshja ceremoniale gjatë dasmës në rrethin e Strugës.

Veshja me dimija dhe brekushe

Dimijat paraqesin tip të veçantë shallvaresh, të gjera që i mbanin gratë e këtij rajoni. Në varësi nga gjerësia e pëlhurës, dalloheshin disa lloje të dimive. Më të gjera ishin ato të punuara nga pëlhura e gjatë deri katër metra. Edhe pse të njëjta për nga prerja, dimitë qepeshin vetëm nga pëlhura e bardhë dhe ishin të caktuara për nuset dhe gratë e reja në raste festive. Për dallim prej tyre brekushet mbaheshin në ditët e tjera nga e gjithë popullata e Strugës dhe rrethinës. Në varësi nga statusi social, nuset mbanin brekushe nga ngjyra të ndryshme. Kështu për shembull, vajzat dhe të fejuarat mbanin brekushe të zeza, nuset dhe gratë e reja brekushe me ngjyrë të gjelbërt dhe të kaltërt, kurse ata më në moshë mbanin të bardha,

me ngjyrë kafe ose të zeza – nëse janë duke mbajtur zi për ndonjë të vdekur të afërm (janë në zi).

Mbulesat e grave të kokës janë pjesë përbërëse dhe shumë e rëndësishme e veshjes tradicionale shqiptare të Strugës. Sipas materialeve arkivistike dhe eksponateve muzeale, mund të konstatojmë se copat e grave për mbulimin e flokëve – shamitë, në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX ishin të punuara nga pëlhura e bardhë, e endur shtëpiake, në formë kuadrative, me dimensione 1.50 cm x 1.50 cm. Vajzat dhe gratë e reja mbanin shami në ngjyrë të bardhë, kurse nusët më të reja me ngjyrë më intensive, më së shumti të kuqe, të kaltërt ose të gjelbërt.⁹

Vajzat dhe gratë më të moshuara shaminë e mbanin të lidhur pas qafës, duke i mbuluar të gjithë flokët e mbledhura. Për dallim prej tyre, nusët e reja, si shenjë e statusit të tyre social i mbanin të pambuluara zylyfet e gjata (deri në gushë) për tu vërejtur nga të tjerët. Shamitë për gratë e reja dhe nusët punoheshin kryesisht nga pëlhura e bardhë e pambukut e dekoruar me motive florale.

Përfundim

Nga të dhënat e nxjerra në lidhje me veshjen popullore të shqiptarëve mund të vërehet se ajo është pjesë përbërëse e kulturës popullore. Ajo ka shumë dallime dhe te perbashketa që përputhen me veshjet e krahinave të tjera etnografike, ku jeton popullata shqiptare. Kjo kontatohet edhe nga etnologë të njohur shqiptarë, siç janë: Andromaqi Gjergji, Drita Halimi Statovci, Mark Tirta dhe të tjerë.

⁹ Useini, Rini. Veshjet popullore shqiptare në trevën e Strugës, ITSHKSH, Shkup, 2018.

Veshjet e meshkujve në vija të përgjithëshme sipas autores Andromaqi Gjergji, poashtu janë të ndara në pesë grupe: veshja me fustanellë, veshja me këmishë të gjatë dhe dollamë (cibunë), veshja me tirqe, veshja me brekushe dhe veshja me poture. Nga të gjitha këto llojet e përmendura të veshjes në Maqedoninë e Veriut janë të pranishme veshja me fustanellë, tirqe dhe brekeshe. Veshja me fustanellë përdorej nga toskët, ajo me tirq dhe me brekushë nga gegët

Pra, veshjet tradicionale janë elementi thelbësor i komunikimit të njeriut me një botë materiale të theksuar, sepse nëpërmjet tyre njerëzit kanë mundur të dallojnë nga larg përkatësinë sociale, statusore, moshën, etninë, krahinën, etj.

Literatura

Gjergji, Andromaqi. *Veshjet shqiptare në shekuj: origjina, tipologjia, zhvillimi*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 2005.

Osmani–Selimi, Edibe. *Veshja autoktone e femrave të Rekës së Epërme*. Tetovë, 2012.

Halimi – Statovci, Drita. *Veshjet shqiptare të Kosovës*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2009.

Useini, Rini. Veshjet popullore shqiptare në trevën e Strugës, ITSHKSH, Shkup, 2018.

Bihiku, Ikbal. Për një shfrytëzim më të drejtë të motiveve tona popullore në tekstile e artizanatit, *Etnografia shqiptare, IV*, Tiranë, 1978.

Mustafa, Bukuriye. Murtezani, Izaim. Useini, Rini. Gjurmëve të veshjes popullore shqiptare në Maqedoni, ITSHKSH–Shkup, 2017

FUNKSIONI INFORMATIV I VESHJEVE TRADICIONALE TË HASIT

1. Hyrje

Krahina etnografike e Hasit, është njëra ndër zonat specifike të trojeve shqiptare, sa i përket veshjeve tradicionale. Këto specifika të veçanta të veshjeve, kjo krahinë i ka për shumëllojshmërinë funksionale të veshjeve, e në veçanti të veshjeve të grave, përkatësisht të veshjes me kollan, me të cilën veshje karakterizohet kjo krahinë etnografike.

Për shkak të këtyre specifikave të veshjeve tradicionale të Hasit, në këtë drejtim duhet të ndalemi më gjatë, në mënyrë që sado pak të sqarojmë një pjesë të karakterit informativ të veshjes së grave të Hasit. Karakteri informativ i veshjes së grave të Hasit, për kalimtarë rasti, i cili e shihet për herë të parë veshjen e grave të kësaj krahine, do të ballafaqohet me një kod të padeshifruar. Pra, për të do të jenë shumë të panjohura. Madje, edhe për shumë studiues, që deri më tash janë përpjekur të merren me studimin e veshjeve tradicionale. Këto të panjohura kanë qenë dhe kanë mbetur të shumta e të pazbërthyer deri më sot për faktin se veshjet tradicionale të Hasit, kryesisht janë parë si dekor dhe deri diku është parë edhe ana funksionale, por nuk është marrë asnjë studiues me anën informative që sjellin veshjet, apo pjesët e veçanta të veshjeve të grave të kësaj krahine etnografike. Kjo ka ndodhur, jo pse informatorët nuk i kanë ofruar studiuesve, apo të interesuarve sqarime, por për faktin

se ata nuk e kanë pasur idenë e gjuhës komplekse të veshjes së tradicionale të grave të Hasit.



Në anën tjetër, jo të gjitha kostumet në krahinën etnografike të Hasit e kanë të njëjtën mënyrë të komunikimit, përkatësisht gjuhë komunikuese. Në disa kostume të nënzonave të caktuara moshën e dëftojnë në mënyra më të thjeshtë, ndërsa gjendjen civile dhe emocionale e tregojnë krejtësisht me një formë tjetër të komunikimit. Madje, në shumë raste, kur veshjet, apo një pjesë e veshjeve e kryen funksionon informativ, ajo pjesë e veshjes, apo ai motiv i veshjes, e ndryshon në të tersi domethënien, po motivin fillestar.

2. Funkcioni informativ – gjuhë komunikuese me qëllim të zgjidhjes së problemeve jetësore

Të gjithë studiuesit që janë marrë me funksionin e veshjeve tradicionale, kanë konstatuar se veshjet, varësisht nga krahina që merret në shqyrtim, mund të kenë disa lloje të funksioneve siç janë funksioni praktik, estetik, funksioni ceremonial dhe ai ritual. Këto

funksiione janë të lidhura ngushtë njëri me tjetrin, ngase kombini—met në mes këtyre funksioneve janë të mundshme, duke u ndih—muar nga prania e ndryshimeve të shkallëzuara të kushteve të jetës si dhe nga rrethanat, nëpër të cilat ka kaluar bartësi i atyre veshjeve.

Pavarësisht prej funksioneve të lartshënuara, veshjet popullore të Krahinës së Hasit, kanë karakter informues mbi gjendjen sociale, emocionale dhe statusin martesor të personit që e bart atë veshje, apo atë pjesë të veshjes, që plotëson veshjen në tërësi. Karakteri informativ i veshjes së grave të Hasit nuk është shumë i dukshëm, dhe për këtë arsye është vështirë të vihet re në shikim të parë, nga njerëz, që nuk e njohin mentalitetin dhe rrethanat e kësaj krahine, pra pa e bërë një analizë më të thellë në aspektin social kulturor.



Funksioni informativ i veshjeve së grave të Hasit, pavarësisht variantit të veshjeve, është shumë më i ndërlikuar, ngase veshja nuk jep informata vetëm për personin që e bart atë veshje, por edhe për persona të tjerë, që ndikojnë drejtpërsëdrejti në jetën e gruas hasjane. Andaj pikërisht për këtë arsye, dallimi, apo hetimi i funksionit informativ është i kufizuar, vetëm për personat, që i kuptojnë shenjat informuese të kësaj veshjeje. Në anën tjetër, fuqia informative e veshjes së grave të Hasit varet edhe nga ambienti ku ai element informativ shfaqet. Ndonëse funksioni informativ i veshjeve, apo më mirë të themi i disa pjesëve të veshjeve, shfaqet më së shumti në ceremonitë familjare, përkatësisht në vendet ku “informatën” mund ta transmetojnë në mënyrën më të drejtë të mundshme, për t’i dalë në ndihmë bartësit të atij informacioni. Së këndejmi mund të themi se vendet më të shpeshta ku shfaqet funksioni informativ janë ceremonitë e dasmave (në familjen e burrit dhe të nuses), ceremonia e daljes në krua, për fshatrat ku banorët janë furnizuar në një vend me ujë të pijes. Por, ka raste që elementet informative të një veshje të grave të Hasit të jenë transmetuar edhe në veshjet e punës, përkatësisht gjatë daljes në fushë në stinën e verës. Gjithsesi elementet informative të veshjes kanë pasur karakter më të gjerë dhe për qëllim njoftimin e më shumë njerëzve me brengën, shqetësimin e një gruaje, që e ka zgjedhur rrugën e informimit publik për problemet me të cilat ajo është përballur në familje. Prandaj, shikuar në këtë aspekt mund të themi se informimi është publik, për çka edhe ka rëndësinë e vet.

Funksioni informativ veshjeve të grave të Hasit në të shumtën e rasteve është i shoqëruar edhe me funksionet tjera, që e ndihmojnë bartësen ta transmetojë më lehtësisht mesazhin, që ajo dëshiron ta kumtojë me anë të atij veprimi, përkatësisht pjese të veshjes.

Funksioni informativ çdo herë shkon në bashkëvajtje me funksionet tjera të veshjeve tradicionale siç janë:

Funksioni praktik i veshjeve tradicionale vihet re në ndryshimet e natyrshme, që lëvizin së bashku me jetën. Pra, varësisht prej kush-teve të jetës dhe grupmohës së bartësve, kostumet u përshtaten ngjarjeve dhe jetës, që e rrethon bartësin. Dhe si të tilla funksioni informativ i bashkëngjitet këtij funksioni.

Funksioni estetik i kostumeve të grave, kryesisht vihet re tek grupmohat e grave më të reja. Pra, sa më e re që të jetë gruaja që e bart një kostum, aq më shumë ka vlera estetike, që do ta dallonin atë nga një grua e grupmohës më të vjetër. Kështu, nëse në rrugë i takon një nuse me vjehërr, në bazë të funksionit estetik mund të dallohen se cila është reja e cila vjehrra. Dhe ky dallim mund të bëhet pa i parë në fytyrë, sepse elementet estetike flasin qartë për këto ndryshime. Andaj, funksioni informativ pothuaj e shoqëron çdo herë funksionin estetik.

Edhe funksioni ceremonial i veshjeve ka rolin e vet, sepse në bazë të veshjes së grave, një i huaj, apo kalimtar rasti, mund të përfundojë se për çfarë ngjarje bëhet fjalë. Kuptohet, nëse ai kalon pranë asaj shtëpie, ku zhvillohet një ceremoni e nuk dëgjon zhurma e as muzikë, apo vaje. Andaj, funksioni ceremonial dallon varësisht prej ceremonive, që zhvillohen në një familje. Dhe si i tillë funksioni informativ mund të bashkudhëtojë pothuaj se në të gjitha ceremonitë familjare, deri sa ta përcjellë mesazhin e duhur.

Ndërkaq, më i zbehur se tri funksionet e tjera mund të jetë funksioni ritual. Madje, për këtë funksion, mund të flasim më pak se për funksionet e tjera, të cilat mund të flasin nëpërmjet veshjes, dhe në këtë mënyrë mundësitë e informimit janë shumë të kufizuara. Në

anën tjetër, për shkak të besimeve të shumta, nuk tentohet që përmes veshjeve me elemente rituale, të jepet ndonjë mesazh i grave, në lidhje me gjendjen e tyre statusore, apo të reflektimit të dëshirave apo brengave.

Përmes veshjes, në mënyrë shumë të qartë mund të kuptojmë edhe gjendjen ekonomike të një familjeje. Fare lehtë mund të kuptojmë edhe kulturën e saj, sepse me anë të veshjes ajo dëfton për ngritjen e saj kulturore, për respektin që ka ndaj të tjerëve e shumë aspekte të tjera.



Kështu, në shumë raste kostumet tradicionale, për shkak të ngjarjeve me të cilat ballafaqohet familja e bartëses, shumë herë ndodh që një grua në moshë fare të re, të jetë e veshur me kostum shumë të ngjashëm me atë të veshjeve të moshës së mesme, të pleqërisë etj. Prandaj, njohja “e gjuhës” komunikuese e veshjes, mendojmë se

është një art më vete, po aq i rëndësishëm sa arti i endjes dhe qën-disjes së pjesëve të veshjes.

Shumë elemente informative të veshjeve të grave janë të kodifikuara, sepse përmes veshjes, qoftë edhe përkundër dëshirës apo vullnetit të bartëses, veshja tregon gjendjen civile në familje e shoqëri, përkatësisht raportet edhe me bashkëshortin, por edhe me anëtarët e tjerë të familjes. Duke analizuar rolin praktik të kostumeve tradicionale, në ditët, javët dhe muajt e parë të martesës, nusja është e obliguar, që t'i përcjellë këshillat e grave të shtëpisë. Përkatësisht ajo duhet t'i ndiqte këshillat e njerëzve më të afërt të burrit, sepse ndodhë që në një fami-lje të jetojnë në bashkësi deri në pesë breza, andaj kishte shumë rëndësi se nga kush t'i merrte këshillat dhe sugjerimet.

Por, qëndrimi i saj me kalimin e kohës, përkatësisht me adaptimin në shtëpi të re, pra në shtëpi të burrit, e detyron atë që ta ndryshojë edhe mënyrën e komunikimit. Në këtë mënyrë, ajo tani kërkon që urën komunikuese ta zhvillojë vetëm përmes veshjeve, përkatësisht elementeve të kostumeve. Zgjedhja e gjuhës komunikuese përmes kostumeve, përkatësisht elementeve të kostumeve bëhet me qëllim që ajo të mos bie ndesh me traditën dhe familjen. Kështu ajo nuk dëshiron në asnjë moment që ta lëndojë miqësinë e dy familjeve. Por, përkundrazi, me qëndrimin e saj, përmes funksionit praktik të veshjes, përkatësisht gjuhës komunikuese të disa elementeve të veshjes, dëshiron t'i nxjerrë në pah rezultatet e miqësisë, qofshin ato pozitive, apo edhe negative. Me një fjalë, ajo dëshiron që mendimin e saj të mos e mbajë të ndrydhur, por ta shprehë në atë mënyrë që të kuptohet nga ata që ajo dëshiron ta kuptojnë.

Nisur nga kjo që thamë, veshja e grave të Hasit, me specifikat e saj, pos funksioneve të lartshënuara, posedon edhe funksionin infor-mativ, përkatësisht komunikues. Më poshtë ne do të bëjmë fjalë për

këto dy funksione, duke i sjellë shumë të dhëna të mbledhura nga terreni. “Asnjë grue nuk ka dashur që ta prishë miqësinë në mes dy familjeve, pa provuar, që përmes komunikimit me elemente të veshjes, të japë shenja paralajmëruese. E nëse edhe pas shenjave, nuk është ndërmarrë asgjë në drejtimin që ajo ka kërkuar, atëherë në raport me gjendjen e saj emocionale, ka ndryshuar edhe gjuha e komunikimit.”

3. Funksioni informativ përmes veshjes së vajzave

Funksioni informativ dhe ai komunikues i veshjes së grave të Hasit pasqyrohet përmes grupmoshave të ndryshme të bartësve të veshjes. Për t’u parë ky funksion në mënyrë sa më të qartë, po nisemi që nga përgatitja e pajës, apo siç është e njohur në Has përgatitjes së “çejzit”. Kështu në kohën, kur vajza përgatit disa veshje të mira (të përditshme gjatë muajve, përkatësisht gjatë viteve të para të martës), më të mira (për kohën e nusërisë) dhe disa veshje orta. Për të gjitha këto nënndarje të kostumeve, ajo është e përcaktuar se me çfarë figura artistike do t’i punojë ato tipe të veshjeve. Meqenëse siç do të shihet më poshtë kanaci (futa) është pjesa e veshjes, përmes së cilës kryesisht jepen mesazhet komunikuese, ose “kryefjala e alfabetit të veshjes së Hasit” përmes së cilës një nuse e re mund të komunikojë më lirshëm dhe më hapur për problemet e saja në jetën bashkëshortore. Kështu, një vajzë e fejuar, para se ta nisë përgatitjen e një kanaci, do ta projektojë në mendjen e saj së pari dëshirën e pastaj edhe planifikimin për një të ardhme të lumtur. Gjithsesi, në të gjitha rastet, ajo informohet mirë nga familjarët e saj dhe mbi bazën e informacioneve që posedon për burrin e saj të ardhshëm, për familjen ku do të martohet, ajo edhe i punon pjesët e veshjeve, gjithnjë duke ia përshtatë familjes dhe ndjenjave të saja emocionale.



Në rastet, kur një vajzë e fejuar, gjatë përgatitjes së pajës, ka rezervuar, atëherë edhe punën për përgatitjen e pajës e bën në mënyrë të rezervuar, përkatësisht figurat që i përdor në endjet, qëndisjet, janë të mbështetura në dyshimet e saja për të ardhmen. Themi në mënyrë të rezervuar, duke i lënë mundësi pjesës së veshjes, që t'i shtojë, apo t'i heqë një element, me anë të të cilit do të komunikonte sipas dëshirës. Por, nëse dëshirat e saja janë në kundërshtim me realitetin, atëherë ajo me pak ndryshime, do ta ndryshonte edhe “gjuhën” komunikuese në ditët, javët dhe muajt e parë të martesës. Në mënyrë që të mos hetohen qëllimet, apo dyshimet e saja, gjatë përgatitjes së pajës, ajo përgatit pajës, apo veshjes kryesisht sipas traditës, duke përfshirë këtu sa më shumë veshje, përkatësisht pothuaj për gjithë vitet e martesës, që dëshiron t'i kalojë. Por, sasia e veshjeve të punuara varet në masë të madhe edhe nga kushtet e familjes së burrit, e cila sipas traditës ishte e obliguar që t'i siguronte materialin për përgatitjen e veshjeve. Pos ndryshimeve, që mund t'i bëjë më

vonë me anë të ndërhyrjeve, ajo përgatitet edhe në përgjithësi që veshjen ta ketë gjatë gjithë jetës.

Nga kjo del se vajza, qysh në kohën e përgatitjes së pajës, është e përcaktuar për veshjen e saj në dy grupe kryesore: në veshjet për raste solemne dhe në ato të përditshmërisë, ku përfshihen edhe veshjet e punës. Punimi i këtyre dy grupeve të veshjeve, kryesisht varej prej materialit dhe zbukurimeve në endje (vek dhe gjergjef). Në vazhdim ne do të mundohemi që të sjellim në mënyrën sa më origjinale këto ndryshime dhe përshkrime të këtyre dy faktorëve të veshjes së grave të Hasit, duke filluar nga grupmoshat e bartësve të veshjes e deri tek veshjet që shprehin gjendjen civile dhe emocionale, meqë për veshjen e vajzave, kemi bërë fjalë në një punim më herët.

4. Funkcioni informativ përmes veshjes së nuseve

Veshja e nuseve, ndonëse është veshja më e pasur për nga elementet e veshjes dhe gjithsesi funksioni informativ është më i shprehur se në nëntipet tjerat veshjeve. Në të vërtetë nuset, qoftë për shkak të moshës, qoftë për shkak të gjendjes së tyre emocionale, përmes veshjes përpiqen që të jenë për një kohë sa më të gjatë në qendër të vëmendjes si nga njerëzit e shtëpisë së burrit si të familjeve përreth familjes së burrit, apo fëfëfisit të burrit.

Kjo ndodhë për faktin se në të kaluarën statusi i nuses në shtëpinë e dhëndrit ka qenë status, që ia ka kufizuar deri në atë shkallë të drejtën e shprehjes së lirë të nuses, sa ajo nuk ka pasur guxim të flas hapur dhe ashtu siç kanë qenë, as në shtëpinë e burrit e as në shtëpinë e babit për problemet e veta, vetëm e vetëm që të mos prishet miqësia.



Në të gjitha rastet kur një nuse e re, në amujt e parë të martesës, e ka pasë të pamundur ta shpreh hapur mendimin e pse jo edhe qëndrimin e saj, ajo këtë gjë e ka bërë me anë të elementeve të veshjes. Sipas subjekteve me të cilat kam kontaktuar në lidhje me këtë temë, kanë deklaruar se në shumë raste, një element i veshjes flet më shumë se një bisedë që mund të zgjas me ditë të tëra.

Ajshe Cikaj, sot 98 vjeçare, nga Gjonaj, në lidhje me këtë çështje shton se “guha e veshjes na ka mbajtur gjallë, që nga dita kur jemi fejuar”. Ajo vazhdon duke treguar se si qysh gjatë përgatitjes së pajës, veshjet janë përgatitur, duke iu përshtatur gjuhës komunikuese, alfabet të cilin e kanë njohur pothuaj se të gjitha gratë e fshatrave të Hasit. Alfabeti i gjuhës komunikatave të veshjes së Hasit, ka qenë unik pothuaj se në të gjitha fshatrat e Hasit, pa dallim

nëntipeve të veshjeve, edhe pse pamundur që të shprehet, apo edhe të komentohet me pak ndryshime. Kështu, mospajtimi i nuses me fatin që ia ka përcaktuar familja me anë të traditës, gjithkund në Has është shprehur përmes elementin e veshjes të quajtur në popull “Yrrnek me sakica”. Edhe pse në rastet e rëndomta “yrrneki me sakica” për grupmoshat e grave që kanë më shumë se pesë vite martesë, ka simbolizuar plleshmërinë dhe qëndrueshmërinë, për nuset e sapomartuara, ky element, apo motiv ka simbolizuar krejtësisht diçka tjetër. Meqenëse motivi i veshjes me sakica është praktikuar kryesisht përmes kanacit apo rrallë herë përmes pjesës së veshjes së sylykëve të marhamës, që janë në të vërtetë edhe dy elemente ose pjesë të veshjeve të Hasit, përmes të cilave kryesisht përmes këtyre dy elemente nusja i ka shprehur brengat e veta në mënyrë më të lehtë dhe më të shpejtë.

Kështu nëse pas javës së parë të martesës, nusja e sapo martuar ka veshur për tre ditë rresht kanacin “me sakica” ka qenë shenjë se nusja nuk është duke u pajtuar me fatin, që ia kanë përcaktuar familja e saj. Dhe në raste të tilla vjehrra është e obliguar që të ndërmer merr masa të përnjëhershme, duke u orvatur që ta zgjidh këtë mosmarrëveshje në mes nuses dhe djalit të saj.

Nëse nusja gjatë tre muajve të parë të martesës, e parapëlqen kanacin me sakica dhe atë e bartë herë pas here vetëm një ditë, është konsideruar si shenjë se ajo një natë më parë është grindur me burrin. Nëse vazhdon ajo edhe të nesërmen ta vesh të njëjtin kanac, atëherë është vërtetuar se mosmarrëveshjet janë duke vazhduar. Në raste të tilla, sipas subjekteve, për bartjen e kanacit me yrrnek të sakicave, për një ditë, nuk është ndërmarrë asnjë veprim, sepse është e natyrshme që në jetën bashkëshortore ketë zënka deri në rrahje dhe në mënyrë që ato të pasqyrohen edhe në familje janë

prezantuar përmes veshjes, duke dashur që ta informojë në radhë të parë vjehrrën, tek e cila nusja shpreson se do ta gjejë mbështetjen dhe ndihmën më të madhe për ta tejkaluar këtë moskuptim. E nëse ndodh që nusja ta përsëris këtë mënyrë të veshjes, përkatësisht të vishet me veshjen e nuses dhe vetëm kanacin me motive të quajtur “sakica” edhe ditën e dytë, atëherë është konsideruar si shenjë që vjehrra duhet të ndërmarr diçka të shpejtë, përkatësisht të mësojë për arsyet e grindjeve në mes bashkëshortëve.



Në anën tjetër, nëse nusja në shtëpinë e burrit e ka paralajmëruar vjehrrën e saj, apo edhe gratë e shtëpisë përmes mënyrës së veshjes për tre ditë me radhë dhe nuk është ndërmarrë nga askush asgjë, atëherë nusja ka qenë e detyruar që të ndërmerr hapa tjerë për ta nxjerrë në pah mospajtimin e saj. Në raste të tilla ajo, nëse në lagje, përkatësisht në faretis të burrit ka ndonjë gazmend familjar, që sipas traditës nuset e sapomartuara janë në qendër të vëmendjes, deri sa të vjen nusja për të cilën po bëhet dasmë, atëherë ka zgjedhur atë gazmend, që të vishet me kanacin me sakica dhe deri në dasmë, ajo

e ka mbajtur të mbuluar (fshehur) me një kanac tjetër dhe vetëm kur i ka ardhur radha të del në valle e ka shprehur mospajtimin e saj me burrin përmes kanacit që me motive me sakica, që siç e theksuam nuk është pjesë e veshjeve të nuseve të reja. Kjo shenjë, ka qenë alarmuese jo vetëm për familjen e ngushtë, por edhe për farëfisnin dhe si rregull, nusen e kanë nxjerrë nga vallja dhe e kanë nisë për në shtëpi, në mënyrë që të mos alarmohet gjendja edhe më shumë. Prandaj, për këtë arsye zakonisht nuset e reja në çdo ceremoni familjare gjatë muajve të parë të martesës shoqëroheshin nga dikush e besuar e dhëndrit dhe kryesisht kontrolloheshin para se të dilnin nga shtëpia edhe pse për raste të tilla gjendeshin forma të ndryshme të shprehjes së këtij veprimi – informimi.

Një mënyrë tjetër e shprehjes së pakënaqësisë, së nuseve të sapomartuara, në lidhje me burrin ka qenë edhe mënyra e veshjes së nuses, gjatë ditëve kur nisë të del në “bunarë” apo në krua, meqë edhe pusi edhe kroni, zakonisht ishin të përbashkëta për një lagje e edhe më gjerë. Në rastet e tilla, nëse nusja me anë të mënyrës së veshjes, së saj specifike nuk ka arritur, që t’ia tërheq vëmendjen njerëzve të familjes, se nuk është puna mirë mes saj dhe burrit të saj (siç e theksuam mënyrën e veshjes së kanacit me sakica për një ditë apo deri në tri ditë), ajo pas dhjetë ditëshit të parë të martesës deri në lindjen e fëmijës së parë, për çdo të enjte ose të dielë, që ka dalë në krua ka veshur kanacin me sakica, që ka qenë shenjë se ajo po kërkon ndihmë nga të tjerët, që t’i ndihmojnë, në rregullimin e marrëdhënieve martesore, meqë njerëzit e familjes nuk janë duke e marrë në konsideratë hallin e saj.

Në të vërtetë ndihma që kërkon nusja me anë të shenjave, ose përmes komunikimit me elemente të veshjes ka qenë nga më të ndryshmet, pasi që ajo ka informuar të afërmit e burrit edhe në

rastet kur burri e ka refuzuar atë, pra nuk e ka pranuar, përkatësisht kur nuk e ka dashur atë për fat të jetës. Pra, komunikimi përmes pjesëve të veshjes është bërë për të dy rastet, sepse ka pasë një rast të raste kur burri nuk e ka respektuar (dashur) gruan dhe anasjelltas.

Ka raste kur nusja i fsheh këto grindje, duke mos i publikuar me anë të elementeve informative të veshjes, përkatësisht nëse ajo nuk dëshiron që ta publikojë brengën e saj në shtëpinë e burrit dhe këtë brengë e shpreh në ditën kur shkon “spari”, përkatësisht në ditën kur shkon tek prindërit e saj. Nëse një nuse në ditën kur shkon *spari*, e vesh kanacin me sakica ka treguar se marrëdhëniet e saj me burrin nuk janë të mira dhe se nëna e saj duhet ta bisedojë këtë çështje me babain e saj, apo me vëllezërit në mënyrë që të zgjidhet ky problem. Nëse arrihet, që ky problem të tejkalohet, atëherë nusja tek prindërit e saj, vishet me një veshje më të thjeshtë, por gjithsesi jo me kanac me sakica. E nëse ky veprim përsëritet disa herë nga bija e shtëpisë, atëherë familjarët e saj, duhet të bisedojnë me familjen e burrit, në mënyrë që të zgjidhen këto mosmarrëveshje, ose në të kundërtën të prishet miqësia.

Sipas gjuhës komunikuese të veshjes së grave të Hasit, nusja kur kthehet nga prindërit e saj, atë ditë vjen e veshur me veshjen më të mirë të nusërisë, por nëse as pas kësaj pauze disa ditësh, nuk ka ndryshuar asgjë atëherë ajo sërish nisë që ta vesh kanacin me sakica siç u theksua më lartë deri në arrijen e qëllimit, përkatësisht pajti—mit ose në fund ndarjes.

5. Funkcioni informativ përmes veshjes së grave të reja

Gjendjen civile të grave hasjane më mirë se çdo gjë tjetër e dëshmon veshja e saj me ngjyrat dhe zbukurimet, që ku më shumë e ku më pak pasqyrojnë edhe vlerat artistike e bashkë me artin edhe

gjendjen emocionale. Andaj, mënyra e bartjes, kohëzgjatja e bartjes, mënyra e zbukurimeve të kostumeve të grave të Hasit, luajnë në masë të madhe edhe rolin informativ. Funkcioni informativ i veshjes së grave të Hasit, nuk është thjesht funksion informativ vetëm për të shprehur pakënaqësitë e grave, por pasqyron edhe momente tjera jetësore. Prandaj, për këtë arsye, pjesët e veshjeve të grave të Hasit shquhen për nga fuqia artistike e figurave të shumta. Në këtë mënyrë një figurë e endur, apo e qëndisur, që në shumë raste i shtohet veshjeve festive, veshjeve të nuseve, flet më qartë dhe më shumë se ç'do të flisnin dymbëdhjetë pleq në një kuvend të mbarimit të një mosmarrëveshjeje familjare për një çështje bashkëshortore, thuhet në Has. Por, në anën tjetër gjuha artistike e veshjes së Hasit, mund të kuptohet vetëm nga ato artiste, që e kanë trashëguar gjuhën komunikative të veshjes e jo thjesht çdo grua, që vishet në veshje të Hasit, apo edhe që e përgatit veshjen e Hasit. Pra, jo çdo femër, apo grua mund ta deshifrojë gjuhën e veshjes së Hasit.

Karakteri informativ i veshjeve të grave të Hasit nuk është edhe aq i vështirë për t'u kuptuar nga banoret – artiste të fshatrave të Hasit, aq më pak nga bota femërore, të cilat përmes veshjes i vlerësojnë jo vetëm ndjenjat emocionale të grave, por edhe arrijnë të kuptojnë për ngjarjet me të cilat ajo grua është duke u përballur në jetën e saj. Në bazë të këtij fakti, mund të konkludojmë se mënyra e veshjes së grave është edhe një komunikues i ngjarjeve familjare, që i jep mundësinë e bashkëbisedimit në mënyrë më të drejtpërdrejtë e në të njëjtën kohë nga distanca. Kështu, bie fjala, falë kësaj karakteristike informative të veshjes, në të shumtën e rasteve nuk ka nevojë që të pyetet se çfarë i ka ndodhur një gruaje, e cila vishet ndryshe nga një tjetër, edhe pse nga mosha janë të përafërta. Veshje të ndryshme mund të bartin dy gra të martuara në të njëjtën familje

dhe që të dyja ta kenë të zgjidhur statusin e tyre martesor, të trashëgimisë, por që një ngjarje që ka mundur t'i ndodhë familjes së njërës prej grave të shtëpisë, i bën të dallojnë ato nga njëra-tjetra. Dhe ky ndryshim mund të hetohet vetëm me anë të veshjes, që thjesht i posedon elementet informative, të cilat u japin përgjigje në mënyrë vizuale jo vetëm atyre që jetojnë në atë bashkësi familjare, por edhe të tjerëve, që këto ndryshime mund t'i hetojnë nga distanca.



Në masë të madhe gjuha komunikuese e pjesëve të veshjeve ka shërbyer edhe për të dhënë lajmin nusja se është shtatzënë. Kështu nëse një nuse e sapomartuar e heton se ka ngelur shtatzënë dhe dëshiron që këtë lajm t'i kumtojë familjarëve të burrit, atëherë ajo veshjes së zakonshme të nuses në mëngjes i shton edhe një zbukurim që zakonisht në të folmen e Hasit quhet “raft”. Nëse nusja përmes kësaj pjesë të shtuar të veshjes vetëm dëshiron të tregojë se është shtatzënë, atëherë raftin që kryesisht është në formë të zemrës mban në mes, duke e varur në qafë. Ndërsa nëse ajo ka shenja se e di edhe gjininë e fëmijës, atëherë njoftimi bëhet në dy forma: Për të treguar gjininë e fëmijës mashkull rafti lidhet në kukën e djathtë të

kollanit dhe varet në anën e majtë të xhamadanit, apo edhe në qafë duke anuar në të majtë. Dhe nëse fëmija që e pret mendohet se është i gjinisë femërore, raftin e mbështet në cepin e majtë të kollanit dhe në anën e djathtë të xhamadanit. Me anë të këtyre shenjave nusët e reja informojnë jo vetëm familjarët, por edhe të tjerët për shtat-zëninë e tyre, gjë që është edhe qëllim dhe dëshirë e çdo martese.

Me anë të pjesëve të veshjeve të Hasit ka edhe forma tjera të komunikimit, për të cilat do të flasim në një punim më të zgjeruar.

Përfundim

Funksioni informativ i veshjeve tradicionale të Hasit, në këtë punim është prezantuar një studim i veçantë në lidhje me këtë temë, meqë deri më tash janë studiuar vetëm anët funksionale të veshjeve, por jo edhe gjuha komunikuese e veshjeve. Jam përpjekur që përmes këtij punimi të sjell në kujtesë aftësinë komunikuese të botës femërore, e cila krahas angazhimeve të saj në përgatitjen e veshjes, të mendojë edhe për mënyrën, përkatësisht gjuhën komunikuese që kanë disa pjesë të veçanta të veshjes tradicionale të Veshjes së Hasit me kollan.

Shembujt, që kam sjellë përmes këtij punimi, janë vetëm disa shembuj që dëshmojnë për mënyrën e organizimit të jetës në një familje patriarkale. Pra, në të gjitha rastet, kur bota femërore është ndier e pa aftë për ta mbrojtur vetën, qoftë në familjen e burrit, apo edhe në familjen e prindërve, atëherë ajo përmes gjuhës komunikuese të veshjeve, ka treguar se dikush duhet të interesohet për te, para se të ndodhë ajo që nuk dëshiron as ajo e as familja e burrit apo prindërit e saj.

Pra, gjuha komunikuese, apo alfabeti komunikues i veshjes së Hasit është një element i veçantë. Që ka bërë jetën e vet disa qindra vite me radhë. Ndërsa sot në ditët e sotme, shumë nga këto pjesë informuese përdoren , por jo me funksionin që e kryenin këto pjesë të veshjeve dikur. Angazhimi i im në të ardhmen do të jetë edhe më i madh që t'i publikoj edhe mënyrat tjera komunikuese të botës femërore, m e jo vetëm të grupmoshës së grave të reja, si[i kam paraqitur në këtë prezantim të shkurtër.

REFERENCAT

Afërdita, O. (2009) Veshjet popullore shqiptare në Kosovë, Kultura popullore, nr. 1–2, IKP: Tiranë.

Afërdita, O. (2011) Veshjet popullore në Lumë dhe Has, Kultura popullore, nr. 1–2, IKP: Tiranë.

Çoçaj, N. (2000) *Veshja e Hasit*: Bogdani, Has.

Çoçaj, N. (2013) Hasi enciklopedi etnokulturore, vëllimi III – Veshje tradicionale të Hasit: *Pavarësia*, Durrës.

Drita, S. (1988) Kërkime etnografike, Rilindja: Prishtinë.

Drita, S. (2009) Veshjet shqiptare të Kosovës, IAP: Prishtinë.

Gjergji, A. (1988) Veshje shqiptare në shekuj, IKP: Tiranë.

Rrok, Z. (1965) Mbi veshjet tradicionale të popullit tonë, Studime historike, nr. 4, ASHRPSH, Tiranë.

Sulejmani, F. (1988) Lindja, martesja dhe vdekja në Malësinë e Tetovës. Rilindja: Prishtinë

Ukë, Xh. (2005) Shtresime kulturore, IAP: Prishtinë.

BESNIK RAMETI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

VESHJET TRADICIONALE NË DERVEN TË SHKUPIT

Abstrakt

*Qëllimi kryesor i këtij punimi është të nxjerrë në shesh të vërtetën e trashëgimisë kulturore, posaçërisht **veshjet tradicionale në Derven të Shkupit ose veshjen popoulllore shqiptare në Derven të Shkupit**. Rajoni i Dervenit paraqet një tërësi të gjerë gjeografike e cila shtrihet prej Urës së Sarajt e deri në Urën e Zhelinës, ndërsa pjesa tjetër e Dervenit shtrihet përmes Luginës së Vardarit, që fillon nga Ura e Sarajt deri në fshatin Vorcë dhe Orashë e Poshtme, ku përmes kësaj krahine lidhen Shkupi me Tetovën. Krahina e Dervenit të Shkupit ngërthen në vete 24 vendbanime ose fshatra, që i takojnë Komunës së Sarajt. Ky rajon ka qenë i banuar që në lashtësi dhe për këtë dëshmojnë burimet e gjetura materiale. Gjithashtu populli shqiptar ka trashëguar veshjen tradicionale, e cila e ka historinë e vet të zhvillimit dhe është ruajtur brez pas brezi deri pas Lutës së Dytë Botërore, por për shkak të sundimeve të shumta dhe ndryshimeve kohore sot veshja tradicionale nuk përdoret nga popullata e Dervenit, por ruhet në disa familje dhe më shumë kujdesen shoqëritë kulturore – artistike dhe muzetë privatë, që kujdesen për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të veshjes shqiptare në Derven, si te burrat ashtu edhe te gratë.*

Veshja tradicionale (popullore) në Derven të Shkupit

Veshja popullore ose kostumet popullore janë tesha tradicionale të përshtatura në përputhje me veçoritë e vetë historisë së popullit shqiptar. Edhe veshëmbathja në Derven të Shkupit ka historinë e vetë të zhvillimit etnografik, ndërsa ka veshjen është karakteristike si e burrave, ashtu edhe grave. Ajo në periudha të ndryshme ka pësuar ndryshime, por në fshatrat e Dervenit është e njëjtë, me dallime të vogla.

Veshje burrash

OPINGAT – Opingat janë veshëmbathje të këmbëve, të ndërtuara nga lëkura e kafshëve të mëdha, sepse janë më të qëndrueshme. Prerja e tyre bëhet nga lëkura e gjerë, edhe atë sa për një palë opinga, bëhet shpuarja dhe vendoset apo bëhet një veg prej dredhe, më pastaj nëpër verigë e futin lidhëzën, përkatësisht ndortën, që më pastaj e lidhin për këmbë, me qëllim që të mbahet e fortë. Ndortat, që janë pjesë e opingës janë nga leshi, zakonisht nga leshi i bardhë që e tjerrin.



(Opingat)

Çorapet e burave

Çorapet e burrave, janë nga leshi i dhenve, me gjatësi deri në mes të gjurit dhe herë – herë paraqiten deri në gju, me qëllim të mbrojtjes nga i ftohti. Kur çorapet janë vetëm për veshje të rëndomtë, janë të bardhë, e në disa raste ngjyrosen me ngjyrë të zezë apo ngjyrë kafe, me qëllim për t'u mbrojtur nga pluhuri e balta.



(Çorapet e burrave, të ruajtur në fshatin Bojanë)

Tirqit

Tirqit përgatiteshin nga kashniku me ngjyrë të zezë ose të bardhë, rallë herë me ngjyrë kafe, zakonisht janë të bardhë dhe shumë të ngushtë. Tirqit, që visheshin punëtorët, ngjyroseshin me ngjyrë të zezë apo kafe. Më parë i kanë ngjyrosur me lëngun e arrave, përkatësisht me lëvoret e kokrrës së arave ose të lëngut të gjetheve të drurit të verinit (verajnit) apo verit. Me këtë lëng ngjyroseshin edhe lurka, çorapet dhe mintani.



(Fotografi e marrur nga SHKA "Dullla")



(Fotografi e marrë nga vepra e Halide Palloshit)

Mintani

Mintani si veshje e burrave bëhet nga kashniku, por më vonë edhe nga stofi.



(Fotografi e marrur nga vepra e Halide Palloshit)

Këmisha, jeleku dhe brezi

Këmisha, ka qenë e punuar nga pambuku ose mëndafshi, pa jaka, por dalloheshin ato të pleqve dhe të rinjve.

Jeleku bëhet pa krahë, rëndom me ngjyrë të zezë, i zbukuruar me pjesë pëlhure me ngjyrë të kuqe.

Brezi është mbështjellës i belit, i përbërë nga leshi dhe është i gjatë katër metra, ndërsa i gjerë 25 cm.

*(Këmisha)**(Jelevu)**(Brezi)*

Plisi i bardhë dhe marhama

Plisi ka formën e rumbullakët të cilindrit, me ngjyrë të bardhë prej leshi. Është simbol i popullit shqiptar, të cilin e mbajnë të vegjëlit dhe të moshuarit me krenari të pashoq.

Marhama është e ndertuar prej pambuku dhe të rinjtë e kanë mbajtur në qafë në tërë Dervenin.



(Plisi)



(Plisi)



(Marhama)

Lurka dhe ferexheja

Lurka është prej gune me ngjyrë të bardhë dhe më pas ngjyroset sipas dëshirës, por zakonisht me ngjyrë të zezë. Lurka e Dervenit ka karakteristika të veta dhe ndahet nga të tjerat në strukturën e saj, që

dallohet nga lurkat e provincave tjera shqiptare, sepse është më e shkurtër dhe e ngjeshur mirë mbi mintan apo këmishë.

Pas shpine të lurkës është lëshuar një palë që shërben për çdo nevojë dhe kur i lidh qoshet merr formën e gjysmëkësulës (plisit) dhe vihet mbi kokë, duke mbrojtur nga shiu, era dhe të ftohtit.

Ferexheja është prej gune, zakonisht ngjyrosët me ngjyrë të zezë dhe është e gjatë deri të zogu i këmbës. Zakonisht e mbanin kur bënë rrugë të gjatë, por edhe barinjtë dhe njerëzit e tjerë, që dalin nga shtëpie drejt punës. Edhe ferexheja vihet mbi kokë dhe mbron nga shiu, era dhe të ftohtit.



(Lurka, marrë nga vepra e Refik Krosit) (Ferexheja, marrë nga vepra e Refik Krosit)

Veshjet e grave në Derven

Veshja tradicionale ose popullore e grave në Derven të Shkupit ka qenë këmisha dhe jeleku, të cilat ishin të gjata deri mbi gjunj. Gjithashtu më vonë janë përdorur edhe dimitë.

Ato me vete kanë pasë skutaçen ose përparësen, xhaketen, boshllëkun, shaminë, tërllikun, kovrakun, çorapet dhe nallanet prej druri.

Mbulesa e grave në Derven ishte çarçafi, ndërsa disa gra përdornin ihramin.

Veshjet e grave dalloheshin sipas moshës, por kanë pësuar edhe ndryshime, varësisht edhe nga koha kur janë mbajtur.

Këto veshje janë mbajtur deri në vitet e 80–90 të shekullit XX në krahinën e Dervenit të Shkupit.



(Fotografi e marrë nga vepra e Halide Palloshit)



(Fotografi e marrë nga SHKA "Dulla")

Opingat (nallanet) dhe çorapet

Në këtë foto janë paraqitur opingat e grave, të ndërtuara nga lëkura e kafshëve por janë përdorur edhe nallanet prej druri.

Çorapet, janë punuar në vekë prej leshi dhe kanë pasur ngjyrë laramane, por edhe figura të ndryshme.



(Opingat (nallanet) dhe çorapet)

Këmisha, jeleku dhe skutaçja

Këmisha ose mintani është punuar nga pambuku, por edhe prej mëndafshi me ngjyra të ndryshme. Te gratë është veshje numër një, sepse zakonisht mbulon tërë trupin, ka krahë të gjata. është e hapur në gjoks e qafë, që të vishet më lehtë dhe shkon deri te zogu i këmbës.

Mbi këmishë veshin jelekun e gjatë që mbërrin deri në lakun e këmbës dhe është i hapur përpara dhe nën të veshin stroncin që është i thjeshtë, por e mban jelekun bukur, pasi stronci kap belin dhe shkon poshtë, ndërsa nuk ka zbukurime, meqë nuk duket. Jeleku ka shiritin e zbukuruar me ngjyra të ndryshme, sidomos vajzat e rritura kanë shirit të zi, ndërsa nuset me ngjyra, mbi të veshin jelekun e shkurtër, që po ashtu është i hapur dhe mbërthehet me një shirit të zbukuruar, që mban jelekun e gjatë, këmishën dhe trupin së bashku.

Gratë përpara veshin skutaçen (përparësen), që e mbajnë të gjitha gjeneratat, por dallohen mes tyre dhe quhen: skutaçe vajzash, grave

e nuseve. Skutaçet e nuseve janë me ngjyra dhe zbukurime tjera. Skutaçet kanë edhe emrat e tyre: skutaçe dagmare, me shishe etj.



(Këmisha, keleku dhe skutaça, fotografi e marrë nga vepra e Refik Krosit)

Shamia

Shamia është prej mëndafshi ose pëlhure, me ngjyra të ndryshme, gjë që varet nga mosha.



(Shamitë)

Dimitë

Dimitë e vajzave, plakave dhe nuseve. Dimitë, më të mira, si bie fjala të nuseve janë me më shumë pala dhe material për përgatitjen e tyre arrin në 12, madje edhe 14 metra. Dimitë e nuseve janë me ngjyra të ndryshme e të hapura, ndërsa të vajzave e grave me ngjyrë të mbyllur. Dimitë lidhen në bel e shkojnë deri të zogu i këmbës, ku ngushtohen dhe zbukurohen me gajtan. Lidhen me lidhëze të gjatë, të vejtur nga pambuku dhe në qoshe janë të zbukuruara me ngjyra të ndryshme. Gratë më të moshuara veshin këmishë prej pambuku, ndërsa nuset e vajzat veshin këmishë nga mëndafshi, të vejtura në avlimente dhe kanë zbukurime me oja apo diçka tjetër. Mbi këmishë veshin jelekun e shkurtër, por të zbukuruar, sidomos të këtilla duken veshjet e nuseve në Derven të Shkupit.



(Fotografi e marrë nga vepra e Halide Palloshit)

Shoqëritë kulturore – artistike në Derven të Shkupit

Shoqëritë kulturore artistike në Derven janë themeluar pas viteve të 90 – ta, me qëllim që të kujdesen dhe të ruhen traditat e identitetit shqiptar në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu edhe për ruajtjen e valleve dhe këngëve, ndërsa veshjet tradicionale tu trashëgojnë gjeneratave të reja në vend.



(Fotografi rre marra nga SHKA "Duflla")

Në Derven veprojnë këto shoqëri kulturore – artistike

- SHKA “Drita e Dervenit” – Saraj
- SHKA “Shqiponjat” – Krushopek
- SHKA “Duflla” – Raçe



(Foto e SHKA Dufllës, në emisionin Tradita)



(Foto e SHKA Dufllës, në emisionin Konaku)

Përfundim

Veshja tradicionale e Dervenit të Shkupit, që nga lashtësia deri në vitet e 90-ta të shekullit XX është ruajtur në fshatra, por për fat të keq shekulli XXI ka zhdukur këto veshje popullore të shqiptarve të Dervenit. Këto veshje vishen vetëm në ceremonitë martesore ose nga grupet e valltarëve.

Duhet ta kultivojmë dhe t'a ruajmë këtë veshje, sepse e kanë veshur të parët tanë dhe kanë treguar identitetin e vet përmes veshjes.

Literatur e shfrytëzuar

- Abedin Krosi, “*Gjurmë e Të Kaluarës Shqiptare në Dërven*”, Shkup, 1995.
- Baki Bakiu, “*Derveni i Shkupit ndër shekuj*”, Shkup 2011.
- Bukuriye Mustafa, Izaim Murtezani, Rini Useini, “*Gjurmëve të Veshjes Popullore Shqiptare në Maqedoni*”, Shkup 20017.
- Nebi Dervishi, “*Etnokultura e Fushëgropës së Ohrit*”, Tetovë, 2005.
- Halide Palloshi, “*Eksponatat të etnografisë shqiptare në Maqedoni* (Album)”, Shkup, 2010.
- Refik Krosi, “*Muzeu arkeologjik dhe etnologjik “KROSI” në Derven të Shkupit*”, Shkup, 2014.
- Xhelal Jakupi, “*Komuna e Sarajt, 2000–2004*”, Shkup, 2004.
- Xhemaludin Idrizi, “*Mikrotoponimet e Dervenit të Shkupit*”, Shkup, 2019.

IDAETE SINANI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

VESHJET TRADICIONALE TË GRAVE NË FSHATIN KRUSHOPEK TË SHKUPIT

Abstrakt

Veshjet e grave janë pjesë e trashëgimisë kulturore të një populli. Gjatë studimit të tyre, duke analizuar strukturën lëndore, motivet në punimet e tyre, qëndisjet, ornamentikën dhe koloritin e ngjyrave, lidhemi me të kaluarën, gjejmë gjurmët e besimeve të lashta pagane, mësojmë më shumë për traditat, zbulojmë imagjinatën e bujshme të femrës shqiptare dhe shumë elemente tjera që paraqesin prova të lashtësisë.

Në punim kemi trajtuar veshjet tradicionale të grave në fshatin Krushopek të Shkupit, fshat me prejardhje nga krahina e Rekës së Epërme të Gostivarit. Veshja që kemi paraqitur në punim nuk ka funksionin që kishte dikur si veshje e përditshme, por përdoret vetëm në raste solemne. Punohet nga duart e vetë grave të fshatit, ruhet dhe trashëgohet brez pas brezi vite me radhë.

Qëllimi dhe synimi kryesor i këtij punimi është mbledhja dhe regjistrimi i kësaj pjese të trashëgimisë kulturore, e cila rrezikon të zhduket e të harrohet.

Fjalë çelës: *Veshje, kulturë, tradicionale, popullore, Krushopek etj.*

Specifika etnike e një populli, përcaktohet nga një varg manifestimesh të kulturës materiale dhe shpirtërore të tij. Veshja, nga roli i

saj i dobishëm dhe funksioni që kryen, përbën një nga elementet më të rëndësishme të kulturës materiale. E parë nga elementet e zbukurimit që ajo përmban, nga format artistike që merr, nga roli dekorativ që luan, ajo përbën edhe një element të çmuar estetik, duke u integruar kështu në kulturën shpirtërore si pjesë përbërëse e artit popullor. Pra, nga çdo pikëpamje që ta shohim, veshja mbetet një nga manifestimet më të fuqishme të kulturës popullore dhe për këtë arsye, studimi i saj kontribuon për të ndriçuar disa aspekte me interes në historinë e çdo populli.¹⁰

Veshjet e grave përbëjnë një prej trashëgimive të kulturës së një populli dhe ato shpesh janë prova të lashtësisë, traditave dhe organizimit shoqëror të një vendi. Në motivet e tyre mund të gjenden gjurmët e besimeve të lashta pagane e të qytetërimeve të reja. Procesi i realizimit të tyre bën të mundur të kuptohet mënyra e jetesës së një populli. Kështu këto veshje kthehen në copëza të dokumentarit jo gjithnjë të plotë të historisë së popujve.¹¹

Trashëgimia jonë kulturore e shpirtërore, dita–ditës po rrezikohet të na ikë prej dore. Brezat më të vjetër po largohen nga kjo botë duke marrë me vete pjesë të pashkruara e të pa dokumentuara nga thesari i kulturës sonë.

Edhe pse nuk jam specialiste në fushën e etnografisë, për të dhënë një ndihmesë sado modeste, për të shpëtuar një pjesë sado të vogël të trashëgimisë së kësaj fushe, vendosa të bëj një punim lidhur me veshjen tradicionale të grave në fshatin Krushopek të Shkupit.

Jam vetë me prejardhje nga ky fshat, prandaj edhe këtë punë mund ta bëj më mire se kushdo tjetër që është nga jashtë pasi që kalimtari

¹⁰Andromaqi Gjergji, *Veshjet shqiptare në shekuj*, ASHSH, Tiranë, 2005, f. 7.

¹¹EdibeSelimi Osmani, *Veshja autoktone e femrave të Rekës së Epërme*, Tetovë, 2012, f.6.

i huaj apo fqiu nuk mund ta njohë shtëpinë e dikujt më mirë se vetë pronari. Jam rritur e rrethuar me gra që mbanin këtë veshje. Ende i kam të freskëta kujtimet kur si fëmijë u ndihmonim grave të familjes në endjen e penjve që bënin gati për të punuar në vegjë pjesë të kësaj veshje kombëtare. Jam rritur duke e veshur nëpër dasma e raste tjera solemne këtë veshje kombëtare. Sot me një përkujdesje të madhe, ruaj të trashëguar nga familja këtë veshje mjaft me vlerë. Pjesët e veshjeve që do të shihni në fotot e punimit, pothuajse të gjitha janë trashëgimi e familjes sime.

Dy tri fjalë për Krushopekun

Sa për të krijuar një pasqyrëpërlexuesit dhe studiuesit që nuk kanë informata rreth këtij vendbanimi të lartpërmendur, do të jap disa të dhëna më me rëndësi.

Fshati Krushopek shtrihet në pjesën jugperëndimore të fushëgropës së Shkupit, përreth lumenjve Treska dhe Vardar. Gjendet në lindje të Dërvenit, afër fshatrave Nerez, Gërçec dhe i takon Komunës së Sarajit. Banorët e Krushopekut, janë me prejardhje nga Reka e Epërme e Gostivarit. Kur u detyruan të shpërngulen nga vatrat e tyre, ata me vete nuk morën plëng e shtëpi, por gjuhën, doket dhe zakonet i ruajtën me fanatizëm dhe i përcollën brez pas brezi.¹²

Banorët e Krushopekut, krahas dialektit specifik të Rekës dhe veçorivetë tjera kulturore, njihen edhe për nga ruajtja e veshjeve tradicionale kombëtare. Veshjet tradicionale të grave në fshatin Krushopek, nuk janë ato që dikur kishin veshur në trojet e lashta të stërgjyshërve të tyre, në Rekë të Epërme.

¹² Idaete Sinani, *Studime Albanologjike* 19, Shkup, 2019, f. 53.

Sikurse edhe veshjet tjera popullore që janë zhvilluar dhe kanë ndryshuar vazhdimisht nga një epokë në tjetrën, edhe veshja e Rekës së Epërme, si rezultat i kushteve historike, ekonomike e shoqërore, u transformua në një veshje të re në vendbanimet e reja të rekasve të shpërngulur.

Në bazë të klasifikimit të përgjithshëm të veshjeve të grave në Maqedoninë e Veriut, veshja e grave e fshatit Krushopek, bën pjesë në grupin e veshjeve të tipit me **këmishë të gjatë dhe jelek pa mëngë**, në dallim nga grupet e veshjeve tjera që janë me **këmishë dhe anteri** dhe me **brekushe**. (ky tip i veshjeve ndeshet edhe Çiflik, Setapetkë, Alldincë si dhe në disa fshatra tjerë të rrethit të Shkupit.

Pjesët kryesore të kësaj veshjeje janë: **Këmisha e gjatë**, me mënge te gjata, te gjera ose te ngushta; **Jelevu**; **Brezi**, **Përparësja**, **Kollani**, **Gjukëslleku**, **Shamia**, **Çarshaf** dhe **këpucët**.



Foto 1. Veshja tradicionale



Foto 2. Jelevu

Jelevu është pjesa kryesore dhe më e rëndësishmja e kësaj veshje. Pjesa e jashtme e jelekut është prej materiali të mëndafshhtë me ngjyrë të kuqe (allaxhë jeleki), me vija të bardha të gjera ose të ngushta. Pjesa e brendshme qepet prej materialit të patiskut të bardhë, ndërsa brendia mbushet me pambuk. Jeleku zakonisht është i gjatë deri në gjunjë dhe i hapur përpara. Në pjesën e jakës, pjesët e përparme dhe fundi, zbukurohen me shirita të ndryshëm ngjyrë ari dhe argjendi. Këto jelekë janë qepur për nuset. Vajzat, gratë më në moshë dhe plakat, kanë veshur jelekë më pak të zbukuruar dhe me ngjyra më të errëta. Kur krahasohen jelekët më të vjetër me këto të ritë, mund të shihet se sot janë më të ngarkuar me zbukurime pasi që vishen vetëm për raste solemne, në dallim nga e kaluara kur ato ishin pjesë e veshjes së përditshme.

Në të kaluarën për shkak të sëmundjeve të shumta vdekjeprurëse, nuset e dobëta konsideroheshin të sëmura. Prandaj kur kërkohej nuse për djalë, e shihej a është e shëndoshë, dhe e madhe. Nuset e dobëta, për tu dukur më të shëndosha, nën jelekun e mirë, vishnin edhe nga një jelek më të vogël, çul, me arna. Këto jelekë bëheshin me materiale të vjetra dhe shërbenin si veshje nën jelekun e mirë.¹³



Foto 3. Përparësja (Skutaçja)

Edhe **përparësja** është pjesë e rëndësishme e kësaj veshje popullore. Zakonisht është e punuar nga materiali i leshtë dhe në vegjë. Kombinimi i ngjyrave dhe motivet e shumta në këto punime, nxjerrin në pah imagjinatën e pasur,

¹³ Arife Ebipi (1955), f.Krushopek, Shkup. Interviste e realizuar nga Idaete Sinani më 28 prill 2020.

shkathhtësinë dhe ndjenjat estetike të gruas së kësaj ane. Përparëset e nuseve janë punuar duke kombinuar ngjyra të ndryshme, ndërsa të grave në moshë, me ngjyra më të errëta.



Foto 4. Këmisha (këmisha)

Këmisha është qepur prej pëllhurës e cila paraprakisht është endur dhe punuar në vegjë nga fijet e mëndafshit të fituar nga bubat e mëndafshit dhe fijeve të holla të pambukut. Kjo këmishë ka një prerje në grykë, është pa jakë, me krahë të gjerë dhe fund jo shumë të gjerë. Qëndiset vetëm pjesa e grykës dhe krahët. Punimet bëhen me rruaza dhe aspra duke përdorë lloje të penjve dhe rruazave shumëngjyrëshe. Ky lloj i këmishave dedikohet

për nusët dhe gratë e reja, ndërsa gratë më në moshë vishnin këmisha më pak të qëndisura dhe me mëngë në fund.



Foto 5. Brezi

Në të kaluarën **brezi** ka qenë pjesë e pandashme e veshjes së gratë. Me kalimin e kohës, kur kjo veshje e humbi funksionin si veshje e përditshme, dhe përdoret vetëm për raste solemne, brezi nuk përdoret dhe është zëvendësuar me kollanë të ndryshëm. Është punuar kryesisht në vegjë

me fije leshi të tjerrura hollë. Edhe gjatë punimit të brezit nuk kanë

munguar kombinimi i ngjyrave dhe motivet e shumta. Gjatësia e brezit arrin gjatësinë deri në 3 metra.¹⁴



Foto 6. Çorapet

Edhe për thurjen e **çorapeve**, si lëndë e parë është përdorur leshi. Në punimet e çorapeve, ekziston një ornamentikë dhe kolorit i shumëllojshëm i ngjyrave.

Janë punuar me kërrabëza duke përdorur fjetet e tjerra hollë të leshit me ngjyra të ndryshme dhe fijeve të telit dhe sermit. Për nusët dhe

gratë më të reja punimet dhe ngjyrat kanë qenë të shumta, ndërsa gratë në moshë kanë mbathur çorape me ngjyra më tëvarfra dhe punime më të thjeshta¹⁵



Foto 7. Marhama (Marhoma)

Marhama bëhet nga pëllhura e endur në vegjë e punuar nga pambuku dhe mëndafshi. Edhe në skaje edhe në pjesën e brendshme të marhamës janë punuar zbukurime me qëndisje. Qëndisja është bërë me fije mëndafshi dhe fije ari, duke fituar motive të

¹⁴ Fazile Halili (1945), f. Krushopek, Shkup, Interviste e realizuar nga Idaete Sinani, më 10 qershor 2020.

¹⁵ Çorapet janë dhuratë për autorën nga kushërira, Nafie Iljazi, f. Krushopek, Shkup, të trashëguar nga e ëma.

ndryshme. Marhama të tilla kanë shërbyer për dekor por edhe për të mbuluar pjesën e poshtme të fytyrës të gratë kur kanë ecur rru-gës.¹⁶



Foto 8. Kollani (Kallani)

pjesë të kollanit, janë edhe paftelet, një element zbukurues që vendosen në skajet e kollanit dhe shërbejnë për tu mbërthyer. Këto zbukurime janë metale me vlerë si argjendi, dhe trashëgohen nga gjenerata në gjeneratë.¹⁷



Foto 9. Çarçafi (Çarshafi)

Edhe **kollanët** janë punime të vetë grave të cilët punohen enkas për veshjen tradicionale. Siç shihet edhe nga fotoja, kollani është i punuar me rruaza të imëta duke formuar motive të luleve. Gjatë punimit të kollanëve përdoren motive të ndryshme të luleve. Si

Çarçafi është mbulesë e vejtur me fije pambuku dhe mëndafshi. Në të kaluarën ka shërbyer si mbulesë për nusen që ka qenë e veshur me veshje tradicionale. Për shkak se veshjet tradicionale janë të trasha dhe pamundësojnë

¹⁶ZedinEbipi (1949), f. Krushopek, Shkup, Interviste e realizuar nga Idaete Sinani, më 10 qershor 2020.

¹⁷ Mamudije Berisha (1968), e lindur në Krushopek, Shkup, Interviste e realizuar nga Idaete Sinani, më 27prill 2020. Kollanin e ka trashëguar nga nëna e ndjerë, FerideEbipi, f. Krushopek, Shkup.

veshjen e mbulesës normale, gratë për të mos dalë rrugës ashtu të zbukuruar, kanë hedhur mbi kokë çarçafin i cili i ka mbuluar deri në pjesën e poshtme të veshjes. Më vonë janë përdorur çarçafë që janë blerë të gatshëm në Turqi. Një çarçaf i tillë është çarçafi që kemi dhënë në foto.



Foto 10. *Këpucët e llastikut (jemeniat)*

Femrat pasi kanë veshur çorapet e leshta, kanë mbathur opinga, jemenia ose këpucë. Opingat janë mbathur në kohërat më të hershme. Më vonë duke i transportuar nga Turqia, kanë filluar të përdorin mbathjet si në foto. Këto janë quajtur *jemenijallastiki* ose *llastike për gra*.


Kohëve të fundit, kur veshja tradicionale po ruhet dhe përdoret vetëm nëpër dasma, gratë veshin këpucë moderne që janë në trend me kohën.



Motive të ndryshme të punimeve



Zbukurime



PËRFUNDIM

Duke i paraqitur lexuesit rezultatet e punës në terren, në këtë punim jam përpjekur të jap një kontribut të përmasave modeste, e ndërgjegjshme se kërkimet e mia nuk mund të krahasohen me kërkimet dhe gjurmimet e ekspertëve të fushës, prandaj do të

mirëprisja çdo vërejtje dhe sugjerim të dobishëm nga etnologë e etnografë. Sidoqoftë, shpresoj që ky punim të jetë një pikënisje dhe udhërrëfim për kërkime dhe hulumtime të reja.

LITERATURA E KONSULTUAR:

Osmani –Selimi, Edibe, *Veshja autoktone e femrave të Rekës së Epërme*, Tetovë, 2012.

Gjergji, Andromaqi, *Veshjet shqiptare në shekuj*, ASHSH, Tiranë, 2005.

Mustafa, Bukuriye, Murtezani, Izaim, Useini Rini, *Gjurmëve të veshjes popullore shqiptare në Maqedoni*, Shkup, 2017.

Useini, Rini, *Veshja popullore shqiptare në trevën e Strugës*, Shkup, 2018.

https://sq.wikipedia.org/wiki/Veshjet_tradicionale_shqiptare

<http://odeacademy.org/veshjegra>

<https://veshjettradicionale.weebly.com/trevat.html>

AFED JASHARI

Ministria e Kulturës

VENDBANIMET E KARSHIAKËS QË KANË RUAJTUR VESHJET POPULLORE

Si shumë vendbanime tjera shqiptare, edhe vendbanimet e rajonit të Karshiakës së Shkupit kanë ruajtur veshjet e tyre shumë ngjyrëshe dhe sende tjera të përdorimit të përditshëm si për shembull (shtroje e mbuloje, pajisje djepi, veshje për gra dhe burra etj., që tregojnë se ka një shkallë të zhvilluar të ndjejnave estetike, të cilat përgjatë zhvillimit historik kanë ardhur duke u përpunuar gjithnjë e më shumë. Sa më të hershme janë pjesët e veshjeve, sidomos veshjet e venbanimeve Patishka Rekë, Maja e Zezë (Crnivër), Çiflik, Sata Petkë etj., aq më pak ngjyra janë përdorur për zbukurim. Në të shumtën e rasteve për zbukurimin e tyre mund të jenë përdorur ngjyrat natyrore të leshit të deles (e bardhë dhe e zezë) ose ato të leshit të dhisë (e bardhë, e zezë, e kuqe).



Çorape të punuara me dorë dhe disa veshje tjera nga veshjet e Karshiakës



Veshje grash të ruajtura nga familja Jakupi nga fshati Çitlik – Karshiakë

Ngjyrosjet kimike janë shfaqur në një periudhë të mëvonshme, ashtu si në të gjitha vendbanimet tjera dhe në vendbanimet e Karshiakës së Shkupit kanë filluar një sistem të ri të ngjyrosjes në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit XIX.¹⁸ Ngjyrosjet kimike janë shfaqur në një periudhë të mëvonshme, ashtu si në të gjitha vendet

¹⁸ Etnografia shqiptare nga Aferdita Onuzi me temë :Përdorimi i ngjyrosjeve natyrore dhe kimike ne tekstilet popullore, 1989 ,Tiranë

tjera ballkanike, edhe në vendin tonë kanë hyrë gjërësisht nga dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit XIX, ndërsa siç dihet bojërat me bazë aniline janë përdorur në industrinë e tekstile rreth vitit 1870.



Ekspozita personale në vitin 2014 me veshjet tradicionale nga Karshiaka në Kurshumli Han

Përdorimi i ngjyrave në tekstilet e ndryshme të punuara nga populli përveç funksionit estetik shprehin edhe momentet e jetës si gëzimet, hidhërimet, moshën, gjendjen shoqërore etj. Ngjyrat e gjalla ishin veshje për dasma e gëzime tjera familjare. Ngjyrat shërbenin për të treguar gjendjen shpirtërore të bartësve, si dhe për të treguar edhe moshën apo gjendjen shoqërore. Për veshjet e vajzave janë përdorur kryesisht ngjyrat neutrale. Bukuria, estetika, laramania e ngjyrave të harmonizuara me mjeshhtërinë e hollë të krijesit popullor në dizajnimin – ornamentin dhe plasimin e

ambientit jetësor shqiptar me të gjitha begatitë e jetës me bukurin fizike të shqiptarit gërshtuar me ato të natyrës – ambientit ku ai jeton – qëndron e gjallëron përball stuhive të shumta të jetës – kostumet kombëtare janë ditari më i mirë që flasin për rrjedhën e jetës – historisë së bujshme shqiptare me të gjitha baticat dhe zbaticat e jetës nëpër mijëvjeçarët e tij të ekzistencës në trojet e tij etnike.¹⁹ Veshjet popullore, muzika, tradita, vallëzimi popullor etj., kanë bashkëjetuar me mjeshtëritë e ndryshme të arteve të zbatuara, përmes të cilave janë krijuar edhe kostumet dhe tekstilet aq të pasura në modele, ngjyra e dekorime. Veshjet në rrafshin historik ruajnë veçori autentike të trashëguara nga një nënshtresë kulturore të fiseve ilire që kanë jetuar në trojet e sotme të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, duke përfutur nga veshjet tradicionale shqiptare edhe popujt tjerë vlera të veçanta.

Kostumet popullore dhe tekstilet nga vendbanimet shqiptare të rajonit Karshiakës, e kryejnë funksionin e tyre shoqërore edhe përmes strukturave artistike, të cilat janë shprehje e botës shpirtërore të malësorëve për ngjarje të ndryshme të jetës, sidomos në dasmat e tyre.

Përjetime kolektive me veshje tradicionale në Karshiakë

Përjetimi i gëzimit kolektiv në dasmë përcillet me muzikë, vallëzime e lojëra të ndryshme popullore. Përveç këngëve që janë përcjellë nëpër ceremoni dhe rite të ndryshme në fshatarat sidomos Patishka Rekë dhe Maja e Zezë janë përfshirë gati të gjithë, sidomos femrat, të cilat kanë bartur veshje me ngjyra dhe dekorime.

¹⁹ *Veshjet popullore shqiptare në Maqedoni 2005, Shkup*



Trashëgimia e veshjeve tradicionale dhe fshatrat që i kanë ruajtur në Karshiakë

Dasma shqiptare nuk ishte thjesht ceremoni festive popullore, por këto preokupime infiltrohen edhe te dekori i kostumeve popullore. Përballë nuses me ngjyra dhe zbukurime, dasmorët ngjanin solemnë me veshjet e tyre tradicionale.

Funksioni shoqëror i kostumeve popullore zbulohet edhe te dallimet në ngjyra dhe në zbukurime sipas grupmoshave të bartësve. Në fshatrat e Karshiakës, veshjet e fëmijëve dhe të rinjve, dallohen nga ato të nuses dhe të atyre më të moshuarve. Kostumet e nuseve ose veshjet nusërore dallohen pasi janë plot ngjyra e zbukurime, si për shembull ngjyra e kuqe dhe e verdhë kanë qenë më të pëlqyera. Kurse te veshjet e të moshuarve dallohen ngjyrat më të erëta. Ngjyrat dhe dekorimet e pakta të veshjeve për të moshuar dhe për fëmijë japin pamje të përmbajtura.

Përfundim

Estetika e veshjeve tradicionale përbën një lloj ligjësie të përgjithshme për çdo vendas, pavarësisht nga gjendja e tij ekonomike. Kostumet popullore, deri në vitet e 90-ta sidomos në fshatin Patishkë dhe Maja e Zezë ishte obligim i veçantë i të gjithëve sidomos i grave. Por sot duke pasur parasysh shpërnguljen e shumë vendasve nëpër qytete dhe fshatra më të rrafshta, sidomos në Studeniçan dhe Batincë ky rregull ka filluar të mos zbatohet, ndërsa gratë që jetojnë ende nëpër këto vende malore të Karshiakës i bartin në jetën e përditshme. Sot ka familje që këto veshje ende i ruajnë, si për shembull familja Ejupi nga fshati Patishka Rekë, familja Baftjari nga fshati Maja e Zezë dhe familja Jakupi nga fshati Çiflik. Këto dhe shumë familje tjera i ruajnë veshjet tradicionale, si vlera të përkatësisë kombëtare, ndaj i ruajnë me vetëdije dhe përgjegjësi të plotë. Një sakrificë e tillë konsiderohet si normë tradicionale, zakon, ligj, detyrim shpirtëror, së cilës edhe sot e kësaj dite nuk mund t'i shmangen lehtë. Duke qenë kaq e shtrenjtë dhe e çmuar me vlera materiale dhe vlera shpirtërore, veshjet popullore edhe sot e kësaj dite në fshatrat malore të Karshiakës, është shenjë e dashur e përkatësisë kombëtare, me të cilën lidhen lindja dhe vdekja, ëndërrat, e kaluara dhe e ardhmja e tyre sidomos te ata që janë më të moshuar.

Shprehja estetike e dekorimeve popullore nuk jepet me skema të fiksuara kompozicionale dhe me ngjyra e ornamente të përcaktuara, por ndryshon sipas funksionit praktik e shoqëror të objekteve ku është zbatuar.

Veshjet tradicionale dhe tekstilet e fshatrave nuk janë objekte relikte të nxjerra prej një garderobe të hershme që përdoren vetëm në ceremoni të mirëfillta folklorike, por përdoren edhe sot në shfaqjet e

folklorit bashkëkohor në fshatrat e fshatit Maja e Zeze, Patishka Rekë, Çiflik, madje pjesërisht edhe në jetën e përditshme, si për shembull në fshatin Maja e Zezë (**banorët që ende jetojnë në këtë fshat**).

Në përgjithësi, veshjet e këtij rrethi të kënaqin me bukurinë mahnitëse të laramanisë së pasur në harmoninë e papërshkrueshme të ngjyrave, që paraqet edhe një hallkë në koloritin përrallor të kostumografisë shqiptare.



Ekspozita personale në vitin 2014 me veshjet tradicionale nga Karshiaka në Kurshumli Han

Burimet:

- Etnografia shqiptare nga Aferdita Onuzi me temë: Përdorimi i ngjyrove natyrore dhe kimike në tekstilet popullore, 1989, Tiranë
- Veshjet popullore shqiptare në Maqedoni 2005, Shkup
- Familja Ejupi (Patishka Rekë) , Familja Jakupi (Çiflik), Familja Baftjari (Maja e zezë)–Karshiakë
- Ekspozita personale e realizuar më 2014 me veshjet tradicionale të Karshiakës në bashkpunim me familjet që kanë ruajtur veshjet tradicionale

MINIR ADEMI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

VESHJA POPULLORE SHQIPTARE NË TREVËN E KARADAKUT TË KUMANOVËS

Abstrakt

Trashëgimia kulturore e historike e të kaluarës së një etnie, e në veçanti e veshjes tradicionale kombëtare shqiptare në trevën e Karadakut të Kumanovës, duhet të ruhet dhe të mos lihet pas dore dhe padyshim që duhet t'i jepet vendi i merituar në shoqëri.

Etnologjia si shkencë ka për detyrë ta studiojë dhe ta ruaj çdo element të kulturës popullore e në veçanti atë të veshjes, që të mos zhduket pa gjurmë nga jeta bashkëkohore. Prandaj edhe hulumtimi i punimit tim ka të bëjë me veshjet tradicionale shqiptare të ruajtura si nga popullata e anës së Karadakut të Kumanovës, po ashtu edhe nëpër institucione, siç janë muzetë.

Në këtë punim do t'i paraqes disa nga faktorët e rëndësishëm që determinojnë ruajtjen e veshjes popullore. Në Maqedoninë e Veriut, e posaçërisht në trevën e Karadakut të Kumanovës e Likovës, edhe pse njafat pak, por ende ruhen veshje tradicionale popullore shqiptare, që përfaqësojnë një mozaik të vërtetë nga disa lloje veshjesh të rralla popullore, në mersin e të cilëve dallohet ajo e gruas.

Fjalët çelës: *Trashëgimia, veshje, Karadak, popullore.*

Etnologjia si shkencë humanitare, në një këndvështrim të gjerë, flet shumë për shoqërinë dhe shkallën e zhvillimit të saj. Etnologjia i hulumton dhe studion të gjitha format e veshjeve si të gjinisë mashkullore dhe asaj femrore. Përmes etnologjisë kemi mundësi të njohemi përveç me kulturën tonë popullore etnike, me thesarin etnokulturor, me identitetin e një populli i cili ruhet mu përmes veshjeve dhe elementeve tjera popullore kombëtare. Në studimet në fushën e etnologjisë përveç karakterit teorik, kemi edhe atë praktik ku përmes veshjeve kuptojmë jetën e njerëzve, artin, kulturën, traditën, njëdysin, veprimtarinë dhe funksionin e tyre.

Veshja në përgjithësi është pjesë e të mirave materiale, të cilat janë të domosdoshme për jetën e njeriut. Ajo ka lindur në paleolitin e vonshëm, në fillim të rendit gjinor. Pikësynimi fillestar dhe kryesor i veshjes ishte mbrojtja e trupit të njeriut nga faktorët e dëmshëm klimatikë dhe faktorëve të tjerë të jashtëm. Në këtë periudhë veshja ishte element i nevojshëm e i domosdoshëm, ndërsa më vonë veshja si dhe veshëmbathja popullore në përgjithësi, shprehet në kompozicionin stilistik të tyre, ashtu edhe në numrin dhe llojllojshmërinë e veshjeve dhe zbukurimin e tyre.

Specifika etnike e një kombi është ruajtje e kulturës materiale dhe shpirtërore. Në këtë kontekst, veshja me të gjitha vlerat e saja ekspresive paraqet një nga format më të rëndësishme të kulturës materiale.²⁰ Në shkallë të caktuar të zhvillimit të saj veshja paraqet dallime sipas stinës, moshës dhe profesionit të bartësit. Me kohë në të janë pasqyruar dallimet sociale–klasore dhe përkatësia etnike. Përveç veshjeve tradicionale, çdo etnos ka edhe veshjet kombëtare.

²⁰ Rini Useini, Veshjet popullore shqiptare në trevën e Strugës, Shkup, 2012, fq. 57

Veshja kombëtare shqiptare në zanafillë të hershme vendase u përdorë përgjithësisht në fshatra e pjesërisht në qytete deri në fillim të shekullit XX. Klasifikimi është bërë në bazë të ecurisë së zhvillimit të veshjeve popullore në vitet e hershme të shekullit XX.

Siç dihet, veshjet e meshkujve klasifikohen në pesë lloje kryesore, si: veshje me fustanellë, veshje me këmishaë të gjatë dhe dollamë, veshje me tirq, veshje me brekushe dhe veshje me poture. Ndërsa, veshjet e femrave janë të grupuara në pesë lloje si: veshje me xhubletë, veshje me këmishë të gjatë dhe një përparëse, veshje me këmishë të gjatë dhe dy përparëse, veshje me mbështjellës dhe veshje me brekushe.²¹

Veshja ka rëndësi të madhe historike për çdo etnos, prandaj kërkimi dhe hulumtimi i veshjeve tradicionale shqiptare në regionin e Karadakut të Kumanovës, ka rëndësi të veçantë në hulumtimin tim etnografik, brenda përkufizimit gjeografik të Maqedonisë së Veriut. Disa veshje që kemi arritur t'i hulumtojmë në mesin e disa familjeve që me dashuri shumë të madhe kanë arritur t'i ruajnë ato veshje, e sidomos gjinia femrore e anës së Karadakut të Kumanovës. Dy gra që kanë jetuar gjatë në këto treva, lokja Azbije dhe lokja Ramize, vetë i kishin përdorur disa nga mbështjellëset që i kemi gjetur tek familjet e tyre, si dhe disa këmisha që iu kishin dhënë për kujtim vajzave të tyre. Disa prej atyre veshjeve i kam hasur edhe në Muzeun e Kumanovës.

Në vijim i po prezantojmë dy lloje të veshjeve popullore për gra, të ruajtura në trevën e Karadakut të Kumanovës. Bëhet fjalë për një këmishë dhe një pale dimija (shalije) të zeza, të cilat kanë qenë

²¹ Gjergji Andromaqi, Veshja shqiptare në shekuj: origjina, tipologjia, zhvillimi, Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Instituti Kulturës Popullore, Tiranë, 2005, fq.112

pronë e Sihane Shaqiri Mamuti nga fshati Brezë, e lindur në vitin 1933, e martuar në Shkup. Këto veshje ia ka dhuruar vajzës së motrës, Zemile Kamberi Ebibi nga Kumanova, e cila edhe sot i ruan me kujdes të veçantë, si shenjë kujtimi e trashëgimie nga tezja.



Këmishë për nuse, e përbërë prej materialit të mëndafshhtë, e zbukuruar me oja rreth qafës dhe duarve. Gjatsia e këmishës është 55 cm, ndërsa gjatësia 61 cm.

Zakonisht vishej bashkë me dimijat e zeza me lule.



Dimitë – apo ndryshe i kanë quajtur edhe shalije të zeza, prej pambuku, me lule, me gjatësi prej 103 cm dhe gjerësi prej 240 cm.

Popullata e anës së Karadakut të Kumanovës fare pak ndryshon edhe nga pjesët e tjera të viseve ku jetojnë shqiptarët në Ballkan, ku institucionet shtetërore nuk kanë arritur ta trajtojnë trashëgiminë kulturore të popullit shqiptar nga këto vise, e cila pasuri kulturore rrezikohet edhe të zhduket.

Institucioni nacional Muzeu i Kumanovës, përmes etnologëve ka arritë të mbledh disa lloje të veshjeve shqiptare në trevën e Karadakut të Kumanovës, që janë trashëguar nga të parët tanë. Disa nga këto veshje që ruhen sot në këtë institucion, janë në një gjendje të mjerueshme, jo nga ruajtja e tyre me shumë kujdes, por nga ana e institucionit që nuk arrinë që së paku t'i ekspozojë si veshje për

vizitorët, që të njoftohet edhe popullata e nacionaliteteve tjera që jetojnë në një shoqëri multi-kulturore dhe multi-konfesionale që të kenë bile pak njohuri edhe me të kaluarën dhe veshjet tradicionale shqiptare të kësaj ane. Disa nga këto veshje kanë qenë mjaft të vjetruara, por të ruajtura me një dashuri të madhe nga të moshuarit që përmbajnë vlerë dokumentare dhe emocionale siç është rasti me loken Azbije Iseni, e cila ka kaluar një shekull jetë dhe me dashurinë më të madhe rrëfen dhe i kujton ditët kur i kishte veshur shalijet e zeza me lule dhe mëshallakun (mbështjellësen) prej leshi që ia kishte prodhuar nëna e saj në tezgjah (veg). Shumë prej këtyre veshjeve janë të vjetra, duke pasur parasysh se janë trashëguar nga vjehrrat. Kjo trashëgimi kulturore e veshjeve në anën e Karadakut të Kumanovës ka rëndësi të madhe historike për të kaluarën e cila shkon drejt harresës dhe zhdukjes ku do të jetë një goditje e madhe e etnografisë shqiptare të kësaj ane dhe të etnosit shqiptar në përgjithësi.

Veshja popullore, si një pjesë shumë e rëndësishme e trashëgimisë sonë kulturore, është e lidhur ngushtë me teknologjinë e prodhimit të saj. Analiza e teknologjisë së veshjeve mundëson një këndvështrim shumëplanësh të studimit mbi veshjen popullore, duke e parë atë, jo vetëm si një objekt i mbrojtjes së trupit nga dukuritë natyrore dhe si mjet zbukurimi, por edhe si një objekt që pasqyron mënyrën e jetesës, identitetin kulturor, stadin ekonomik dhe social, huazimet dhe ndikimet nga kulturat e tjera etj. Studimi i veshjes në tërësinë e saj do të kontribuonte jo vetëm në studimet etnografike, por edhe në ato historike, gjeografike, sociale, madje edhe në ato ekonomike.

Mënyra kryesore për të siguruar mbrojtjen dhe ruajtjen e traditave më të mira të teknologjisë së veshjeve tradicionale është

ajo e arritur përmes dizajnit bashkëkohor dhe inovacionit. Mbajtja e tyre në muze nuk mund të konsiderohet si alternativa më e mirë nëse ne nuk i përkthejmë këto njohuri tradicionale në një gjuhë bashkëkohore. Dhe, nëse arrijmë që kulturën tradicionale ta kthejmë në një kulturë bashkëkohore, vetëm atëherë e shkuara mund të rilidhet me brezin e ri.²²

Prandaj, është e nevojshme që të lidhet e kaluara me të sotmen, duke u përkujtuar gjeneratave të reja për një të kaluar etnografike shumë të pasur të këtyre anëve. Siç potencuam, në këtë trevë më tepër janë ruajtur veshjet tradicionale të grave, ndërsa nga veshjet e burrave janë të ruajtura vetëm tirqit që më së shumti ruhen dhe përdoren gjatë ceremonive gazmore të dasmave si dhe në organizimin e manifestimeve nga kulturo – artistike.

Trashëgimia kulturore e historike e të kaluarës së një etnie, e në veçanti e veshjes tradicionale kombëtare shqiptare në trevën e Kumanovës, ruhet në Muzeun e Kumanovës dhe padyshim që duhet t'i jepet vendi i merituar në shoqëri.

Trashëgimia kulturore është një çështje specifike e cila inkorporon një fushëveprim shumë të gjerë. Ruajtja dhe promovimi i diversitetit kulturor janë vepra që çmohen dhe vlerësohen nga Bashkimi Evropian. Mbrojtja e trashëgimisë ka rëndësi historike për të promovuar diversitetin kulturor, i cili paraqet po ashtu një instrument shumë të rëndësishëm në afirmimin e komuniteteve dhe përmirësimin e dialogut në mes kulturave të ndryshme.

Veshjet popullore janë, pa dyshim, një nga manifestimet më të fuqishme të kulturës tradicionale. Ato janë trashëguese, trans-

²² Nini Silvana, Veshjet popullore të para në këndvështrimin e teknologjisë së punimit dhe vlerave estetike.

metuese por njëkohësisht edhe shprehje e marrëdhënieve kulturore me popuj të tjerë gjatë shekujve. Ato përbëjnë një aspekt të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore shqiptare. Studimi i veshjes popullore, si një manifestim i kësaj kulture, ndihmon fuqishëm në njohjen e mënyrës së jetesës së popullsisë në zonat urbane dhe në ato rurale.

Mënyra kryesore për të siguruar mbrojtjen dhe ruajtjen e traditave më të mira të teknologjisë së veshjeve tradicionale është ajo e arritur përmes dizajnit bashkëkohor dhe inovacionit. Mbajtja e tyre në muze nuk mund të konsiderohet si alternativa më e mirë nëse ne nuk i përkthejmë këto njohuri tradicionale në një gjuhë bashkëkohore. Dhe, nëse arrijmë që kulturën tradicionale ta kthejmë në një kulturë bashkëkohore, vetëm atëherë e shkuara mund të rilidhet me brezin e ri. Në vazhdim do të paraqes veshjet tradicionale shqiptare të anës së Karadakut të Kumanovës, që ruhen edhe tek popullata vendase, por edhe në institucionin nacional, Muzeun e Kumanovës.



Mushallak (pshellak – përparëse)

Mushallak (pshellak – përparëse) i leshtë me vija të bardha i përbërë nga leshi i dhisë me gjatësia 63 cm dhe gjerësia 82 cm. Përbëhet prej dy pjesëve të bashkuara ku në pjesën e përparme gjendet një xhep prej një materiali jo të njëjtë dhe me ngjyrë të ndryshme nga mushallaku. Në pjesën e sipërme është e ngjitur një tojë e cila shtrëngohet për beli për ta mbajtur më mirë atë. Ruhet në Muzeun e Kumanovës, me inventarin nr. 11/1 – 2339.



Mushallak (përparëse)

Mushallak (përparëse) i zi me vija të kuqe i punuar në dorë (veg) prej leshit të dhenve me gjatësia prej 73 cm dhe gjerësi prej 88 cm. Ruhet në Muzeun e Kumanovës, me inventarin nr. E1/1 – 2340.



Dimi – shalija

Dimi (çitjane, shalije) prej pambuku, me lule, me gjatësi prej 103 cm dhe gjerësi prej 240 cm. Ruhët në Muzeun e Kumanovës, me inventarin nr. nr. E1/1 – 2341.

Fatkeqësisht, veshjet tradicionale shqiptare nuk kanë gjetur vend për ekspozim në Muzeun e Kumanovës, por ato ruhen në sirtarët e muzeut. Është i habitshëm edhe fakti se aty nuk mund të gjejsh veshje tradicionale të burrave, sikur ato të mos ekzistonin fare. Ndërsa, edhe në mesin e popullatës shqiptare, gjithnjë e më pak mund të gjenden veshje të tilla të vjetra – tradicionale, të cilat rrëfejnë për të kaluarën tonë.

Burimet dhe literatura:

- Institucioni Nacional “Muzeu” – Kumanovë
- Informatorë: Azbije Iseni (1915–2020), Ramize Aliti (1930–2013), Zemile Kamberi Ebibi.
- Murtezani Izaim, Rite dhe praktika magjike të ciklit jetësor, Shkup, 2016
- Mustafa Bukurije, Murtezani Izaim, Useini Rini, Gjurmëve të veshjes popullore shqiptare në Maqedoni, ITSHKSH, Shkup, 2018
- Nini Silvana, Veshjet popullore të para në këndvështrimin e teknologjisë së punimit dhe vlerave estetike
- Zeqiri Mumin, Besime popullore shqiptare rite e mitologji në rajonin e Kumanovës, ITSHKSH, Shkup, 2016.

GURETA BAJRAMI BREZNICA

Universiteti i Tiranës

VESHJA – SI KULTURË MATERIALE DHE SHPIRTËRORE, TREGUES I MËNYRËS SË JETESËS SË SHQIPTARËVE NË RAJONIN E KUMANOVËS NË SHEK. XX

Abstrakt

Veshja popullore është treguesi më i mirë i zhvillimit kulturor, artistik dhe i ngjarjeve shoqërore e politike të një populli, që jeton në një zonë të caktuar.

Për veshjet tradicionale të popujve është shkruar shumë, duke nxjerrë në pah kulturën, traditat dhe veçoritë më karakteristike të një populli. Etnografia e njohur, prof. Afërdita Onuzi, veshjen tradicionale e ka konceptuar dhe trajtuar si “një identifikim”. Nisur nga ky përcaktim shkencor, vërejmë se në rajonin e Kumanovës disa karakteristika të veshjeve i dallojnë shqiptarët e këtij rajoni, si pasojë e faktorëve të shumtë që ndikuan në ndryshimet graduale të veshjeve shqiptare. Sidomos ndryshimet dhe përjetimet emocionale që lidhen me veshjen e femrës shqiptare, por pa lënë anash edhe veshjen mashkullore e cila kishte ndryshime ndonëse jo aq sa ajo femërore. Këto dhe disa zhvillime kryesore, kulturore e politike që patën ndikim në mënyrën e jetesës, veçanërisht në stilin e veshjeve të shqiptarët e rajonit të Kumanovës në shek. XX do të trajtohen në këtë kumtesë.

Bazuar në dëshmitë e të moshuarve me mendje të kthjellët dhe në intervista realizuar gjatë ekspeditave në trevat shqiptare të Kuma-

novës, po ashtu jam bazuar edhe në libra e shkrime shkencore të studiuesve e autorëve shqiptarë e të huaj.

Në këtë kumtesë japim një pasqyrë të veshjeve shqiptare në rajonin e Kumanovës përgjatë shek.XX, trajtohen ndarjet e veshjeve për ditë të zakonshme, nga ato të festave tradicionale e fetare, raste gëzimi e hidhërimi.

Etnografia e njohur, prof. Afërdita Onuzi, veshjen tradicionale e ka konceptuar dhe trajtuar si “mjete identifikimi”.²³ Nisur nga ky përcaktim shkencor, vërejmë se në rajonin e Kumanovës disa karakteristika të veshjeve i dallojnë shqiptarët e këtij rajoni.

Në të shumtën e rasteve emërtimet janë caktuar nga pjesa e poshtme e veshjeve, pikërisht ashtu siç e cilëson prof. Afërdita Onuzi²⁴ si veshja për nuse, gra, burra e të rinj. Përjashtim bëjnë: 1. Fere-xheja, e cila, me heqjen e perçes, nuk quhet më fere-xhe, vetëm veshja e trupore që quhej hiram; 2. Veshja me dimi, që emërtimet i merr nga emërtimi karakteristik i materialit dhe ngjyrës së tij. Si psh, dimijat e mira me shirita, shalijet e bardha, shalijet e zeza ose dimija june, etj.

Materiale kryesore studimore janë të intervistuarit që kanë dhënë informacion të mjaftueshëm për veshjen e viteve '40-të të shek.XXe në vazhdim. Ndërsa për veshjet e kohëve të mëhershme të fillim-shekullit XX kërkimet na çojnë në veshje të trashëguara deri në ditën e sotme. Kryesisht veshjet e nuseve janë më të plota çka na e bën më të lehtë dhe më të saktë, punën studimore, në krahasim me veshjen e fëmijëve, që paraqiten si kujtesë e shprehur me gojëtar.

²³ Afërdita Onuzi - *Veshjet popullore simbol identifikimi fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX*- Revista “Kultura Popullore”, Tiranë 2008, nr. 1-2, f.4

²⁴ <https://www.shqiperia.com/Veshje-Popullore-Shqiptare.3499/>

Në asnjë nga familjet që kam kërkuar gjatë ekspeditave, nuk është ruajtur qoftë edhe një nga veshjet për fëmijë, madje as edhe një fotografi nuk ekziston.

Në fillim të shek.XX veshja e fëmijëve në moshë të vogël ishte fustani i gjatë deri poshtë gjurit dhe brekë të gjata (*done t'gata*), të punuara nga pëlhura e prodhuar në avlëmend nga gratë. Më vonë, rreth viteve '40–'50 të shek.XX këto veshje janë bërë nga basma (*fanullabez*).²⁵ Disa të intervistuar tregojnë se dallimi i rrobave të vajzave nga ato të djemve fillon nga mosha 7–8 vjeçare, disa e shtyjnë në kohë, nga mosha 10–vjeçare. Duket se në varësi të zhvillimit fizik të fëmijëve ka filluar edhe ndryshimi i veshjeve. Kur djemtë i vishnin me pantollona të qepura vetë nga nënat e tyre ose të thurura me shtiza deri në moshën e pjekurisë.

Afërsisht në moshën 15–vjeçare, në moshën e pubertetit (*kur çika hiken'bilik*) vajzat vishnin dimi të thjeshta (jo me shumë lule) dhe xhaketë. “*pi 15 vet e te përpet vishni dimi e xhket...*”²⁶ Në këmbë mbanin papuçe druri të quajtura *nallane*, punuar nga druri me një rrip të vogël lëkure që e merrnin prej dizgjinëve të vjetruar të kua-jve.

Femra (madhore) kur dilte jashtë oborrit të shtëpisë duhej të ishte e mbuluar, me Hiramini e shami të zezë, e shoqëruar me një cohë tjetër po të zezë, që i mbulonte fytyrën, duke u lënë hapësirë për të shikuar vetëm syve. Kjo veshje, quhej “ferexhe”. Është përdorur nga femrat shqiptare deri nga fundi i viteve '50 të shek. XX.

²⁵ Treguar nga Xhemile Edipi lindur më 1950 nga fshati Runicë, martuar në fshatin Rahmanli, profesioni shtëpiake.

²⁶ Treguar nga Nafije Aziri lindur më 1939 nga fshati Runicë, e martuar në fshatin Sllupçan, profesioni shtëpiake.

Kur themi femrat, nënkuptojmë të gjitha gratë, edhe vajzat që nga mosha e pjekurisë. Naime Osmani, nga fshati Sllupçan, tregon: “*pi kur ka hi çika n’bilik ka vesh fërexhe a mlu me peçë*”. Ato edhe në punët e fushës shkonin mbuluar me hiramini e shaminë e zezë. Kështu është vijuar derisa perçja u hoq.²⁷

Veshje të tilla janë përdorur edhe në vise të tjera të banuara me shqiptarë. Si dëshmi e kësaj veshjeje janë fotografitë e fotografit Italian Giuseppe Massani, të sjella nga albanologu Robert Elsie.²⁸ Por, ndryshe nga veshja me perçe që shohim në foto të hershme në qytetin e Shkodrës, në rajonin e Kumanovës është veshur vetëm veshje e zezë e mbulimit.



Veshja me fërexhe e grave shqiptare që ishin shpërngulur në Turqi



Gratë shqiptare në tregun e Shkodrës 1940, fotografuar nga Giuseppe Massani

²⁷ Treguar nga Naime Osmani – lindur më 1948 nga fshati Llojan, e martur në fshatin Sllupçan, profesioni shtëpiake.

²⁸ <http://www.balkanweb.com/site/foto-fotografi-te-rralla-te-grave-shqiptare-ne-qytetin-e-shkodres-gjate-viteve-40/>

²⁹ Teaching Modern Southeast European History, Alternative Educational Materials, The BalkanWars / Selanik, 2009 f.58 ne linkun / http://cdrsee.org/jhp/pdf/ëorkbook3_eng_ed2.pdf

Por intelektualët atdhetarë, kudo e kundërshtonin në forma të ndryshme mbulimin e femrave shqiptare. Shkrimtari dhe atdhetari ynë i madh, Naim Frashëri thoshte: “*Të mbuluarit dhe të mshehurit e fytyrës së gruas s’ka qenë në kohën e profetit, por është shpikur më vonë. Ndalim i madh në përparimin e një kombi...*”.³⁰ Shkrimet dhe veprat e patriotëve, të Rilindasve shqiptarë, ishin shumë të lexuara në rajonin e Kumanovës. Prandaj, nëpër oda të burrave, nga pleq të mençur dhe me autoritet publik, thuhej: “Femra e emancipuar lind fëmijë të emancipuar”.³¹ Disa nga ata ishin kundër veshjes së mbuluar, veshjes me ferexhe, por këta ishin të pakët.

Pjesa që mbulonte fytyrën, perçja (*peça*) është hequr dhe ndaluar me urdhër zyrtar. Është bërë presion psikologjik, por edhe fizik; për ata që e kundërshtonin.³² Për këtë vendim dhe qëllimet e heqjes së perçës shkruan studiuesi, dr. Qerim Lita. Citoj: “...*Krerët e Byrosë Politike e dinin shumë mirë se ndikimi i klerikëve myslimanë është shumë i madh te popullata shqiptare në përgjithësi, posaçërisht te fshatarësia. Ndaj ata, nëpërmjet organeve të tyre ndihmëse (Komisioni i Çështjeve Fetare, Dhoma e Politikës së Jashtme, Dhoma e Pakicave Nacionale, UDB-ja etj.), gjatë viteve 1949–1950, hartuan një sërë planesh, analizash, elaboratesh, me të vetmin qëllim: të përfitohet “Bashkësia Fetare Islame” dhe krerët e saj, me çka shumë lehtë do t’i realizonin planet e tyre antishqiptare...*”³³ Nisur nga kjo, bazuar në dokumente arkivore, ai shkruan; dhe një

³⁰ <http://www.fjala.info/arkiv/fjala3/2013/07/07/pse-naimi-ishte-kunder-havales/>

³¹ Treguar nga Nezir Bajrami– jetoi në vitet 1890–1981 nga fshati Shtrazë. Anëtarë politiko-ushtarak në shtabin e Sule Hotlës, mjeshtër i njohur në zonën e tij. Materiale të marra nga incizimet në kasetë të vitit 1980.

³² Treguar nga Halil Tahiri– lindur më 1947 nga fshati Sllupçan, profesioni shofer.

³³ Qerim Lita - *Shpërngulja e shqiptarëve nga Shqipëria lindore në Turqi* (1953-1959) <http://www.nacionalalbania.al/2015/04/shperngulja-e-shqiptareve-nga-shqipëria-lindore-ne-turqi-1953-1959/25/>

nga kërkesat e shumta, që iu bë BFI-së ishte edhe heqja e perçës. Citoj: “...Në mbledhje të shqyrtohet çështja e fereksesë, duke u mbështetur në shkresat udhëzuese dhe deklaratat e Reis-Ulemasë. Aty për aty të sillet rezolutë dhe t’u bëhet apel grave myslimane për ta hequr fereksen...”³⁴ Ndikimi fetar ishte i madh. Në intervista e pyetësorë kam rrëfime të ndryshme. Xhabir Islami shkruan: “Mbajtjen e peçës e kanë quajtur të shenjtë”, më vijon: “kur do ta hiqnin peqën, një pjesë e quante si mjerim dhe thoshin: qohuni ju të vdekur të hym ne të gjallët”³⁵ Ndërsa Xhemile Dërvishi, që e ka përjetuar heqjen e perçës, tregon: “Ka qenë shumë e vështirë edhe vet e kam përjetuar menjëherë se u banëm shkje, dolëm prej dinit”.³⁶ Zahir Arifi tregonte: “Kur u hoq peça u ba shumë keq sa që të gjithë mendojshin të shpërngulen në Turqi”.³⁷

Kjo ndodhi, studiuesi Q.L. shpjegon dhe argumenton se gjatë periudhës së viteve 1949–1951, u bë spastrimi i BFI nga hoxhallarët e “papërshtatshëm” dhe u zëvendësuan me “hoxhallarë të mjerë”,³⁸ siç i quan Qemal Sejfulla³⁹. Ata punuan për zbatimin e ligjeve dhe të urdhërësive të pushtetit vendor dhe një ndër to ishte edhe heqja e fereksesëme dhunë. Kishte edhe dëshmi që tregonin në rezistencë. Nga viti 1951 femrat shqiptare e zbuluan fytyrën, por hiram i zi nuk u hoq. Në fillime përdorshin forma të ndryshme

³⁴ Po aty.

³⁵ Treguar nga Xhabir Islami – lindur më 1970 nga fshati Llojan, me arsim të lartë, punon mësues i ciklit të ulët.

³⁶ Treguar nga Xhemile Dërvishi – lindur më 1926 nga fshati Bellanocë, profesioni shtëpiake.

³⁷ Treguar nga Zahir Arifi – lindur më 1954, nga fshati Çerkez ka mbaruar shkollën e lartë në degën historik – gjeografi, punon arsimtar.

³⁸ Dr. Qerim Lita - *Shpërngulja e shqiptarëve nga Shqipëria lindore në Turqi* (1953-1959) <http://www.nacionalalbania.al/2015/04/shperngulja-e-shqiptareve-nga-shqiperia-lindore-ne-turqi-1953-1959/25/>

referencë AM. 1. 427. 27. 56. 259-267.

³⁹ Qemal Sejfulla ishte kryebashkiak i qytetit të Shkupit në vitet 1951 - 1954

për mbulimin sadopak të fytyrës se ato ishin edukuar me mendësinë paragjyquese se, po dole zbuluar “të djeg zjarri i ferrit”– (*t’djegz-jarmi i xhenenit*).⁴⁰

Pas emigrimeve shqiptare të viteve ’60 të shek. XX drejt Perëndimit, ndryshoi edhe veshja e grave. Hirami i zi u zëvendësua me mantil ngjyrë hiri (*ngjyrë të thim*) e më vonë filluan edhe ngjyrat të tjera. Për gratë rreth të ‘40–tave, mantili kishte ngjyra të hapura. Sa më e madhe të ishte gruaja në moshë, aq më të errët e vishte edhe mantilin.

Mantili dhe shamia mbahen edhe sot. Gratë e moshuara sot i mbajnë flokët e mbledhura mbrapa kokës me kapse të ndryshme të thjeshta. Pothuaj të gjitha gratë nuk mbajnë më shami me oja. Shumica e grave, kur dalin jashtë shtëpisë, vënë në kokë një shami të hollë lidhura nën fyt.

Femrat e reja dhe nuset veshin edhe sot mantil: për të rejat mantili ka ngjyrë të bardhë a bezhë, d.m.th. ngjyra pastel të hapura dhe më i shkurtër. Shamitë pa dantella të mëndafshita ose materiale të mira me lule, ka raste edhe njëngjyreshe, të shndritshme, mbahen nga nuset e reja.⁴¹ Deri në vitet ‘70 të shekullit të kaluar gratë ishin të mbuluara. Me kalimin e kohës dhe zhvillimin kulturor të shoqërisë, disa familje të emancipuara i paraprinë me vetëdije ndryshimit të veshjes së grave e vajzave. Ata i jepnin rëndësi shkollimit të bijve e bijave të tyre. Ishin burrat e rinj ata që këmbëngulin për heqjen e shamive, por shpesh herë hasnin në kundërshtimin brenda familjes. Mendësia se “*fëmna nuk ban me hec krye shtruni*” kishte hedhur rrënjë të thella, shndërruar në tabu.

⁴⁰ Treguar nga Ema Bajrami – lindur më 1945 nga fshati Ladolishtë – Srugë, e martuar në fshatin Llojan – Kumanovë, profesioni mësuese.

⁴¹ Treguar nga Azir Aziri – lindur më 1954 nga fshati Çërkez, profesioni arsimtar.

Veshja e grave të moshuara deri nga fundi i shekullit XX përbëhej nga dimitë, xhaketa, mintani, jeleku i thurur, si dhe “mshallaki” apo “mushallaku”. Në kokë mbanin shaminë e hollë me oja të thjeshta e lidhur me piskil⁴² e mbi të një shami tjetër.



Grua e moshës 70– vjeçare veshur me dimi, xhaketë e mshallak – foto e viteve ‘80

Sa më shumë rritej mosha e femrës, aq më pak zbukurime e ngjyra kishin veshjet e femrave edhe në rajonin e Kumanovës ashtu siç i përshkruan edhe prof.dr. Afërdita Onuzi në studimin për veshjet tradicionale të grave të veriut të Shqipërisë.

Të intervistuarit tregojnë që në shtetet Perëndimore në vitet ’60 të shek. XX veshja e grave të moshuara ndryshonte shumë nga veshja e grave të vendlindjes, ishin me ngjyra më të hapura, kishin edhe lule e zbukurime të ndryshme. Veshja e tyre me pantallona e fustane për ta ishte një botë tjetër. Megjithatë ndikoi ngadalë ndryshimin e veshjes shqiptare.

⁴² Püskül (lexohet Pyskyl) – xhufkë shih: <https://translate.google.com/#tr/sq/p%C3%BCsk%C3%BCl>

Të gjithë të intervistuarit kur flasin për veshjen e të rinjëve tregojnë se mosha e pjekurisë bënte diferencën edhe të veshjes për djemt. Ata, sa fillonin e rriteshin, nga mosha 10 – 15-vjeçare vishnin “*tir-qe pa gajtana, mintan me ni palë pulla, fanellt’leshtë,n’krije kapuç t’bardhë, çorapet’leshta dhe kanë math opinga*”⁴³

Në fillim shek. XXmbahej Plisi i bardhë i quajtur (*kapuç i bardhë*) me të cilin identifikoheshin shqiptarët, ndërsa kapuçi i sllavëve dallonte shumë nga ai i shqiptarëve si nga forma dhe nga materiali. Quhej “shubara”.⁴⁴



Shubara – kapuç tradicional i macedonëve

Në vitin 1927 autoritetet shtetërore e ndaluan mbajtjen e plisit të bardhë, sepse ishte simbol identifikimi i popullsisë shqiptare, për arsye e qëllime të shumta që dihen e që ekzistojnë të shkruara në studime të ndryshme të studiuesve vendore e të huaj. Shqiptarët tashmë mbanin kapuç të zi prej bezi.⁴⁵ Për kundërveprim dhe identitet, shumë shqiptarë plisin e bardhë e ngjyrosnin me bojë të zezë industriale në kushte shtëpie. Kishin krijuar njetet e

⁴³ Treguar nga Xhemile Dervishi - lindur më 1926 në fshatin Bellanoc. Profesionit shtëpiake.

⁴⁴ <https://en.wikipedia.org/wiki/%C5%A0ubara>

⁴⁵ Kadri Halimi - Shënimet e para të qeleshe punuesëve,- Prishtine 1994: f.152-172

nevojshme, formën e drurit e quajtur “*kallëpidhe fërkuesin*”⁴⁶ një copë druri të lëmuar që i ruante formën në kallëp.⁴⁷

Gjatë kërkimeve në terren, në familje të ndryshme kam hasur në disa lloje të kapuçave që janë përdorur e që te disa të moshuar mbahen edhe sot.



Foto 231. Plisi i zi me qevër në foto Nezir Rrahmani



Foto 232. Kapuçi i zi prej bëzi në foto Zijadin Aziri



Foto 233. Kapuçi i haxhive në foto Bektesh Aziri



Foto 234. Beretë franceze e zezë në foto Raif Aziri

Për shkak të politikave shtetërore, ndikimit fetar, kushtet të mira ekonomike pas viteve '60, shumë të moshuar shkuan në haxhillëk, dhe identifikoheshin me krenari, me kapuçin e haxhit. Për raste të ndryshme kishin kapuç të caktuar, por në përgjithësi ishin të bardhë, punuar me grep për përdorim të përditshëm, ose për raste festash, i qepur dhe i dekoruar me shirita të bardhë, për raste të veçanta ishte me shirita të verdhë.

Rreth viteve '50–'60 kapuçi në përgjithësi nuk ishte i pëlqyer nga të rinjtë. Disa përjetime të të rinjëve të asaj kohe për kapuçin nga të intervistuarit dhe anketuarit të shkruar në të folmen e zonës:

⁴⁶ Po aty f.142

⁴⁷ Treguar nga Mexhid Bajrami – lindur më 1942 nga fshati Llojanjeton në Fushë-Kosovë, profesioni – piktor – redaktor artistik në revista, Pallatin e shtypit “Rilindja: Prishtinë

- Hajrulla Bislimi nga fshati Llojan tregon: “...*Kapuçin kurr se kam dasht...tinza, kur dilshna pi shpijësikshna pi babës tem i kishnallokt katran t’zeza,... e shtishnan’xhep kapuçin e kur hishnan’shpi kapuçin e ndojshna,... shka ti bajsh, pi zorit...*”
- Bajram Ademi nga Kumanova tregon: “...*unë der sa e kam kry gjimnazin s’um ka lan baba të hy në shtëpi pa kapuç, as buk s’kam pas shancët’ha, t’uleshn’sofërt’hajshbukjooooo hiq ... e po mysliman, feja...*”
- Rexhep Jashari nga fshati Allashec sqaron :”...*i kepin vet kapuçat . (e heq kapuçin nga koka e fut në xhep dhe më drejtohet): –a u prisha? Jo, a m’qiti pi fes? – Jo, ama tradit kur ma ka nunanaçata se heki, përpara si kan lan mu hunxh me hangërbukn’sofër pa e pas kapuçin n’krije,... – pse? –shka (sllav) thojshin pa kapuç...*” etj.

Për veshjen e hershme të burrave, Ibrahim Musliu nga fshati Llojan tregon, ashtu si e ka dëgjuar nga babai i tij: në zonën e Kumanovës, në malësinë e Karadakut, është veshur dikur fustanella: “...*baba m’ka pas kallxuemetiüüü, që burrat kishin pas vesh fistan kah ana e Karadakitanej...*”⁴⁸ Edhe studimet shkencore e kanë treguar që fustanella është veshur edhe në këtë rajon. Prof.dr. Afërdita Onuzi, kur shpjegon përhapjen e fustanellës si veshje e burrave përmend edhe në rajonin e Maqedonisë Perëndimore.⁴⁹

Deri rreth viteve ’45–’50 të shek. XX veshje tradicionale e burrave ishin tirqit, të bardhë dhe kafe të errët, me gajtanë të zinj, të lidhur në mes me brez (*shokë*) disangjyrëshe prej leshti të punuar në vegje.

⁴⁸ Treguar nga Ibrahim Musliu – lindur më 1934 nga fshati Llojan, profesioni bujk

⁴⁹ Afërdita Onuzi – *Veshja popullore simbol identifikimi* – “Kultura Popullore” Nr 1,2 / Tiranë 2008 / f.14

Sipër kanë veshur këmishën e bardhë prej pëlhure, të punuar nga gratë në avlëmend, mbi të (*nuntani – mitani me di pal pulla*).⁵⁰ Përdoren të dy këto emërtime për veshjen e sipërme që ishte prej shajaku me mëngë të gjata me ngjyrë të kuqe të zezë ose të bardhë. Informatorë të ndryshëm thanë se në vitet '50 – '60 të shek. XX fshatarët e zonave malore, por edhe ata të fushës janë veshur me cashnikë, pantallona prej zhguni.

Deri nga vitet '20 për dhëndrin në ditën e dasmës veshja tradicionale ishte veshja me tirq të bardhë të ngushtë me gajtanë, me këmishë të bardhë pëlhure (*plihure*) e mbi të xhamadani dhe brezi (*shoka*) me lara e lidhur për mesi. Në këmbë, opinga të punuara punë dore.

Në vitet '40–'50 të shek. XX, djali – dhëndër, ditën e dasmës vishte “*tesha t'mira*” ose “*katin e teshave*” e quanin disa, i quajtur kostumi perëndimor: xhaketa (*setra*) me jelek dhe këmishë të bardhë (*k'nisht'bardh najloni*). Në kokë mbanë një kapuç të zi bezi. Kostumi ishte shumë i kushtueshëm, prandaj në fshatra, rrobat e dhëndrit i kanë veshur 10 e më shumë veta duke i huazuar nga njeri tjetri.⁵¹ Kjo tregon një mënyrë shumë të vështirë jetese.

Ndërsa veshja e përditshme për të punuar, burrat përdornin rrobat e vjetra. Ata që punonin larg shtëpisë mbanin me vete edhe Jani–xhikun, një lloj çante e punuar nga lëkura e kafshëve, lëkurë e përpunuar, nga jashtë prej gëzofi me qime. Kishte formë drejtkëndëshi

⁵⁰ Treguar nga Xhemile Dervishi - lindur më 1926 në fshatin Bellanoce. Profesioni shtëpiake.

⁵¹ Treguar nga Vebi Destani – lindur më 1926, i njohur si „Aga Vebi”. Nga viti 1951, ishte emëruar kryetar i Bashkësisë vendore për fshatin Llojan, detyrë të cilën e ushtroi 36 vite me radhë

dhe një rrip të gjatë lëkure. Në të, për shkak të materialit natyral, bukën e në përgjithësi ushqimin e fusnin pa e mbëshjellë.⁵²

Veshja për raste mortore – Nisur nga studimet e shumë autorëve që janë bërë rreth zisë dhe termit zi përmendim këtu studiuesin, prof dr. Vasil Tole, që shpjegon; duke e lidhur me kuptimin e ngjyrës së zezë.⁵³ nisur nga fjalori elektronik i gjuhës së sotme shqipe, kuptimi i zisë⁵⁴ është edhe kuptim figurativ ku shprehet “...Fatkeqësi a e keqe e madhe, mynxyrë. Ndillte (mbillte, parandiente) zi. Shihte vetëm zi...” në rajonin e Kumanovës gra e burra për raste mortore mund të themi se përdoret kuptimi figurativ i zisë, ndryshe nga veshja për raste mortore në Shqipëri. Duke ju referuar prof dr. Agim Bidos mësojmë se nuset dhe gratë për raste mortore tragjike vishen me të zeza. Më tej ai arsyeton “ngjyra e errta të përdorura në masë të madhe dekorative krijojnë nga ana estetike një llojë atmosfere të rëndë tragjike në aspektin shpirtërorë...”⁵⁵

Në Kumanovë dhe në fshatra si në zonat malore, ashtu edhe në ato fushore, në rastet mortore është përdorur veshje e zakonshme. Shqiptarët e rajonit të Kumanovës nuk kanë pasë dhe nuk kanë ndo—një veshje të veçantë për raste mortore. Asnjëherë nuk është praktikuar veshja me të zeza, përkundrazi në rastet mortore gratë vënë shami të bardha, mbulimi me shami të bardhë ka qenë dhe është zakoni i veshjes në raste vdekje. Ato vishen me rroba të zakonshme pa

⁵² Treguar nga Bajram Sulejman – lindur më 1946 nga fshati Mateç, profesioni magjistër, i pensionuar

⁵³ Vasil S. Tole – Pse qajnë kuajt e Akilit (E qara me botë dhe prejardhja e isopolifonisë popullore shqiptare / Media Print Tiranë 2011 – f. 83

⁵⁴ZI f. 1. Hidhërim i thellë, pikëllim i madh, që shkaktohet nga vdekja e një njeriu shumë të afërt e të dashur a shumë të nderuar; shfaqja e këtij pikëllimi; <http://www.fjalori.shkenca.org/>

⁵⁵Agim Bido – Arti popullorë në veshje e tekstile – Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë - Instituti i kulturës Popullore / Tiranë 1991 / f. 173

shumë lule e ngjyra për nuset e reja pastrojnë mirë fytyrën, as krem në fytyrë nuk vënë. Sot nuset të shumtën e rasteve nuk e vëjnë më shaminë në kokë por e varin rreth qafës edhe nëse vdekja u nodh në familjet e tyre. Ndërsa plakat vishen me ngjyra të errta si zakonisht që është veshja e tyre. Nga intervistat tregojnë se plakat vishen edhe me rroba të vjetra në rast se vdekja është në shtëpi⁵⁶.

Por për ngjyrën e zezë në rastet e zisë e kam dëgjuar sipas gojëdhë-nave përcjellur edhe në kohët tona, burrat kishin filluar ti veshin tirqet me ngjyrë kafe ose të zezë, si shenjë zije që me vdekjen e heroit tonë kombëtar, Skënderbeut. Por një gjë e tillë tregohet edhe në Shqipërinë e mesme në lidhje me ngjyrën e zezë të xhurdisë e cila vishej në shqipëri të veriut dhe atë të mesmen si veshje mortore e burrave sipër rrobave të mira "...tregohet me insistim e krenari se ajo është kthyer e zezë si shenjë zije mbas vdekjes së Skënderbeut".⁵⁷

Këto leksema kanë të bëjnë edhe me tipat e ndryshëm të veshjeve, të cilat nuk mund të vështrohen jashtë përkufizimit lokal, kështu p.sh. *kmish memomshtona* dhe *çintjanet/çitjane* (me vija vertikale të verdha në material të kuq dhe shirita të verdhë), të quajtura *jallane* janë emërtime të njohura vetëm për grate e f. Cernivor; ndërkaq emërtimi *shalie*, dimi me ngjyrë të zezë e me lule, ishte e njohur për gjithë gratë e rajonit të Likovës, të cilat dikur vetë i kishin mbajtur. Kjo vjen nga fakti i veshjes popullore dhe uniforme të lidhura me rajone të caktuara.⁵⁸

⁵⁶ Vehbi Rexhepi – lindur më 1933 në fshatin Vaksincë . Profesion i - bujk

⁵⁷ Andromaqi Gjergji – Ligjërata për etnologjinë shqiptare / Shtëpia Botuese Lilo / Tiranë 2004 f. 158

⁵⁸ Bukurie Mustafa - Mbi disa leksema popullore artizanale / Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup / Studime Albanologjike 10 / 2014 / fq. 302

Përfundim

Për shkak të politikave shtetërore, ndikimit fetar, kushtet ekonomike pas viteve '60, shumë të moshuar shkuan në haxhillëk dhe identifikoheshin me krenari me kapuçin e haxhit. Thuhej për ata që ishin kthyer nga haxhi (*man kapuç t'haxhive, se ka shkuen 'haxhi – llëk*). Ndikimi fetar ishte shumë i madh. Në intervista e pyetësorë, kam rrëfime të ndryshme, Xhabir Islami shkruan: “*Mbajtjen e peçës e kan quajtur të shenjt*” më vazhdim shkruan “*kur do ta hiqnin peqën një pjesë e quanin si mjerim dhe thoshin qohuni ju të vdekur të hym ne të gjallët*” Ndërsa Xhemile Dërvishi, që e ka përjetuar vet heqjen e perçës, tregon: “*Ka qenë shumë e vështir edhe vet e kam përjetue menojshmi se u banëm shkije, dolëm prej dini*”.

Femrat e reja dhe nusët veshin edhe sot mantil: për të reja mantili ka ngjyrë të bardhë a bezhë, d.m.th. ngjyra pastel të hapura dhe është më i shkurtër. Shamitë pa dantella të mëndafshita ose materiale të mira me lule, ka raste edhe njëngjyreshe, të shndritshme, mbahen nga nusët e reja. Deri në vitet '70 të shekullit të kaluar gratë ishin të mbuluara. Me kalimin e kohës dhe zhvillimin kulturor të shoqërisë, disa familje të emancipuara i paraprinë me vetëdije ndryshimit të veshjes së grave e vajzave. Pavarësisht nga kontaktet me kulturën Perëndimore, e zhvillimin shoqërorë e arsimorë veshja e grave shqiptare në rajonin e Kumanovës ndryshonte me ritme shumë të ngadalta.

Referenca:

1. Afërdita Onuzi – *Veshja popullore simbol identifikimi* – “Kultura Popullore” Nr 1,2 / Tiranë 2008
2. Agim Bido – *Arti popullorë në veshje e tekstile* – Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë – Instituti i kulturës Popullore / Tiranë 1991

3. Andromaqi Gjergji – Ligjërata për etnologjinë shqiptare / Shtëpia Botuese Lilo / Tiranë 2004
4. Bukurie Mustafa – Mbi disa leksema popullore artizanale / Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup / Studime Albanologjike 10 / 2014
5. Qerim Lita – *Shpërngulja e shqiptarëve nga Shqipëria lindore në Turqi* (1953–1959) <http://www.nacionalalbania.al/2015/04/shperngulja-e-shqiptareve-nga-shqiperia-lindore-ne-turqi-1953-1959/25/>
6. <http://www.balkanweb.com/site/foto-fotografi-te-rralla-te-grave-shqiptare-ne-qytetin-e-shkodres-gjate-viteve-40/>
7. <http://www.fjala.info/arkiv/fjala3/2013/07/07/pse-naimi-ishte-kunder-havales/>
8. <https://en.wikipedia.org/wiki/%C5%A0ubara>
9. <https://www.shqiperia.com/Veshje-Popullore-Shqiptare.3499/>
10. Kadri Halimi – Shënimet e para të qeleshe punuesëve, – Prishtine 1994
11. Prof.dr. Afërdita Onuzi – *Veshjet popullore simbol identifikimi fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX*– Revista “ Kultura Popullore”, Tiranë 2008, nr. 1–2
12. Teaching Modern Southeast European History, Alternative Educational Materials, The BalkanWars / Selanik, 2009 ne linkun / http://cdrsee.org/jhp/pdf/ëorkbook3_eng_ed2.pdf
13. Vasil S. Tole – Pse qajnë kuajt e Akilit (E qara me botë dhe prejardhja e iso-polifonisë popullore shqiptare / Media Print Tiranë 2011

Të intervistuar:

1. Azir Aziri – lindur më 1954 nga fshati Çërkez, profesioni arsimtar
2. Bajram Sulejman – lindur më 1946 nga fshati Mateç, profesioni magjistër, i pensionuar
3. Esma Bajrami – lindur më 1945 nga fshati Ladorishtë – Srugë, e martuar në fshatin Llojan – Kumanovë, profesioni mësuese
4. Halil Tahiri– lindur më 1947 nga fshati Sllupçan, profesioni shofer

5. Ibrahim Musliu – lindur më 1934 nga fshati Llojan, profesioni bujk
6. Mexhid Bajrami – lindur më 1942 nga fshati Llojan jeton në Fushë–Kosovë, profesioni – piktor – redaktor artistik në revista, Pallatin e shtypit “Rilindja: Prishtinë
7. Nafije Aziri – lindur më 1939 nga fshati Runicë, e martuar në fshatin Sllupçan, profesioni shtëpiake
8. Naime Osmani – lindur më 1948 nga fshati Llojan, e martur në fshatin Sllupçan, profesioni shtëpiake
9. Nezir Bajrami– jetoi në vitet 1890–1981, nga fshati Shtrazë. Anëtar politiko–ushtarak në shtabin e Sulë Hotlës, mjeshër i njohur në zonën e tij. Materiale të marra nga incizimet në kasetë të vitit 1980
10. Vebi Destani – lindur më 1926, i njohur si „Aga Vebi”. Nga viti 1951, ishte emëruar kryetar i Bashkësisë vendore për fshatin Llojan, detyrë të cilën e ushtroi 36 vite me radhë
11. Vehbi Rexhepi – lindur më 1933 në fshatin Vaksincë . Profesioni – bujk
12. Xhabir Islami – lindur më 1970 nga fshati Llojan, me arsim të lartë, punon mësues i ciklit të ulët
13. Xhemile Dervishi – lindur më 1926 nga fshati Bellanocë, profesioni shtëpiake
14. Xhemile Edipi – lindur më 1950 nga fshati Runicë, martuar në fshatin Rahmanli, profesioni shtëpiake.
15. Zair Arifi – lindur më 1954, nga fshati Çerkez ka mbaruar shkollën e lartë në degën histori – gjeografi, punon arsimtar.

ANGJELINA HAMZA DHE VLORE FETAJ-BERISHA

Instituti Albanologjik – Prishtinë

VESHJA TRADICIONALE NË RRAFSH TË DUKAGJINIT– KOSOVË

(teshat e katunit)

Abstrakt

Veshjet tradicionale janë shenja identifikuese për çdo kulturë dhe popull. Ato nuk shërbejnë vetëm për mbulimin e trupit, por paraqesin kulturë e traditë të atyre njerëzve dhe krahinave të tyre. Veshjet janë pjesë e trashëgimisë shpirtërore dhe simbolet e paraqitura në to janë gjuha e cila flet për një të kaluar të atij populli. Pra, veshjet tradicionale janë pasuri kombëtare për secilën kulturë, për këtë arsye ato janë ruajtur më fanatizëm të madh dhe janë pjesë e pothuajse të gjithë muzeve të botës. Madje, nga artizanë të ndryshëm ato kanë filluar edhe të riprodhohen. Pjesë e rëndësishme e veshjeve janë aksesorët e ndryshëm që përveç anës estetike në disa raste kanë edhe anën funksionale.

Sipas studiuesve të kësaj fushe, në fillim të shekullit të kaluar, numri i veshjeve popullore shqiptare kishte 140 forma të ndryshme. Këto veshje janë ndarë në dy tipa, tipin e gunës dhe tipin e xhubletës. Në tipin e parë (gunës) bën pjesë edhe veshja e grave të Rrafshit të Dukagjinit. Kjo veshje ndryshe njihet edhe me emrat: teshate katunit (vesha e katunit), veshja e Rekës (vesha e Rekës), veshja melidhcë e marhamë (vesha me lidhcë e marhamë), veshja mehotoz (vesha me hotz), veshja e çikave (vesha e çikave), veshja mepshtjellc (vesha me pshtjellc).

Përmes këtij punini kemi bërë përpjekje të sjellim të dhëna për këtë veshje, si: shtrirjen, nënlojet, mënyrën e punimit, rastet kur vishet (si veshje e përditshme që ishte dikur apo vetëm në raste gëzimi, manifestime e festivale folklorike), sa është ruajtur, sa ka pësuar ndryshime në ditët e sotme, e shumë çështje tjera që kanë të bëjnë me këtë veshje. Këto të dhëna i kemi shoqëruar me foto dhe tëinformacione nga terreni.

Fjalët çelës: *Kulturë, traditë, veshja tradicionale, Dukagjini, veshja e Rekës, teshat e katunit, vesha e çikave, vesha e nuseve.*

Hyrja

Çdo popull i ka specifikat e veta etnike në kulturën materiale e shpirtërore, ashtu siç i ka edhe populli shqiptar. Veshjet tradicionale janë njëra ndër pasuritë kulturore, materiale e shpirtërore në mesin e shumë trashëgimive të tjera. Veshjet tradicionale shqiptare si një thesar i trashëguar kulturor, nuk mbetën pa u prekur nga zhvillimet e gjithmbarshme historike, ekonomike dhe shoqërore në të cilat ka jetuar dhe punuar populli shqiptar.

Edhe veshja tradicionale e Rrafshit të Dukagjinit të cilën e kemi marrë në shqyrtim nuk ngeli indiferente ndaj zhvillimeve historike, sociale, ndryshimeve e ndikimeve tjera kulturore.⁵⁹ Aktualiteti i sotëm nxjerr në pah ndryshimet strukturore, morfologjike, motivore, kromatike, të veshjet e grup-moshave të ndryshme, që paraqet material me interes për studim.

Duke iu referuar periudhave të ndryshme të historisë së njerëzimit lidhur me veshjen e njerëzve, për veshjet në përgjithësi kemi

⁵⁹ Andromaqi Gjerqji, *Ndryshimet morfologjike e artistike të veshjeve popullore*, ASHAK, Instituti i Historisë, Sektori i Etnologjisë, Tiranë 1976, f., 4.

mendime të shumta shkencore. Sipas disa mendimeve “*funksioni themelor i veshjes ka genë mbrojtja e trupit*”, për këtë arsye ajo ndryshonte nga një stinë në tjetrën, pasi paraqiteshin si nevojë fiziologjike për mbrojtjen e organizmit nga ndikimet e ndryshme klimatike, të tjerë mendojnë se veshja është paraqitur si nevojë estetike dhe dëshirë për pamje më të bukur.⁶⁰ Veshja si element i rëndësishëm kulturor ka pasur dhe ka shumë funksione, të ndryshme. Mënyra e veshjes tregon për personalitetin dhe karakterin e individit, sipas veshjeve dallohen (vërehen) gjinitë, veshjet për burra dhe për gra etj. Si funksione të përgjithshme, sipas studiuesit Bashkim Lajçi, veshja ka funksion njohës prej nga kuptohet përkatësia etnike, konfesionale, sociale, gjinore, si dhe ajo e moshës së individit.⁶¹ Ndërsa studiuesja Andromaqi Gjergji, dallon katër funksione kryesore të veshjeve; *funksionin praktik, estetik, ceremonial dhe atë ritual*.⁶²

Veshjet tradicionale apo kombëtare të popujve në përgjithësi paraqesin thesar të rrallë artistik, ngase përmes tyre dhe simbolikës që bartin në vete, shprehin kulturën materiale dhe shpirtërore të popullit dhe artin e shprehur në të, kulturë e cila e përcjell njeriun brez pas brezi.

Populli ynë, me kohë i ka kultivuar specifikat e veshjes së vet si p.sh: materialin prej të cilit i kanë punuar veshjet, ngjyrat, simbolet e shprehura në forma dhe dizajnë të ndryshme etj. Në njëfarë mënyrë veshjet janë pasqyrë e një kohe dhe mjedisi të caktuar. Kjo tregon se edhe brenda një populli apo regionimë të vogël ka dallime në veshje. Dallimet i hasim më shumë në mënyrën e

⁶⁰ Mark Krasniqi, *Nga gurra e traditës*, Zëri, Prishtinë 1991, f. 374-375.

⁶¹ Bashkim Lajçi, *Gjurmime etnologjike*, Pejë 2007, f. 243.

⁶² Andromaqi Gjergji, *Veshjet shqiptare në shekuj*, ASHAK, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë 2005, f., 71.

punimit të veshjeve, në ngjyrat dhe zbukurimet që përdorën, në rastet kur është përdorur veshja, qoftë në jetën e përditshme apo edhe raste të veçanta, si në dasma, apo në raste të vdekjeve.

Rrok Zojzi, për të bërë *“kategorizimin e veshjeve popullore shqiptare”* ka përdorur kriterin e gjenezës së tyre, prej nga ka ardhur në përfundim: *midis veshjeve tradicionale të popullit tonë, dallojmë dy grupe veshjesh: veshje autoktone që lindën dhe u zhvilluan në vend dhe veshje të importuara që lindën tek popuj të tjerë por që hynë në përdorim gjatë shekujsh edhe tek populli ynë.*⁶³

Duke u bazuar në shumë hulumtime dhe studime, studiues të shumtë të kulturës shqiptare, e më konkretisht, ata që u morën me llojete veshjeve popullore në aspektin diakronik e sinkronik dhe duke vënë në plan të parë elementet e përbashkëta, i përcaktuan dy tipa veshjesh: *tipin e gunës dhe tipin e xhubletës*.⁶⁴ Këto dy tipa sipas Zojzit *“përfaqësojnë rreth tyre të gjitha veshjet e përcaktuara si veshje autoktone në përdorim të popullit shqiptar”*.⁶⁵ Sipas veçorive të saj, veshja e Rrafshit të Dukagjinit i përket tipit të veshjes me gunë. Kjo veshje e paraqet një tip të veçantë në kuadër të veshjeve popullore shqiptare, dhe hyn në grupin e 140 formave të ndryshme, të veshjeve popullore të njohura deri më sot.⁶⁶

⁶³ Rrok Zojzi, *Gjurmë arkaike në veshjet tradicionale të popullit shqiptar*, Studime Ilire, II Rilindja, Prishtinë 1978, f. 249-250.

⁶⁴ Rrok. Zojzi, *Mbi veshjet tradicionale të popullit tonë*, Studime Historike, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë 1965, f. 145; *Gjurmë arkaike në veshjet tradicionale të popullit shqiptar*, punim i cituar f. 252;

⁶⁵ Rrok Zojzi, *Gjurmë arkaike në veshjet tradicionale të popullit shqiptar*, punim i cituar, f. 252.

⁶⁶ Rrok Zojzi, *Mbi veshjet tradicionale të popullit tonë*, punim i cituar, f. 143; *Gjurmë arkaike në veshjet tradicionale të popullit shqiptar*, punim i cit., f. 249.

Kosova si një shtet i vogël për nga hapësira gjeografike, është e pasur me veshje e variante të tyre të cilat dallohen sipas regjioneve. Pra, secila veshje dallohet nga njëra-tjetra, ka karakteristikat e veta, si; materiali, teknika e punimit, mënyra e dekorimit të kokës, koloriti, aplikimi i motiveve etj. Të gjitha veshjet i karakterizon punimi me shije estetike të veçantëtëshprehur përmes ornamentikës. Sa i përket kësaj larushie veshjesh, studiuesja Onuzi mendon se “*në panje tëparë, të krijohet përshtypja se kemi të bëjmë me një shumëllojshmëri veshjesh, sidomos të atyre për gra. Në fakt, ato janë variante tejet të shumta në numër, por klasifikohen në tre tipe kryesore veshjesh, për gra dhe në një tip për burra.*⁶⁷ Në grupin (tipin) e parë i ajo ka futur veshjet me këmishë të gjatë dhe dy futa. Kjo veshje ka qenë e përhapur më shumë në fshatrat e Rrafshit të Dukagjinit, në Rugovë, në Has, në Drenicë, si dhenë luginën e Preshevës. Në grupin e dytë hyjnë veshjet me mbështjellës (fustanellë) e përhapur në fshatrat e Opojës (me ngjyrë të bardhë) dhe në ato të Gorës (në variantin me ngjyrë të kuqe). Ndërsa në grupin e tretë i ka vendosur veshjet me dimi. Sipas saj, edhe pse kjo veshje është shfaqur vonë në arealin etnokulturor shqiptar, gjeti përdorim të gjerë për shkak të disa rrethanave social-kulturore, por edhe për praktikitetin e saj, kryesisht në Rrafshin e Kosovës, në Krahinën e Karadakut, të Gollakut, si dhe në Shalën e Bajgorës. Ndërsa sa i përket pasurisë së këtyre tipave me variante, më i pasur në variante dhe në vlera artistike paraqitet ai “me këmishë dhe dy futa”, i cili në njësi të ndryshme etnografike të Rrafshit të Dukagjinit paraqitet njafë i larmishëm.”⁶⁸

⁶⁷ Afërdita Onuzi, *Veshjet popullore shqiptare në Kosovë*, Kultura popullore 1-2, Tiranë 2009, f. 52.

⁶⁸ Afërdita Onuzi, po aty, f.54.

Variant i këtij tipi të veshjes është edhe veshja tradicionale e grave në Rrafshin e Dukagjinit, apo siç njihen në popull “*vesha me lidhçë e mahramë*”, “*teshat e katunit*”, “*vesha mehotoz*”, e cila është marrë në trajtim në këtë punim.

Kjoveshje dallohet për nga thjeshtësia dhe bukuria që shfaqet në të. Nuk është veshje e ngarkuar me shumë “zbukurime” dhe ngjyra. Në të si zbukurime kryesisht është qëndisur ndonjë lule e vogël, simboli i gjarprit etj., dhe ngjyrat kryesisht kanë qenë të lehta. Si- veshje përbën një thesar të pasur të kulturës sonë materiale- po- pullore. Por, edhe kjo si çdo veshje tjetër pati rrugën e saj evoluti- ve. Pas viteve të 70-ta, përdorimi i saj filloi të zbehej secilën herë e më shumë. Po ashtu, edhe mënyra e të veshurit pësoi ndryshime të mëdha.

Meqë veshja tradicionale shpreh simbolikë të caktuar, për kultura të caktuara, atëherë në vazhdim të këtij punimi do të paraqitet stru- ktura e veshjes së grave në Rrafshin e Dukagjinit dhe elementet përbërëse të saj gjatë kohës kur ajo ka qenë veshje e përditshmërisë, por edhe sot që ka mbetur më shumë veshje ceremoniale që prefe- rohet nga nuset e reja.

Materiali, mënyra e punimit dhe ngjyrosjes

Materiali më të cilin janë punuar veshjet, shtrojat dhe mbulojatka qenë leshi i deleve dhe i dhive. Por për të arritur deri të produkti finalishte një punë shumë e madhe, duke filluar nga rritja e bagëtive nga të cilat merrej lënda e parë, pra leshi, për të vazhduar me qe- thjen, larjen, lënurjen, tjerren e endjen, shkaljen e zhgunit e deri të puna që bëhej në thurjen, endjen nëvegje apo qëndisjen varësisht se çka punohej. Për këtë arsye studiuesja Onuzi, sa i përket endjes shprehet: “*Mjeshtëria e të endurit nuk është vetëm ndër më të her-*

*shmet; ajo konsiderohet edhe ndër më të rëndësishmet për vetfunksionin që ka kryer. Prodhimet e saj shërbenin për të veshur anëtarët e familjes, për të pajisur vendin e fjetjes dhe mjediset e tjera të banesës, për nevojat e transportit, etj. Për këto arsye ajo ishte edhe ndër më të përhapurat dhe më të suksesshmet, si në fshatra, edhe në qytete*⁶⁹. Gjithashtu, për punimin e tekstileve konkretisht veshjeve është përdorur edhe *lini, pambuku dhe mëndafshi*.

Në trajtimin e kësaj tematike, përveç shfrytëzimit të literaturë përkatëse, burime shumë të rëndësishme kanë qenë të gjeturat në terren. Një nga informatorete intervistuar është Mirushë F. Ndër të tjera, ajo tregon se ka filluar të punojë veshje tradicionale në “ma-qinë” nga mosha 18 vjeçare. Këtë profesion e ka praktikuar deri para luftës së fundit në Kosovë, pra vitin 1999. Gjatë punës së saj 30 vjeçare, këto veshje i ka punuar kryesisht me porosi, por i ka shitur edhe në tregun e Pejës. Gjithashtu, ajo tregon se fillimisht ka nisur të punojë në vek qilima, nga mosha 14 vjeçare, e pastaj edhe pëlhura. Ajo tregon se “*Gjansia e pelhures u kon’ 40 cm, e gjatsia qeosht’ dashtme u punu n’vek 100 m. (pa shkëputje). Për një kmishë janë shku 10 m. për nuse, e për plaka ma pak. Edhe punimi i pelhurs për plaka asht ba ma ndryshe, prej “pamuki” i thoshin, e për nuse nryshe, ajoosht’ kon’ ma e udo: b (e dobët). Ja kan’ ba midisinpër me i da katet, i ngjyshin n’kllapesh t’arres, disa tjera me t’zi i kan’ ngjye me lkurë verri e arre. Te t’mesmet janë shku ma gjon ato katat (vijat), e për pelhurat ma t’mira jan’ qit edhe skejeve, n’tre rena. Per t’linat e burrave o kon pelhura e trash, o kon tjeter, i thoshin për pelhure te burrave. Ata pej (qe kan thur pelhuren) jan’ ble n’Pej’, prej se e mban ne mend kjo*”.

⁶⁹ Afërdita Onuzi, *Besime e rite rreth mjeshtërisë së endjes*, Kultura popullore 1-2, Tiranë 1976, f. 47.

Pra, kanë qenë tri kategori tëpëllhurës, e “udob” (e dobët,) për plaka, e mesme për gra më në moshë, dhe e mira për nuse. Dallime ka pasuredhe punimi veshjeve nëmakinë, sepse ka dalluar shumë sa i përket moshës, ajo për nuse ka pasur shumë “*punim*” (qëndisje), ndërsa për gratë më në moshë më pak, e ajo e plakave shumë pak.

Edhe veshja e nuseve i ka pasur tri kategori: *Njo vetem për dasma qe o kon ma e mira, pak ma e “udob” kur kan’ dal më shku di-kund, e ajo e treta qe i kan’ vesh neper shpi. Edhe marhamat jan’ punu n’vek, pejtu blejshin n’Pejë, u matke nji here nji marham sa osht, e toni sa marhama dojshe me i lshue qaq e bajshe masen, za-konisht i bajshin 100 marhama. Plakat i kan’ pas ma t’shkurta e ma t’ngushta, e nuset ma t’gata e ma t’gjona. Ne Pejë u blejkepeni (peri) i thoshin, “bogosi”, o kon i zi e u prishke (shprishke), e i mush’shim fytzat per me i ba dorat, knej shtatin e bojshe me pa-muk, per t’rejat u bojke me mnash, e per plaka pamuk, dorat për plaka veç me vija, për t’reja u shkrusjhin me draspermas, masi u kryke trupit. Pra, punimi apo dora e marhamës, ornamentika janë punuar në fund. Kur osht kry dora e ke lon’ kapak ne kryt per me u nise tjetra, nuk jan’ pre. Marhama per nuse u “shkrujke” (punojke) edhe ka pjesa e gojes, per plaka u bajshin veq vija. Dora u shkrujke me fitila, diku i qitshe lula, diku me dras u dajshin ata katat, me shara rena –rena.*

Prerja (premja) e këmishës kishte shumë rëndësi, ishte një proces i veçantë dhe shumë i rëndësishëm të cilin nuk kanë ditur ta bëjnë të gjitha gratë që e kanë punuar këtë veshje. Mirusha e bën përshkrimin për mënyrën e prerjes së këmishës kështu: *Mas pari u prejke nji cop’ e madhe para e mas, dektejna nji pllom ner gu, kjo ishte gja-tsia. Tonshi e mershe e bojshe dyfish, mongen e prejshe prej brrylit e dejktena te cepi i krahit* (prej cepit krahit deri te bërryli), *mandej*

e bajshe pelhuren tre fish e prejshe si per t'kim (anash, pjerrtas), kina u thoshin atyne, toni jetshin tre knejna e tre anejna 6, tonshi e mershe e prejshe jaken, (është hapur vendi ku do të ngjitej jaka pastaj) e mas jake vike gryka, e qelshe edhe ata(gryka është hapur— prerë vetëm një vije teposhte). Masi prehej pelhura, preheshin edhe pjest e tjera, funi, jaka, gryka, sanaku kapeshin (ngjitheshin) për pelhure— knishe. N'fund prehej lidhca. N'ket menyrr' kompletehej knisha. Deri sa n'pazar nuk pat hy' perdorimi i "pafitit" edhe kto (pjesët tjera)jon' kon' prej pelhures."

Ngjyrosja etekstileve është mjaftë e rëndësishme. Fillimisht janë përdorur ngjyrosësit natyror, derisa kanë filluar tëpërdroreshin ngjyrosësit kimik, dhe në fund tëprodhoheshin tekstile të fabrikua— ra. Nga pikëpanja formale artistike, ngjyrat në veshje e tekstile shqiptare tradicionalisht janë përshtatur e harmonizuar me tipa e modele të ndryshme sipas krahinave etnografike ku përdroreshin⁷⁰. Bido, duke u mbështetur në faktorë të ndryshëm historikë, ekonomik etj., *larminë koloristike të veshjeve dhe tekstileve shqiptare*, pra ngjyrosjen e tyre, e ka grupuar në tri sisteme kryesore: 1. *sistemi njëngjyrësh (monokrom)*; 2. *Sistemi dyngjyrësh (bikrom)* dhe 3. *Sistemi shumëngjyrësh (polikrom)*.⁷¹

Veshja tradicionale e Dukagjinit, sa i përket mënyrës së zbukurimit pra qëndisjes, hyn në sistemin e parë, pra qëndisja njëngjyrëshe. Ky lloj zbukurimi në popull dhe në literaturën etnologjike njihet si qëndisje *e bardhë mbi të bardhë* ose qëndisje *e zezëmbi të zezë*. Pra, kemi qëndisje me fije të bardhë mbi sfondin e bardhë të pëllhurës

⁷⁰ Agim Bido, *Sistemi tradicional njëngjyrësh në zbukurimin e veshjeve dhe të tekstileve shqiptare*, Kultura popullore 1-2, Tiranë 1997, f. 35.

⁷¹ Agim Bido, *Sistemi tradicional njëngjyrësh në zbukurimin e veshjeve dhe të tekstileve shqiptare*, vep. e cit., f. 35.

dhe qëndisje me fije të zezë mbi sfond të zi.⁷² Të gjitha qëndisjet në pëlhurën e bardhe të këmishës, lidhcës apo marhamës bëhen me penj të bardhë, në mënyrë të njëjtë veprohet edhe në punimin e çorapëve të cilat thuren me kërrabëza, ose punohen me gjypner, pastaj edhe pështjellakët kryesisht qëndisen (punohen) me të njëjtën ngjyrëme të cilën është endur pëlhura në vek. Zakonisht këto lloj qëndisjesh nuk bien fort në sy së largu, por kur i vëren së afërmi, madje edhe kur prek sipërfaqe të tilla të qëndisura përjeton një kënaqësi estetike të veçantë, qoftë për relievin e krijuar, qoftë për harmoninë brenda së njëjtës ngjyre⁷³. Pra, ornamentika e cila i zburon mund të vërehet qoftë me sy ashtu edhe më prekje. Për të fituar ngjyrën e bardhë dhe të zezë në këtë rast nuk ishte e nevojshme që të përdorëshin ngjyrosës, sepse pëlhura ishte e endur nga peri i bardhe, ndërsa ngjyra e zezë merrej nga leshi i deles së zezë. Në këtë mënyrë është vepruar, para se të hynin në përdorim ngjyrosësit kimik, *aty nga dhjetëvjeçarët e fundit të shek. XIX,*” përderisa ‘*bojërat me bazë aniline janë përdorur në industrinë tekstilë rreth viti 1870*’⁷⁴

Para se të fillonte përdorimi i këtyre ngjyrosësve kimikë janë përdorur ngjyrat natyrale, që nënkupton leshi i deles së bardhë dhe i deles së zezë, dhisë së bardhë, të kuqe, të zezë dhe gri, ose eventualisht janë ngjyrosur me ngjyrat e fituara prej drunjveedhe bimëve, ku janë shfrytëzuar lëvozhga, gjethet apo edhe fryti i tyre.Me kombinimine perit nga leshi i deles së bardhë më atë të deles së zezë është përfutur ngjyra gri. Për të arritur tonin e ngjyrës së dëshiruar, fiksimin e ngjyrës, qëndrueshmërinë, gratë kanë përdorur edhe

⁷² Agim Bido, po aty, f. 35.

⁷³ Agim Bido, po aty, f.40.

⁷⁴ Aferdita Onuzi, *Përdorimi i ngjyrosësve natyrorë dhe kimikë në tekstilet tona popullore*, GJAFE. 28-29, Prishtinë 2001, f.43-44.

sheqer, yndyrë, hi, kripë deti, uthull, lëngtë mollëve të egra, lëng të lakrave turshi, urinëtë lopëve etj. Më fillimin e përdorimit të ngjyrosësve kimikë kanë filluar të përdoren edhe okside metalesh, e që kanë shërbyer për të fiksuar ngjyrat. Një i tillë ishte edhe sulfati i hekurit që në popull njihet me emrin *karabojë* ose *kosej*.⁷⁵ Përveç këtyre, në disa krahina, si Çermenikë, Kurvelesh, Korçë e Zagori është përdorur guri i njohur me emrin *llullan* ndërsa ngjyrën e kanë quajtur *llullaq*. Ndërsa në disa fshatra në rrethinën e Pejës, Mat, Librazhd etj., ngjyrën e kuqe (tullë) e kanë përgatitur me argjilë të kuqe apo *mellë* siç njihet në Kosovë. Ngjyrat kryesore të cilat kanë mundur të përfitohen nga gjethet, lëkura, rrënjët, lulet, frutat e bimëve dhe drunjve të ndryshëm janë: e zezë, e kuqe, e verdhë, e gjelbër, kafe (me disa nuanca), etj.⁷⁶

Vlen të theksohet këtu se secila grua e kishte metodën dhe mënyrën e vet për të fituar ngjyrën bazë por edhe nuancat tjera, aty ndikonin shumë faktorë, duke filluar me sasinë e penjve, ujit, kohës së zierjes, mënyrës së zierjes, sasisë së lëndës me të cilën janë ngjyrosur, prandaj kishte disa nuanca të ngjyrave bazë. Këto ngjyra ishin shumë më të qëndrueshme (se ato kimike), pra ato nuk e humbasin (shlyheshin) ngjyrën derisa sa konsumohej (çkyhej) materiali.

Duke u bazuar në të gjitha mënyrat dhe format e përfitimit të ngjyrosësve të tekstileve tona popullore kemi tri kategori të mënyrës së përfitimit të ngjyrave: 1. Ngjyrat nga peri –leshit natyral i deleve, që ishte e bardhe, e zezë (galmë), si dhe përzierja e leshit të bardhe më të zi e që përfitohej ngjyra gri. Ndërsa nga leshi i dhisë së kuqe, të zezë, gri dhe të bardhë, nga këto kombinime përfitoheshin

⁷⁵ Afërdita Onuzi, po aty, f. 52; f. 60.

⁷⁶ Afërdita Onuzi, *Përdorimi i ngjyrosësve natyrorë dhe kimikë në tekstilet tona popullore*, punim i cituar, f. 50-51.

tone të ndryshme e shumë herë, “*të pa përsëritshme*”.⁷⁷ 2. Ngjyrat e fituara nga ngjyrosës natyrore, pra bimët dhe drurët, janë përfituar këto ngjyra me të gjitha nuancat e tyre: e zezë, e kuqe, e verdha, kafe, blu ose “*llullaq*”, gjelbër. 3. Ngjyrosësit kimikë nga të cilët përfitoheshin të gjitha ngjyrat bazë.

Më zhvillimin e teknologjisë, pra industrisë së tekstilit filluan të hynin në përdorim pëlhura dhe tekstile të fabrikuar që në një mënyrë i zëvendësuan materialet, tekstilet të cilat janë punuar në avlëmend, nga peri i deles, i dhisë, lirit, si dhe janë ngjyrosur me ngjyra natyrore dhe janë punuar në vegje, kërrabëza e gjypner. Koloriti i ngjyrave, puna e realizuar me shumë finesë, ornamentika shumë e pasur në tekstilet popullore, tregon për punën dhe përkushtim e gruas, jo vetëm për tu veshur, përgatitjen e shtrojave dhe mbulojave, por edhe për zhvillimin e ekonomisë familjare, pasi që është punuar edhe për tregun. Shumë familje kanë jetuar nga këto prodhime, duke filluar, me leshin e deri tek të gjitha tekstilet tjera.

Ornamentika popullore në veshje

Ornamentika në krijimet tona popullore është e njëjtësi në tekstile (veshje, shtrojë, mbulojë) ashtu edhe në drugdhendje, metalpunues, poçeri, latues të gurit, etj. Sa i përket ornamenteve në veshje, e konkretisht në veshjen e grave të Dukagjinit, përmbledh shumë motive me figura gjeometrike këndore, zigzage, apo linja të thyera, ku sipas studiueses Andromaqi Gjergji, janë përdorur edhe në motivet ilire.⁷⁸ Studiuesi Agim Bido ornamentet e përdorura në

⁷⁷Aferdita Onuzi, po aty, f. 48.

⁷⁸Andromaqi Gjergji, *Përkime midis ornamentikës popullore shqiptare dhe asaj ilire*, Studime Historike, 1, Tiranë 1973, f. 169-173; *Përkime midis ornamentikës*

traditën tonë konkretisht në tekstile, shtrujë, mbuloje veshje, të cilat gjejnë përdorim në Malësinë e Veriut (në këtë regjion hynë edhe veshja që e kemi marrë në trajtim) ku *“përdoret tipi i veshjes me këmishë të gjatë e dy futa për gra”*,⁷⁹ i ka ndare në tri grupe duke u bazuar në mënyrën e shpjegimit të vendasve—popullor. Në grupin e parë ka vendosur ornamentet me motive krahasuese, duke i krahasuar me florën (lule), yjet, (hana, dielli), faunën, mace (thonj mace). Gjatë shpjegimit të tyre përdorin pjesëzën krahasuese, “si”. Në grupin e dytë ka vendosur motivet me shpjegim gjeometrik, këto ornamente më shumë janë të përhapura në tekstile (shtrujë e mbulojë) sesa në veshje, ndërsa grupi i fundit është me motive pasqyruese e simbolike, pra në shpjegimin e tyre i krahasojnë me gjera konkrete, si vath, byzlyk dore, dorë, aeroplan, etj. Si pjesë e këtij grupi i ka vendosur edhe motivet me funksion simboliko—magjik, duke i krahasuar motivet me hajmali, toksin (gjarprin) etj.⁷⁹ Të gjitha këto motive dhe ornamente gjejnë vend dhe janë përdorur edhe në këtë veshje, disa më shumë e disa më pak. Motivët dhe ornamentika që na paraqitet në këtë veshje të bukur janë kryesisht gjeometrike, por edhe motivet floreale: gjethe, lule të ndryshme, nëpër mes të cilave dëshirohet të tregohet gjallëria, vitaliteti, jeta etj. Këto motive janë të pranishme në të gjitha pjesët e veshjes, si në këmishë, çorape, e pështjellak. Pështjellaku ishte kryesisht i punuar me *“motive gjeometrike”* në *“sakica”*, e *“topa”*. Këto motive janë shumë të lashta me simbolikë solare, që kanë të bëjnë më kultin e diellit.⁸⁰

popullore shqiptare e asaj ilire, Studime Ilire, II Rilindja, Prishtinë 1978, f., 231-247.

⁷⁹ Agim Bido, *Arti popullor në veshje e tekstile*, Tiranë 1991, f. 125-167.

⁸⁰ Ukë Xhemaj, *Etnokultura shqiptare në Podgur*, Prishtinë 2003, f. 142.

Punimi, qëndisja apo ornamentika në këto veshje është mjaft artistike, ka një simetri dhe harmonizim në mes tëornamenteve, gjithashtu kombinimet e ngjyrave janë mjaft estetike, nuk ka ndonjë kontrast shumë të madh, kryesisht janë penj të bardhe të qëndisur në të bardhensa i përket këmishës, ndërsa çorapet e zaza e pëshjtjellakët po ashtu janë të punuar më të zezë, përderisa *polla* (baza për qëndisjen e peshjtjellcit) mund të jetë ngjyrë kafe për plaka dhe e zezë për nuse e gra të reja. Pra, ngjyrat bazë në këtë veshje janë e bardha dhe e zeza, ndërsa e kafta është përdor për pollat e pëshjtjellakut, e në disa rasteçorapet për veshjen eçikaveapo me pshjtjellc kanë qenëtë kafta, pshtjellci ngjyrë hiri. Ndërsa shoka kishte ngjyrat që ishin mjaft karakteristike, dalluese: *e kuqja, e gjelbra, e verdha, e zeza* etj.⁸¹ Gjithë kjo punë tregon për talentin dhe përkushtimin e grave që e kanë punuar këtë veshje. Veshja si e tillë konsiderohet art dhe bart në vete vlera artistike popullore. Sa i përket pranisë dhe dominimit të ngjyrës së bardhë në këtë veshje, disa udhëpërshkrues të huaj në shekujt XVII e XIX, duke kaluar nëpër Pejë, Deçan, Gjakovë e qytete tjera, i kishin përshkruar veshjet e vendasve që dominonte ngjyra e bardhë e që nuk kishte as dallime të theksuar në mes të përkatësive të ndryshme fetare.⁸²

Sa i përket dallimeve fetare në ornamentikë në këtë veshje, *e argumentojnë subjektet tona, Marija, e cila e ka veshur këtë veshje dhe tregon që nuk ka pasur dallime në aspektin fetar. Po ashtu subjekti tjetër, Mirusha, e cila për 30 vite e kishte punuar këtë veshje, asnjëherë nuk kishte pasur ndonjë kërkesë të veçantë në qëndisjen e ndonjë simboli fetar, siç mund të jetë kryqi, apo ndonjë simbol tjetër, i cili mund të bënë diferenca fetare. I vetmi dallim sa i*

⁸¹ Ukë Xhenaj, po aty, f. 142.

⁸² Hasan Zekaj, *Gjytetet thërrasin ndërgjegjen, (Kujtesë e trashëgimisë kulturore rreth Krasniqes së Vëndit)*, Prishtinë 2011, f. 254.

përket kësaj veshje te myslimanet dhe katolikët e që ndoshta vlen të përmendet, tregon ajo, është se (pasi që katoliket varrosen me teshat) *plakat i kan' porosit teshat postafat sa ishin gjall', i bojshin veshat për dek, me krejt komplet, me marham e lidhc, shpollak, çorape, jelek. Une jau kom kep, kmish, lidhc e marham, ato tjerat i kan porosit tjetër ka''*.

Mendësia e atëhershme popullore, ka qenë mjaft e lidhur me besime dhe besëtytni të ndryshme lidhur me natyrën, syrin e keq, magjinë e zezë etj., dhe kryesisht disa nga motivet e qëndisura në veshje janë të mbështetura edhe në këto besime.

Tek kjo veshje më shumë ka qenë e shprehur si motiv lulja, mandej motivi i gjarprit. Ky simbol ka mbijetuar që nga ilirët e deri në ditët tona. Gjarpri është kafshë e cila me domethënien e vet të shumëfishtë zë vendin qendror në strukturën religjioze simbolike. Gjarpri është kafshë toteme, simbol i mençurisë, i së keqes, shëndetit, plleshmërisë, mbrojtës i vatrës së shtëpisë e mbi të gjitha kafshë h'tonike⁸³. Simboli i gjarprit ishte dhe vazhdon të jetë një nga simbolet më të shprehura në veshje. Sot këto motive janë më shumë te shprehura si dekorime në veshje (si aksesori, i cili kapet, qoftë gjarpri, kalaveshi i rrushit), ka motive nga më të ndryshmet, po ashtu edhe ngjyra më të theksuara.

Veshja sipas moshës

Prania e kësaj veshje është mjaft e gjerë, “duke filluar me pjesën veriperëndimore të Rrafshit të Dukagjinit, përkatësisht të “nahijes” së Pejës e të Gjakovës, prej Urës së Fshajtë të Drinit afër Gjakovës e deri në Istog, dhe prej Junikut deri në Klinë. Kjo pra, është një

⁸³ Aleksandër Stipčević, *Ilirët*, Toena, Tiranë, 2002, f. 309.

zonë njaft e madhe etnografike, në të cilën bëjnë pjesë si zona më të vogla të këtij lloji: Reka, Dushkaja, Vokshi, Lugu i Baranit, Lugu i Leshanit, Lugu i Drinit, Podguri i Pejës dhe “katundet e Strellcit” – rrëzë Bjeshkëve të Nemuna, prej Peje deri në Deçan, ku fillon Reka. E njëjta veshje është edhe në rrethinat e Tropojës të Malësisë së Gjakovës në Shqipëri”.⁸⁴ Pa dyshim që ekzistojnë dallime në nuanca të vogla, në mënyrën e emërtimit të pjesëve të veshjes, mënyrën e veshjes, përshkrimin e ornamenteve por si tersi është e njëjta.

Si çdo veshje tjetër, edhe kjo e pati rrugën e saj evolutive. Megjithatë është ndër veshjet popullore që më së shumti arriti të ruaj formën dhe origjinalitetin e saj. Pas viteve të 70-ta, përdorimi i saj filloi të zbehej çdo herë e më shumë. Në disa treva është përdorur si veshje e përditshme deri në kohën e luftës së fundit, pra deri në vitin 1999, kryesisht nga moshat e vjetra. Ndërsa pas luftës ajo u largua pothuajse krejt si veshje e përditshme.

Kemi dy lloje kryesore të veshjes, ajo e çikave ose me “*pshtjellc*”, dhe ajo e grave, për mosha të ndryshme, nga nusët e deri të plakat.

Në përshkrimin e kësaj veshje është shfrytëzuar literatura e studiu – esve të ndryshëm që janë marrë mëtë dhe veshjet tradicionale në përgjithësi, si dhe nga subjektet e intervistuar gjatë punës hulumtuese në terren. Një nga subjektet Mirusha (72 vjeçare), e cila e ka punuar këtë veshje, e ka veshur si veshje tradicionale atë *mepsh-tjellc*, po ashtu edhe atë me “*marham e lidhcë*”. Subjekti tjetër, një grua e moshës 78-vjeçare, dhe sot vazhdon ta bart veshjen me “*marham e lidhcë*”, siç i thotë ajo. Dallimet në veshje nga vajzë,

⁸⁴ Mark Krasniqi, *Lugu i Baranit, (Monografi etno-geografike)*, Prishtinë 1984, f. 150.

nuse dhe plakë subjektet itregojnë me të gjitha elementet dhe dallimet që janë bërë në veshje, si: materialin, prerjen, punimin, (ornamentikën) dhe ndryshimet që kanë pësuar ato.

Veshjet që i kanë punuar kryesisht kanë qenë të klasifikuara edhe për qëllime të caktuara, p.sh: veshjen për punë e kanë pasur më të vjetër, veshjen me të cilën kanë dalë i kanë kushtuar më shumë rëndësi, kurse veshjes së nusërisë, përveç që ka qenë më e mirë, i kanë kushtuar rëndësi edhe pëlhurën e kanë përdorur më të mirë. Edhe veshjes së “*dekës*” (te gratë e besimit katolik) plakat i kanë kushtuar shumë rëndësi, dhe e kanë ruajtur me shumë xhelozë. Pra, sipas subjektit Marije, për martesën e saj, i ka punuar tri veshje: *vesha e pare, (e mira), veshja e dyte, dhe veshja e trete, për ndonjë rast të caktuar.*



Foto 1. Veshja e çikave me pshtjellë, origjinale (1957). Fshati Shushicë–Istog*.

⁸⁵<https://www.facebook.com/groups/AlbanianVintagePhotography/permalink/2861670653908689>, [qasur më 1 shtator 2020].



Foto 2. Veshja e çikave me pshtjellc e modifikuar*.

Kjo veshje është veshur nga të gjitha vajzat dhe është veshje e cila është trashëguar brez pas brezi. Po ashtu edhe puna në vek ka qenë punë përcjellëse ndër breza, nënat i kanë mësuar të bijat e tyre të endin ose të punojnë me të. Punën me këtë mjet kanë ditur ta bëjnë pothuajse të gjitha vajzat dhe gratë. Karakteristikat kryesore të veshjes si vajzë kane qenë këto: vajza deri në moshën 13–15 vjeçare në kokë kryesisht nuk ka vendosur asgjë, flokët i kanë mbajtur të shkurtra, të qethura më “*briskrrueze*” ndërsa në maje të kokës e kanë lëshuar një tufë flokësh, të gjata, të cilën e quanin “perçe”.⁸⁷ Pas moshës 15vjeçare, pas hyrjes në pubertetet flokët i kanë bërë

⁸⁶<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=1008739785986742&set=pb.100005521904069.-.2207520000..&type=3> [qasur më 10 gusht 2020].

⁸⁷ Ukë Xhemaj, *Etnografia shqiptare në Podgur*, vep. e cit., f. 153-154.

gërshet apo "bistak" siç shprehet subjekti (Marije Hamza, 69), dhe kanë vendosë shami me ngjyra të ndryshme, p.sh e hirit me zbukurime apo me lule. Këto shami nuk janë punuar por kanë qenë të blera në treg. Më pubertetin lidhet edhe bartja e pështjellakut të prapmë, sepse deri në atë moshë e bartnin vetëm pështjellakun e parë.⁸⁸ Kromatikja e veshjes së çikave ishte e kufizuar kryesisht në dy ngjyra, e bardhë dhe e zezë, me ndonjë përrjashtim, për shkak të statusit të tyreveshja duhej të ishte me e thjeshtë, që nuk bi në sy. Ndërsa subjekti tjetër, Mirusha veshjen e çikave na e përshkruan në këtë mënyrë: "*Vesha e çikave, përpara jon' kon' shpollakt t'udob. Kapak jon' kon' t'punum, ka 3 gishtjon' kon' pakez ma t'mdhaj. Jon kep brekt ma t'gjata ner gu, tonshi çorapat i kan' pas t'bardha e ngjyr kafë, t'zeza nuk i kan pas. Nalt e kan' vesh knishen, punim s'ka pas, bo vaki veç me naj tegel, qashtu i kan' pas t'thjeshta, e ka pas edhe jaken e vogel. Edhe shaminë e majshin n'kry, e lidhshin ner fyt, ajo o ble, o kon prej pafitit (patiska)*". Ajo nuk ka një shpjegim për kalimin nga vesha me pështjellak në atë më pshjtjellc, por sipas studiuesit Ukë Xhemaj: *Koha e lëshuarjës së flokëve dhe fillimi i bartjes së pështjellakut të prapmë, mu në moshën e pubertetit, e cila në traditën popullore konsiderohet si fázë e pjekurisë, ofron mundësinë për njohjen e një besimi të lashtë popullor, që ka të bëjë me ceremoninë arkaikë e rituale, të dikurshme-pagane si gjurmë të iniciacionit*⁸⁹. Pra, ka të bëjë me ritet e kalimit që në traditën tonë popullore u është kushtuar rëndësi, qoftë në veshje ashtu edhe në veprime. Kalimi i veshjes sëçikave nga veshja me pështjellak në atë me pshjtjellc na vjen si *risi morfologjike-strukture*⁹⁰. Ndërsa veshjen më pshjtjellc Mirushja e

⁸⁸ Po aty, f. 154.

⁸⁹ Ukë Xhemaj, po aty, f., 154.

⁹⁰ Ukë Xhemaj, po aty, f., 154.

përshkruan kështu: “*Ma vone jon’ kon’ pshtjellcat posht, e nalt knisha, jo shum’ e gat sa me hy ner pshtjellc. Knishat jon’ kon’ me krah t’gat. Pshtjellci o bo edhe ai n’vek. Dikur ma vone u blejke materiali. Jon kon’me ngjyra, kafë, hini, t’zeza. Çarapt u bojshin me krrabza e t’gata deri mi gu e pshtjellci vike deri n’gu. Kur u ulshe shkojke permu gu, e ne kome deri n’gu.*”

Duke u bazuar nëliteraturën, përshkrimin e subjekteve, disa fotove familjare, por edhe nga vëzhgimet në terren e shohim se materialet e kësaj veshje kanë qenë të punuara në vek, këmisha ishte e materialit pëlhurë, ishte shumë e thjeshtë dhe pa ndonjë zbukurim apo motiv të caktuar. Për motive dekorative tek veshja e vajzave as që mund të bëhej fjalë. Këmisha ka qenë me mëngë të gjata por edhe disa me mëngë të shkurtra. Jaka ishte e ngushtë dhe pa zbukurime. Pështjellakë po ashtu sikurse këmisha kanë qenë shumë të thjeshta dhe pa zbukurime, të punuara prej leshit të deleve, të ngjyrosura me ngjyra nga ngjyrosësit natyror që i kemi paraqitur më lart. Pjesë përbërëse e kësaj veshje kanë qenë edhe çorapet e gjata deri në gjunjë, nga peri i leshit, më vone edhe sintetike, të punuara me gjypner(grep), apo kërrabëza, ndërsa si mbathje kanë shfrytëzuar opingat. Mbi këmishë kanë veshur jelek të punuar.

Shikuar nga aspekti socio-kulturor, veshjet pësonin ndryshime me rastin e ndryshimit të statusit të individit. Pra në këto raste veshja ishte ajo që reprezentonte këtë përfaqësim të dallueshëm të imazhit të individit nga të tjerët, me rastin e ndryshimeve që i pësonte gjatë jetës. Dallimi i veshjes së vajzës ndryshon shumë pak pasi që ajo të jetë fejuar. Fejesa e vajzave është bërë në moshë fare të re, po ashtu edhe subjekti (Marija 69) është fejuar fare e re, dallimi i veshjes së saj ka qenë përdorimi i pak më shumë i zbukurimeve.



Foto 3. Veshje për gra në moshe më të re. Nga arkivi familjar (Deçan).



Foto 4. Veshje e nuseve⁹¹.

⁹¹ <https://www.facebook.com/1594374677461704/photos/a.1594379460794559/1814562965442873/?type=3>, [qasur me 27 gusht 2020].

Veshja e nuseve—grave, në mënyrë të veçantë ajo e nuseve është varianti më i bukur, aty është shkruirë e gjithënjeshhtëria në “*orna—mentikën dekorative*”, por edhe në “*planin strukturalo—morfologjik*”. Transformimi i kësaj veshje në planin morfologjik është bërë gjatë Luftës së Parë Botërore, përderisa evoluimi i një shkalë më të lartë është bërë në periudhën mes dy luftërave botërore.⁹² Si rezultat i këtyre ndryshimeve është bërë edhe zëvendësimi i disa elementeve të kësaj veshje. Në këtë mënyrë, “*kapuçi me parë*” u zëvendësua me *lidhcën*. Materiali i saj fillimisht punohej në vek, por që më vonë u zëvendësua me “*pat*”, i cili blihej në tregjet e qyteteve, qoftë në Pejë apo Gjakovë.

Në “*çejzin*” (pajën) e nuses duhej të ishin më së paku 3 deri në 5 veshje, të cilat visheshin me raste të ndryshme. Më e mira ishte për ditën e martesës, pastaj për dasma, apo “*mizhlic*”, si e quajnë në këtë anë, përshkuarje në vizita, për shtëpi, për të punuar në fusha (punët e bujqësisë), gjithashtu në mesin e këtyre veshjeve ishte edhe “*veshja e harçit*”⁹³ e cila vishej në raste pikëllimi—vdekje në familje. Në raste të zisë, në kokë kanë vendosur shamia por jo të zeza. Sipas subjektit Tones, malësoret në të kaluarën nuk kanë vendos në koke shamia të zeza, ndërsa sot në raste zie vendoset shamia e zezë ose bojëkafe. (fjala është për shqiptaret e besimit katolik, përderisa ato të besimit mysliman mbajnë shamia të bardha)

Si pjesë të veshjes të cilat punoheshin për “*çejz*” ishin edhe marhamat të cilat zakonisht ishin 100, kurse *lidhcat* 20 e më shumë. Në ditën e martesës vishej veshja më e mirë, por në kokë nuk i vendoseshin “*marhmë e lidhcë*”, pra nuk e kanë “*lidhë krytë*” por kanë vendosur shami të kuqe. Ky është i vetmi rast kur nuk vishej

⁹² Ukë Xhemaj, *Etnografia shqiptare në Podgur*, vep. e cit, f. 155.

⁹³ Po aty, f.161.

vesha komplet. Këtë e konfirmon edhe subjekti Marija e martuar ne vitin 1970, e cila për ditën e martesës, është veshur me veshjen tradicionale përveç në kokë ka pasur të vendosur shaminë e kuqe.

Pjesët prej të cilave përbëhej kjo veshje janë: këmisha e pëlhurës, e gjatë deri përfund gjurit, jakën e vogël që më kohë ajo filloi të bëhej më e gjerë, gryka që ishte pak e hapur, e pas saj vije “*sanaku*”, mëngët të cilat ishin të gjata e pastaj u shkurtuan deri te bërryli, prapa ishte fundi i këmishës. Jaka, gryka, “*sanaku*”, lidhca dhe fundi ishin të qëndisura fillimisht me gjilpërë e më vonë me makinë, po ashtu edhe pëlhura për këto pjesë u zëvendësua me paf. Fundi për kamishat e nuseve ishte i gjerë deri në 40 cm., por që ngushtohej më kalimin emoshës, sa më e shtyrë aq më i ngushtë. Qëndisja në këmisha për nuse bëhej edhe përfundi *sanakut*, si dhe përmbi fund. Pjesa më e bukur dhe që i kushtohej shumë rëndësi ishte edhe lidhja e kokës, që bëhej me *marhamë e lidhcë*, e cila për nuset e reja kishte shumë qëndisje si në ballë ashtu edhe në “*dora*” e saj të cilave u vendosshin edhe thekë, që lidhshin me “*nejë*” (nyje) në dorë por janë punuar edhe me kërrabëza. Marhama po ashtu ishte e qëndisur në pjesën ka fyti, po ashtu edhe dora e saj. Kishte shumë rëndësi mënyra se si lidhej koka, marhama për nuse lëshohej më gjatë deri përmbi gjoks, por që varësisht nga mosha ajo fillonte të shkurtohej. Rëndësi i kanë kushtuar edhe flokëve, pra “*kablushes*”(rregullimi i pjesës se përparme te flokëve). Flokët përmbi ballëduhej të dukeshin, sa më e re nusja, ajo (kablusha) dukej më e “madhe”. Lidhca vinte përmbi, lidhej prapa me dora të cilat lëshoheshin në shpinë.



Foto 5. Mënyra e dekorimit – Lidhja e kokës te plakat dhe nuset⁹⁴.

Pështjellakët janë dy, i përparmi dhe i prapmi. Janë punuar në vek, pastaj janë prerë nga dy polla; njëra më e ngushtë ndërsa tjetra më e gjerë për pështjellakun e përparmë, pollat e pështjellakut tëprapmë janë prerë mëngushtë dhe dypollat në një madhësi. Janë punuar me gjypner, rrethit me tegela dhe përbrenda, pështjellaku i përparmë është punuar/qëndisur më shumë se ai i pasmi. Në fund ju kanë ‘dredhur’ tojat me të cilat është shtrënguar në mes përmbi këmbishë. Këmisha palosej përpara dhe ngrihej deri te mesi, nëmënyrë që gjatësia e saj tëvinte deri te gjunjët. Prapa në kuka vendosej shoka e cila u zëvendësua më shall, me thek. Përfundi këmbishës visheshin *t’linat* nga pëlhura e pambuktë, në gjunjë vinin këmbëzat nga

⁹⁴<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=1220749034785815&set=pb.100005521904069.-2207520000..&type=3.>, [qasur 2 shtator 2020]

materiali i leshit të punuara në vek, të cilat në pjesën e epërme lidheshin me lina, kurse në pjesën e poshtme futeshin në çorape. Gjatësia e *komzave* ishte prej mbi gju deri ndër gju. Çorapet çdo herë ishin më ngjyrë të zezë, fillimisht nga peri i leshitë ndërsa më vonë punoheshin me mëndafsh, e kishin gjatësinë deri ndër gjunjë ku lidheshin me toja përreth gjurit. Çorapetjanë punuar n'krrabza, ato u "*shkrujshin*" me model, "*mbrapsht e mar*", apo me "*t'şjellne te gjilpons*". Para së të fillonte përdorimi i jelekut ishte "*mitani, i allaxhës, kishte mëngë të gjata e jakë të ngushtë. Kopsitej deri te fyti. Ishte i gjatë deri në brez, kurse në dy kapakët kishte nga një rend sumbulla. Zakonisht kishin ngjyrë të mbylltë vjollce. Bliheshin te terzitë në Pejë.*"⁹⁵ Ai më vonë u zëvendësua me jelekun, i cili po ashtu ishte i punuar në vek, dhe i dekoruar me gajtan në të dy kapakët dhe nëshpinë, nuk kishte mëngë as jakë, por më vonëkanë filluar ta punojnë me kërrabëza, ose gjypner, apo edhe nga stofi i blerë në treg. Të mbathurat ishin opingat, të punuara nga lëkura e gjedheve, të cilat u zëvendësuan me këpucë.⁹⁶ Pas shkurtimit të mëngëve të këmishës, si pjesë e re e veshjes tradicionale paraqiten "mëngët"⁹⁷, të cilat punoheshin nga peri i leshit në gjypner. Gjatësia e tyre ishte prej shuplakës së dorës deri të bërryli, më saktë te përfundimi i mëngës. Sa i përket stolive, subjektet thonë se; "*dukat herët nuk ka pas, naj lir a ka pas tek tuk, veç jon kon' tyne here ato*

⁹⁵ Ukë Xhemaj, *Etnografia shqiptare në Podgur*, vep. e cit., f. 157

⁹⁶ Përshkrimi i pjesë të veshjes është bërë nga vëzhgimi në terren duke pasur mundësi t'i njohim të gjitha pjesët, i dhe nga subjektet-informatorët, të cilat treguan edhe mënyrën e veshjes që është shumë e rëndësishme për këtë veshje. Duhej "pocitur" (shtrënguar) mirë çdo pjesë që ajo të rrinte ashtu siç duhej. Ato treguan që jo çdo kush ka mundur dhe ka ditua ta vishte këtë veshje në mënyrën adekuate, prandaj gjithherë nusen por edhe gratë më të reja i ka veshur një grua tjetër. Më kalimin e kohës është thjeshtuar mënyra e veshjes, por sigurisht edhe përvoja e ka bërë të veten.

⁹⁷ Ukë Xhemaj, *Etnografia shqiptare në Podgur*, vep, f. 156.

t'sernit, qystekat. Ka pas edhe rruza, t'bardha e aty ktu i punojshin kapak, veq jo shume". Por sipas studiuesve të ndryshëm, ka pasur stoli të argjendit, si unaza, byzylyk, qostek, etj.



Foto 6. Pjesë të "Veshjes se katundit" me marhame e lidhce.

Foto nga Anduena Balaj Thaqi.



Foto 7/8. Veshje e plakave, marrë nga subjekti i intervistuar,

Tone Kabashi, Klinë 2003.

Për sa ju përket pjesëve nga të cilat përbehet veshja tradicionale të plakave, nuk ka dallim me atë të nuseve, por nuk dallon as nga veshjet e më hershme që i kanë veshur plakat. Ajo i “*ruan më tepër tiparet e veshjes së vjetër, si në aspektin strukturor e morfologjiko-ornamentik, ashtu edhe në vetë mënyrën e të veshurit*”.⁹⁸ Dallimi (në mes veshjeve të nuseve e grave te reja në moshë me të plakave) më substancial është mënyra e lidhjes së kokës, *lidhca* është më e ngushtë, marhama më e shkurtë, prandaj marhama është e puthitur për fyti, ndërsa lidhca vendoset më afër ballit, anash duken zylyfët e lëshuara në faqe, ndërsa “*kablusha*” nuk bëhet, nxirret. Dekoret në të gjitha pjesët e veshjes janë të pakta, duke filluar nga këmisha, e cila është më e shkurtë, fundi është i ngushtë afërsisht 3 *gish* (afërsisht 5 cm.) i qëndisur shumë pak, gryka është e hapur (çelur) me jaka të rrumbullakëta të ngushta, pastaj pështjellakët janë më të vegjël si i përparmi ashtu edhe i prapmi, ornamentika është shumë e paktë, çorapet janë të leshta, me shumë pak qëndisje, “komizat” po ashtu, përfundi këmishës vijnë brekët apo siç njihen në kulturën popullore *liname kokrra*, *apoklina me kokrra*, të punuara në vek. Mbi këmishë kanë veshur jelek apo “fanellë” (bluzë), shpina e zezë, ndërsa përpara ka pasur ngjyrë të murrinë (kafe) me mëngë të shkurtra. Si mbathje dikur kanë pasur opinga, ndërsa sot kanë këpucë të përshatshme për moshën.⁹⁹

⁹⁸ Ukë Xhemaj, *Emografia shqiptare në Podgur*, vep. e cit., f. 159.

⁹⁹ Subjekti (Tone Kabashi) 78 vjeçare të cilin e kemi marrë në intervistë, e cila e bart këtë veshje edhe në ditët e sotme.



*Foto 9. (Tone Musolli –Selitaj dhe Jana Grabanica– Musolli).
Veshje e plakave nga arkivi familjar (Kline).*

Këto ishin disa nga karakteristikat e veshjeve që i takojnë një periudhe më të hershme të mënyrës tradicionale të jetës së shqiptarëve por që ishte shumë funksionale. Më kalimin e kohës kanë ndryshuar mënyra e jetesës, e me këtë rast edhe mënyra e veshjes duke dalë jashtë përdorimit, pra si veshje e përditshme. Veshja ka shpërfaqur imazhin jo vetëm të individit, por edhe të tërë asaj familje duke e paraqitur reputacionin social–kulturore në mjediset sociale të asaj kohe. Për këtë po rendisim disa nga faktet:

- veshjet në përgjithësi janë dalluar edhe në bazë të shtresave klasore p.sh: familjet më të pasura edhe veshjet i kanë pasur më të kushtueshme, me dekorime dhe aksesore më të shprehura, çka d.m.th se në familjet me kushte jetese mesatare edhe veshja ka qenë më e thjeshtë, materiali më i thjeshtë, më pak cilësor.
- Një fenomen i tillë ndarjeje të shtresave shoqërore po ndodh edhe sot, si në veshje si në çdo aspekt tjetër kulturor dhe social.

Duke iu referuar të dhënave nga studiuesja Drita Statovci, kjo veshje ishte veshje e përditshme deri në vitet e 70-ta, ndërsa pas viteve të 70-ta, përveç disa grave të cilat dëshiruan ta mbanin këtë veshje, të tjerat i vishnin vetëm në festa familjare, apo edhe në rast vdekjeje. Mbas kësaj periudhe e deri në luftën e fundit në Kosovë, çdo nuse e kishte nga një apo dy veshje tradicionale, varësisht prej kushteve ekonomike që kishte familja e burrit. Ndërsa, sot shumë vajza me rastin e martesës, kanë dëshirë të kenë nga një veshje tradicionale, për ta veshur në festa të ndryshme familjare.



Foto 10. Veshja e grave të grup moshave të ndryshme. Improvizim.¹⁰⁰

Veshja në aktualitetin e sotëm shoqëror

Veshjet janë zhvilluar e kanë ndryshuar nga një periudhë në tjetrën. Ndryshimet ndodhin vazhdimisht, në kohë e në hapësirë, ndodhin para syve tanë dhe janë të pandalshme, të nduarnduarta dhe pa-sqyrohen me spektër të gjerë tabllloide.¹⁰¹

¹⁰⁰ <https://www.facebook.com/photo.php?fbid=1220749034785815&set=pb.100005521904069.-2207520000..&type=3>. [qasur me 20 gusht 2020]

¹⁰¹ Drita Halimi-Statovci, *Veshjet Shqiptare të Kosovës*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2009, f. 336.

Prandaj edhe kjo veshje si shumë veshje të tjera pati rrugën e saj evolutive, por ndryshimet që u bënë në këtë veshje nuk iu larguan asnjëherë origjinës së saj, edhe pse iu shtuan disa pjesë të reja, të cilat i solli koha dhe nevoja. Mirëpo, në strukturën morfologjike, si karakteristikë e tipit, u ruajtën elemente kryesore më të lashta të veshjeve si: këmisha, brezi, opingat, shamia për veshjen e grave, ndërsa për veshjen e burrave janë ruajtur: tirqit, brezi, plisi, opingat etj.¹⁰² Rr. Zojzi i konsideron me të drejtë këto pjesë si elementare, të këtij tipi (gunës) të veshjes, duke theksuar faktin *sevetëm këto pjesë nuk mungojnë në asnjë veshje*”, janë pjesë kryesore, dhe *se këto elemente njaftojnë për të mbuluar gjithë trupin*.¹⁰³

Veshja tradicionale e grave në Rrafsh të Dukagjinit i ka ruajtur pothuajse të gjitha elementet e saj, përveç opingave që janë zëvendësuar në këpucë, shoka me shall, tjerat pjesë janë po ato të gjitha, sigurisht që ka ndryshuar materiali, për çorapet, për jelekun, tjerat kanë mbetur, të njëjta si pëlhura për këmishën, marhama prej mëndafshi dhe pambukut, pollët e pësjtjellakut, patisku (pafti) për, *lidhçën*, jakën, *sanakun* e fundin. Faktin se nuk kanë pësuar ndryshime në strukturën morfologjike, pra ajo i ruan elementet kryesore këtë na e dëshmon edhe subjekti ynë Mirusha. Ajo sa i përket ndryshimit të veshjeve tradicionale tregon se prej kohës kur është martuar ajo, viti 1970, nuk kanë ndryshuar. “*Valla kur jom martu une e temas njejt jon, veç a di qe po ndrrojn modelet, se qashtu njejt o kon. Njejt qashtu osht pësjtjellaku, knisha, çorapat, marhama e lidhca. Po njejt, veq qe tash po kepen secilën here ma mire, modelet (e ka fjalën për ornamentikën) po ndrrojn, se njejt prehet, njejt kepet, veq modelet qe i kan ndrru.*”

¹⁰² Ukë Xhemaj, *Etnokultura shqiptare në Podgur*, vep. e cit., f. 163.

¹⁰³ Rrok Zojzi, *Gjurmë arkaike në veshjet tradicionale të popullit shqiptar*, punim i cituar, f. 253.

Ajo çka vlen të ceket këtu është se tani kjo veshje punohet ekskluzivisht vetëm për nuse, sepse pothuajse secila e ka pjesë të veshjeve për martesë në mënyrë të veçante ato nuse që jetojnë në kurbet apo kanë për të shkuar të jetojnë atje. Arsye pse nuk punohet për gra të moshave tjera përfshirë këtu dhe plakat, është sepse ajo më nuk është veshje e përditshme. Kjo veshje është njëaftë e kushtueshme, dhe nëse ndonjë vajzë ka dëshirë për ta pasur dhe nuk mund ta blejë, atë mund ta huazojë nga ndonjë familjare e saj, apo ta merr me qira. Kemi dyqane të cilat punojnë veshje tradicionale vetëm për t'i dhënë me qira, e me këtë rast e kryejnë edhe shërbimin për t'i aveshur nuses, duke pasur parasysht se është njështri e veçantë mënyra e veshjes së saj, ashtu siç është dhe për veshjet tjera popullor, ku çdo element e ka vendin dhe pozitën e caktuar ku dhe si të vendoset për tu dukur sa më bukur.

Lidhur me gjendjen e veshjes tradicionale sot, punimin e saj, bartjen e saj, subjekti ynë Tonja 78 vjeçare, tregon se edhe sot vazhdon me shumë përkushtim të punojë veshjen tradicionale, punë të cilën e bën me shumë kënaqësi që nga vajzëria. Këtë punë e bën vetëm për të kaluar kohën. Shitjen e bënte nga porositë e ndryshme për dasma e organizime të tjera, por i dërgonte në treg, dhe në panairë të ndryshme të vendit. Familja dhe gjendja e saj ekonomike nuk ishin të varura nga puna e saj. Ajo këtë punë e konsideronte si çlodhjen më të madhe. Gratë, të cilat sot merren me këtë punë janë të rralla. Koha, evoluimi shoqëror, emancipimi dhe shkollimi i femrës, punësimi i saj dhe prezenca e saj aktive në jetën publike ka ndikuar në humbjen e dëshirës për punë që kanë të bëjnë me veshjen dhe në përgjithësi tradicionale.

Më ndihmën e shoqatave ndërkombëtare të cilat veprojnë në ruajtjen e traditës, janë bërë dhe bëhen përpjekje për të ruajtur mënyrën e

punimit të pëlhurave origjinale, kështu që ato kanë filluar organi-zimin e trajnimeve të ndryshme për punimin e tyre. Kjo vije edhe si rezultat i dëshirave dhe kërkesave të shtuara në vitet e fundit nga nuset për ta pasur si pjesë të “gardërobës” edhe këtë veshjes në martesë.

Veshja tradicionale, dhe kultura tradicionale shqiptare sot në përgjithësi është zbehur dukshëm. Përderisa dikur ishte veshje e përditshmërisë, sot shikuar nga aspekti profesional nuk ruhet dhe nuk e ka rolin që ka pasur dikur, pra nuk është aktive në ditët e sodit. Si ndikuese e këtyre ndryshimeve, sidomos pas luftës së fundit në Kosovë, janë disa aspekte që kanë ndikuar si: ndikimi i kulturave të huaja moderne evropiane, shkuarjet dhe ardhjet, migrimet e shumta, dhe pranimi i këtyre ndryshimeve nga vet shoqëria jonë. Një tjetër arsye është edhe zhvillimi ekonomik dhe teknologjik.

Mjetet arkaike të punës sot nuk përdorën më, thjesht në ndonjë familje kosovare mund t’i ruajnë vetëm si relikte të së kaluarës. Endja me vegje (vek) sot shumë rrallë praktikohet nga ndonjë plakë e moshuar, ngase për të rejat e kohës bashkëkohore konsiderohet si një mjet shumë i vështirë dhe kompleks për të punuar me të.

Pos tjerash, veshja popullore, për disa të rinj të jetës bashkëkohore dhe “*in modernitetit*”, është e pa pranueshme, shumë komplekse, e rëndë për angazhimet e përditshmërisë etj. Por nëse nuk punohen dhe nuk vishen veshjet tradicionale, është shumë normale, pasi që edhe veshja i përshtatet kohës. Si elemente të ruajtjes së traditës, janë veshjet apopjesë të veshjeve, qoftë edhe të improvizuara, të cilat mund t’i vërejmë në raste të dasmave dhe ahengeve familjare, pastaj; improvizimi i ndonjë riti të mbetur si i shumë shtresuar, si hedhja e grurit, orizit, bonboneve; shtrimi i një cohe të kuqe për të ecur nusja kur hynë në lokal, apo zbret nga makinave; vendosja e

plisave në kokën e nuses, veshja me veshje kombëtare apo ndonjë nga elementet e veshjes nga nusja dhe dhëndri; siç janë: plisi, shoka apo veshja e jelekut (nga dhëndri), ndërsa nga nusja veshja e një dollame, jeleku apo dhe ndonjë element tjetër, si simbole të veshjeve popullore tradicionale.

Përkushtimi dhe dëshira për të veshur një veshje tradicionale vërehet më shumë tek femrat, e shumë rrallë rastis të takosh ndonjë familjar mashkull të jetë prezent në dasmë me kostum tradicional. Por, në disa fshatra të Rrafshit të Dukagjinit, është bërë praktikë që vajzat e reja, për ditën e fejesës të qepin dhe të veshin kostumin tradicional të vajzave, i cili methjeshtësinë e vet dallon nga kostumi apo veshja e nuseve dhe plakave.

Po t'i referohemi veshjes dhe modës së sotme, me stile dhe modele nga më të ndryshmet, nga më e mira deri te veshja më e dobët, e që konsiderohet moderne, do të citoja një mendim të etnologes Drita Statovci: rasti kur një fustan me të çelura anësore, ose me të çelur në pjesën e përparme, kultura e veshjes së masave të gjera për çudi, për mot të ftohtë toleron çorapët e trasha, fare pa shije, madje edhe ndërresa të poshtme të gjata, që vërtetë lënë përshtypje, imazhe jo të mira vizuale.¹⁰⁴ Si të kuptohet tani ky kriter i veshjes në përgjithësi, neglizhencë dhe mospërfillje e kërkesave të modës, pamundësi e përmbushjes së kërkesave të modës në tërësi, apo si dëshirë për ta ndjekur modën dhe në të njëjtën kohë si nivel shoqëror-kulturor ende i pazhvilluar sa duhet.¹⁰⁵

Pra, ndikuesi më i madh në ndryshimet kulturore, pa dyshim, konsiderohet zhvillimi industrial, i cili në shkencat shoqërore rezultoi me teori të ndryshme lidhur me proceset ekonomike, shoqërore e

¹⁰⁴ Drita Halimi-Statovci, *Veshjet Shqiptare të Kosovës*, vep. e cit., f. 364.

¹⁰⁵ Po aty, f. 364

kulturore, siç janë procesi i modernizimit, urbanizimit dhe se fundi globalizimit.¹⁰⁶ Përveç këtyre ndikimeve të cilat kanë sjellë në ndryshimin e mënyrës së veshjes, e me këtë edhe punimin e tyre, apo thënë më mirë improvizimin, e bëjnë edhe kërkesat e mëdha nga mërgimtarët për të pasur diçka nga veshjet tradicionale kanë kërkesa për të blerë por nuk kanë një kriter për të gjetur diçka më origjinale. Gratë të cilat punojnë –improvizojnë veshjet tradicionale, i punojnë me materiale të fabrikua, por, falë interesit shumë të madh të mërgimtarëve për t'i blerë këto veshje, sidomos për fëmijë, ato shitet dhe ata janë blerës potencialë, për këtë arsye shitjet më të mëdha i kanë gjatë verës.

Sa i përket vajzave të reja, të kohës moderne, secila nga to ka mendime të ndryshme. Disa kanë veshje në shtëpi të ruajtur nga nëna, dhe me dëshirë do ta vishnin në ndonjë dasmë. Ka nga ato që e quajnë veshje “de mode”, dhe që nuk kanë dëshirë ta veshin. Të tjera e kanë porositur veshjen tradicionale sikur që e kanë veshur vajzat dikur, për ta veshur për ditën e fejesës së tyre.

Përfundime

Veshjet janë zhvilluar e kanë ndryshuar vazhdimisht nga një periudhë në tjetrën. Edhe kjo veshje si shumë veshje të tjera pati rrugën e saj evolutive. Në strukturën morfologjike, si karakteristikë e tipit, u ruajtën elementet kryesore më të lashta të veshjes si: *këmisha, pëshjtellaku, çorapet*, etj. Ndërsa ndryshimet më të mëdha vërehen në jelek të cilët sot nuk punohen me gajtan, por janë nga materiale fabrike dhe ngjyra të ndryshme, kurse dikur ishin vetëm më ngjyrë të zezë. Ndryshim kanë pësuar edhe mbathjet, opingat që janë zëvendësuar më këpucë apo sandale, ndryshim i shumë

¹⁰⁶ Lumnije Kadriu, *Glokalizimi- përceptime etnokulturore*, Prishtinë, 2009, f. 44.

kohe më parë. Opingat si mbathje origjinale mund t'i shohim në ndonjë muze apo tek dikush që i ka ruajtur si trashëgimi në familje.

Këtë veshje deri në Luftën e fundit në Kosovë gjatë viteve 1998–1999, shumë gra të moshuara e kishin veshje të përditshme. Viteve të fundit kjo veshje është bërë pjesë e veshjeve të martesës për çdo nuse në këtë rajon, pra pavarësisht koston shumë të lartë, ajo është bërë shumë e kërkuar. Kjo ka ndikuar që shumë gra t'i kthehen punës në vek për të punuar pëlhurën origjinale që nevojitet për këmishën, por edhe materiali për pështjellakët.

Duhet theksuar që kjo veshje gjen përdorim të gjerë, kuptohet e modifikuar, si veshje e fëmijëve, qoftë në gëzime familjare ashtu edhe në festa të ndryshme kombëtare. Kurse të rriturit e përdorin zakonisht në festivale folklorike, apo manifestime tjera kulturore ku si prezantim i tillë lë shumë për të dëshiruar, sepse dallon shumë në material, po ashtu edhe në mënyrën e veshjes, që ka shumë rëndësi, për të qenë origjinale si e tillë. Prandaj, mendojmë se është e domosdoshme që të konsultohen etnologët e antropologët sa i përket veshjeve në përgjithësi dhe mënyrës se si vishen ato, që të ketë një prezantim sa më të përafërt me origjinalet.

Si përfundim mund të themi se përkundër faktit që mënyra tradicionale e jetesës të shqiptarët është zbehur dukshëm, dashuria dhe dëshira për tradicionalen dhe njëherësh kombëtaren është e gjallë. Më e shpeshtë është në raste të festave të ndryshme familjare, shtetërore e kombëtare, të cilat na gëzojnë për faktin se ndjenja dhe elementet kulturore kombëtare janë ende ndër ne, shprehen në momente të caktuara, duke ua mundësuar gjeneratave të mos i humbin gjurmët, traditën dhe kulturën e pasur të rrënjëve tona.

Pra, krejt në fund të këtij punimi mund të konstatojmë se veshja e dikurshme tradicionale, e cila ka pasur vlerë dhe rëndësi të posaçme në mjediset tona socio- kulturore, në një mënyrë apo tjetrën vazhdon të jetë e pranishme, qoftë si veshje tradicionale, po ashtu edhe në kreacionet moderne. Si e tillë është një vlerë mjaft e çmuar, jo vetëm në muze apo aktivitete të ndryshme kulturore. Urojmë që këto veshje të jenë të pranishme në ambientet tona, nga ato private-familjare e deri te ato institucionale edhe për shumë kohë.

Bibliografia:

Bido, Agim (1991), *Arti popullor ne veshje e tekstile*, Tiranë 1991.

Bido, Agim (1997), *Sistemi tradicional njëngjyrësh në zbukurimin e veshjeve dhe të tekstileve shqiptare*, Kultura popullore 1-2, Tiranë.

Gjerjgji, Andromaqi (1973), *Përkime midis ornamentikës popullore shqiptare dhe asaj ilire*, Studime Historike, 1, Tiranë.

Gjerjgji, Andromaqi (1978), *Përkime midis ornamentikës popullore shqiptare dhe asaj ilire*, Studime Ilire, II Rilindja, Prishtinë.

Gjerjgji, Andromaqi (1976), *Ndryshime morfologjike e artistike të veshjeve popullore simbas funksionit të tyre*, Etnografia Shqiptare VIII, ASHAK, IKP, Sektori i Etnografisë, Tiranë.

Gjerjgji, Andromaqi (2005), *Veshjet shqiptare në shekuj*, ASHAK, IKP, Tiranë.

Halimi- Statovci, Drita (2009), *Veshjet shqiptare të Kosovës*, IAP, Prishtinë.

Kadriu, Lumnije (2009), *Glokalizimi perceptime etnokulturore*, IAP, Prishtinë, 2009.

Krasniqi, Mark (1991), *Nga gurra e traditës*, Zëri Prishtinë..

Krasniqi, Mark (1984), *Lugu i Baranit, (Monografi etno-geografike)*, Prishtinë.

Lajçi, Bashkim (2007), *Gjurmime etnologjike*, Pejë.

Onuzi, Afërdita (1976), *Besime e rite rreth mjeshhtërisë së endjes*, Kultura popullore 1–2, Tiranë.

Onuzi, Afërdita (2001), *Përdorimi i ngjyrosësve natyrorë dhe kimikë në tekstilet tonë popullore*, GJAFE, 28–29, IAP, Prishtinë.

Onuzi, Afërdita (2009), *Veshjet popullore shqiptare në Kosovë*, Kultura popullore 1–2, Tiranë.

Stipçevisq, Aleksandër (2020), *Ilirët*, Toena, Tiranë.

Xhemaj, Ukë (2003), *Etnokultura shqiptare në Podgur*, IAP, Prishtinë.

Zekaj, Hasan (2011), *Gjytetet thërrasin ndërgjegjen*, Faik Konica, Prishtinë.

Zojzi, Rrok (1978), *Gjurmë arkaikë në veshjet tradicionale të popullit shqiptar*, Studime Ilire, II Rilindja, Prishtinë.

Zojzi, Rrok, (1965), *Mbi veshjet tradicionale të popullit tonë*, Studime Historike nr. 4, Universiteti shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë.

Burime nga Interneti:

1. Foto 1. <https://www.facebook.com/groups/AlbanianVintagePhotography/permalink/2861670653908689>, [qasur me 01 shtator 2020].
2. Foto 2. <https://www.facebook.com/photo.php?fbid=1008739785986742&set=pb.100005521904069.-2207520000..&type=3>, [qasur me 10 gusht 2020].
3. Fotot 4. <https://www.facebook.com/1594374677461704/photos/a.1594379460794559/1814562965442873/?type=3>, [qasur me 27 gusht 2020].
4. Foto 5. <https://www.facebook.com/photo.php?fbid=1220749034785815&set=pb.100005521904069.-2207520000..&type=3>, [qasur me 2 shtator 2020]
5. Foto 10. <https://www.facebook.com/photo.php?fbid=1220749034785815&set=pb.100005521904069.-2207520000..&type=3>, [qasur me 20 gusht 2020].

Subjekte nga tereni:

- Marije Hamza, 69 vjeçare, nga Klina–amvise.
- Xhemile Seferi, 71 vjeçare, nga Klina–amvise.
- Sofë Ramosaj, 67 vjeçare, nga Deçani–amvise, (punon veshjen tradicionale edhe sot).
- Kade Preni, 84 vjeçare nga Klina–amvise.
- Ruka, 60 vjeçare, nga Gjakova, amvise dhe rrobaqepëse.
- Tone Kabashi, 78 vjeçare nga Klina.
- Mirushe Bobi–Fetaj, 72 vjeçare, Strellci i Epërm.

HIRIET ZIBERI

Fakulteti Filozofik, Universiteti "Fadil Sulejmani" – Tetovë

PËRPUNIMI I VESHJEVE TË GRAVE NË MALIN E THATË

Abstrakt

Veshja është një ndër pasuritë më të mëdha materiale dhe shpirtërore e një populli. Pjesët kryesore të veshjeve, zbukurimet, ngjyrat, gjallëria e motiveve, materialet, mënyra e të punuarit, ishin ato elemente të cilat u jepnin një domethënie të veçantë veshjeve popullore.

Veshja tradicionale ka qenë dhe është manifestimi më i fuqishëm i një kulture, edhe pse ajo me kohë është zhvilluar dhe ka ndryshuar vazhdimisht, por bërthama kryesore e saj, ka ngelur e pa ndryshuar. Autentiku i elementeve kryesore të veshjeve është vërejtur ndër shekuj, për tu vërtetuar në këtë na kanë ndihmuar ruajtja me devotshmëri e tyre, veshja e tyre, si dhe të dhënat rreth përpunimit të veshjes. Veshja e Malit të Thatë është veshur, përgatitur, zbukuruar dhe ruajtur me shumë devotshmëri deri në ditët e sotme.

Në këtë punim do të paraqiten veshjet e Malit të Thatë së bashku me motivet dhe qëllimin e tyre, të përpunuara me mjeshhtëri të jashtëzakonshme nga grate e kësaj ane dhe që kanë lënë gjurmë në thesarin e veshjeve popullore shqiptare.

Fjalët çelës: *Veshjet popullore, Mali i Thatë, punimi, mjeshtria e qendisjes, grate.*

Hyrje

Mali i Thatë është një zonë malore që shtrihet në veriperëndim të Maqedonisë së Veriut. Këtu bëjnë pjesë tre fshatra, Korita, Gurgurnica dhe Sallareva. Këto fshatra shtrihen në një lartësi mbidetare prej 800 m deri më 1200 m. Struktura e popullatës së këtyre fshatrave ndryshon dukshëm. Përderisa në fshatin Koritë kemi një dyndje të madhe të popullatës në zonat më të ulëta, fshatrat Sallarevë dhe Gurgurnicë kanë arritur të ruajnë numrin e banorëve. Duhet theksuar se sipas të dhënave demografike popullata e këtyre anëve e ka prejardhjen nga zona e Rekës së Epërme, për të cilën flasin shumë elemente gjuhësore, kulturore duke përfshirë edhe veshjet tradicionale.

Në kohërat e hershme, populli shqiptar përfitimin e lëndës së parë për prodhimin e veshjeve e bënte vetë. Prodhimet e para të përfuturara ishin njaft të ashpra, por mënyra e përfitimit ishte shumë më e thjeshtë dhe bëhej në kushte shtëpiake. Pjesët e veshjes dhe elementet shtesë të saj, për masat e gjëra përpunoheshin kryesisht brenda kuadrit të ekonomisë shtëpiake, me lëndë që nxirreshin nga prodhimet bujqësore dhe blegtorale, siç ishin leshi, liri, kërpi dhe lëkura.

Mjeshttrinë e përpunimit të lëndëve të para e posedonin si gratë ashtu edhe burrat, por përgaditja e lëndës së parë për veshjen e grave bëhej zakonisht prej grave më të moshuara, të cilat e kishin përvetësuar mire këtë mjeshtri. Duart e grave të këtyre trevave kanë qenë çdoherë të ngathëta në përpunimin e gjërave të shumëta, dhe jo vetëm veshja ka qenë një përparësi e tyre.

Përgatitja e materialeve për përpunim

Veshja si pjesë e pandarë e përditshmërisë sonë edhe në kohërat më të hershme ishte pjesë e detyrimeve të femrave, të cilat kishin për obligim përgaditjen e tyre, jo vetëm për vetveten e tyre, por njëkohësisht edhe për anëtarët e tjerë të familjes siç ishte bashkëshorti dhe fëmijët, por në shumë raste nëse ishte e vetnija nuse e shtëpisë ishte e detyruar që edhe për anëtarët e tjerë të familjes së bashkëshortit ti përgadisë pjesët e veshjeve.

Si lëndë bazë në përpunimin e veshjeve shfrytëzohej leshi i deleve, kurse në mbathje lëkura ë përpunuar e lopëve. Zona e Malit të Thatë njihet për rritjen e deles. Mjeshtëria e qethjes së deleve nga blegtorët e këtyre fshatrave, ishte e veçantë. Zakonisht pas qethjes së dhënëve, gratë kishin obligim larjen, qërrimin ose pastrimin e leshit dhe në fund tharjen, para se ai të dërgohej në qytetin e Gostivarit për përpunim. Pasi që përpunohej leshi, gratë fillonin me përgaditjen e pjesëve të veshjes, por para bënin ngjyrosjen e leshit. Sa u përket ngjyrave në periudhat shumë të hershme në tekstilet e punuara në shtëpi nga gratë mbizotronin ngjyrat natyrore të leshit, si e bardha, e zeza, e murme, kafe, ndërsa për ngjyrosje përdorëshin ngjyrosësit bimorë, pra bimë të ndryshme. Në periudhat më të vonshme filluan ngjyrat të blihen të gatshme dhe vetë gratë e ngjyrosnin leshin. Ngjyrosja bëhej duke vendosur një kusi të madhe me ujë në zjarrë dhe pritnin deri sa të vlonte, pastaj e hidhnin ngjyrën dhe prisnin deri sa përhapej në të gjithë kusin dhe i gjithë uji merrte ngjyrën e njejt. Pas kësaj në kusi futeshin “sukanicat” (topat e leshit të përpunuar), të cilat merrnin ngjyrën e pëlqyer. Nurmi i “sukanicave” që do të ngjyroseshin mvarej nga lloji i veshjes dhe sasia që do të prodhohin. Ngjyrat që më së shumti pëlqeshin nga vajzat dhe gratë ishin ngjyra e verdhë, e kuqe, e kaltërt,


gjelbërt dhe ngjyra vishnje. Pas ngjyrosjes fillonte përpunimi i pjesëve të ndryshme të veshjes. Gratë e përpunonin leshin në fije, fija e hollë quhej “*tyme*”, ndërsa fija e trashë “*ind*”. Varësisht nga lloji i veshjes zgjidhej se cila fije do të përdoret, por tre fije e përbënin një krye.

Një material tjetër që është përdorur nga gratë por është blerë i gatshëm ka qenë patiska, lloj pëlhure që është përdorur për brekët e gjata dhe këmishën me kinda. Zakonisht janë blerë patiska me dy lloje ngjyrash, e bardhë dhe e verdhë, pasi që patiska e verdhë ka qenë më e lirë dhe numri më i madh i këmishave është përgaditur me këtë lloj patiske. Zakonisht këmishat me patiskë të verdhë janë përpunuar për në shtëpi dhe kishin më pak kinda se sa këmishat me patiskë të bardhë që kishin më shumë kinda dhe shfrytëzoheshin nga nuset kur ndroheshin (zbukurim për raste të veçanta apo edhe përditshmëri në fillim të nusërisë), pra kur veshnin enterinë e mirë. Një element tjetër i veshjes që është përgaditur prej leshi ishte dhe brezi, si për gjininë femërore ashtu edhe për atë mashkullore. Brezi në fillim përpunohej i tëri nga leshi, po me kohë fillon të shfrytëzohet edhe pambuku si material. Njëjtë si leshin edhe pambukun e ngjyrosnin vetë gratë, të cilin e blenin të gatshëm në treg dhe pastaj e ngjyrosnin me ngjyrat që ju pëlqenin. Pas hyrjes së pambukut në përdorim të gratë e Malit të Thatë filloi brezi të përgaditet me fije leshi dhe fije pambuku, ashtu që brezi kishte ngjyrën e kuqe që ishte nga leshi dhe ngjyrën e verdhë nga pambuku. Për përgaditjen e brezit në vek duheshin një deri dy ditë punë.



Brez me fije lesi dhe pambuku

Mbi brez gratë vendosnin edhe poshin, i cili në periudhat shumë të hershme përgaditej prej lesi, por me kalimin e kohës (zhvillimin e tregëtisë dhe qasjes më të lehtë në materialet e ndryshme) filloi të përpunohej prej mëndafshi. Mëndafshin zakonisht e blenin të gatshëm me ngjyrat të cilat i preferonin gratë, edhe pse ata vetë nuk dilnin në tregje, i porositnin burrat se cilat ngjyra duhej ti merrnin, pra nuk vendosnin burrat për ngjyrat që bliheshin. Varësisht nga shija dhe dëshira e grave poshi përgaditej nga dy deri në shtatë ngjyra të ndryshme, përpunohej nga gratë në vek dhe ishte si pjesë zbukuruese e veshjes.

*Poshi*

Pjesë tjera të veshjes janë Çulkat dhe Kalçinjët të cilat poashtu janë përgaditur nga leshi në periudhat e më hershme, ndërsa më vonë filluan ti bënin nga lëmshe leshi, të cilën e blenin të gatshëm në shumë ngjyra dhe nuk kishin nevojë ta ngjyrosnin. Një material tjetër që filloj të përdoret te elemente të caktuara të veshjeve ishte teli (material ndriçues i lyer me shtresë të hollë ari me ngjyrë të verdhë apo argjendi me ngjyrë të bardhë), që përdorej për ti zbukuruar Çulkat dhe Kalçinjët. Zakonisht këtë e bënin vajzat e reja, që të duken më bukur. Prej leshi është përpunuar edhe skutaçja, por që në kohërat e fundit filloi të shfrytëzohet edhe lëmshe i leshit për përpunimin e saj. Ka pasur dy lloj skutaçesh, skutaçe me bajrak, që ka qenë prej leshi dhe është punuar në vek dhe skutaçe të qëndisura, poashtu prej leshi por të punuara me drugëz. Skutaçet e qëndisura sot përpunohen prej pambuku dhe qëndisen në dorë nga vajzat e reja.

Një ndër elementet më kryesore të veshjes pas këmishës ishte Enteria. Enteria e mirë blihej e gatshme nga mjeshtrit e qytetit, kurse llojet tjera të enterive (pesë të tilla) përgaditeshin nga vetë gratë, meqë ishin më të thjeshta dhe përdoreshin në përditshmëri. Zakonisht për këto enteria blihej materiali i quajtur allaxhe së bashku me shiritat me ngjyra të ndryshme dhe përpunoheshin sipas dëshirës së vet grave.

Përveç këtyre elementeve kishte edhe pjesë të veshjes të cilat bliheshin të gatshme dhe gratë vetëm i qëndisnin ose i zbukuronin ato elemente. Të tillë janë: kollani, skepkat, riza, shamija e kokës dhe kësula. Të gjitha këto zbukuroheshin sipas dëshirë së vajzave me rruaza, monedha argjendi, xixa, tel, guaca të vogla, oja, etj.



Kollani i qëndisur

Modelet për përpunimin e veshjeve zakonisht gratë i këmbenin ose i kopjonin nga njëra tjetra, por kishte gra të cilat ishin vetë në gjendje të vizatojnë modele të ojave, të qëndisjeve për këmishën, enterinë, skutaçen dhe veshje tjera.

*Veku*

Përfundimi

Format e veshjes si të burrave poashtu edhe të grave ishin të lidhura ngushtë me veprimtarinë ekonomike të njeriut, me kushtet në të cilat ata punonin dhe jetonin. Edhe pse ishin të prodhuara në kushte shtëpiake, ata kishin një shkëlqim nga dekori dhe një fantazi ngjyrash intensive, magjepsëse, të ndritshme dhe të hareshme.

Veshja ishte dhe ende është thesar i çmuar i këtyre zonave, të cilët me shumë fanatizëm kanë ruajtur pasurinë materiale që e posedonin. Ata edhe në ditët e sotme me shumë krenari flasin për veshjen e tyre tradicionale, të cilën e ruajtën gjeneratë pas gjenerate. Njerëzit në këto rajone me shekuj janë munduar që sa më mirë dhe sa më shumë ti përpunojnë dhe zbukurojnë veshjet. Ato zakonisht veshjet i kanë prodhuar në kushte shtëpiake dhe janë munduar të krijojnë forma dhe motive më të bukura ose më të gjalla shpesh të lidhura me natyrën dhe ti qendisin ato.

Punën e dorës së gruas e hasim dhe sot e kësaj dite në shumë pjesë të veshjes edhe pse ata në ditën e sotme nuk janë në përdorim siç kanë qenë, por prapëseprapë duart e grave malësore nuk mund të rrinë të qeta, pa krijuar ndonjë mrekulli në veshjen tradicionale shqiptare.



Veshja e Malit të Thatë

Literatura:

Gjergji, Andromaqi, Ligjerata për etnologjinë shqiptare, Tiranë, 2004.

Gjergji, Andromaqi, Veshjet shqiptare në shekuj, Tiranë, 2005.

Halimi-Statovci, Drita, Veshjet shqiptare të Kosovës, Prishtinë, 2009.

XHEMALEDIN SALIHU

Shoqata për Trashëgimi dhe Krijimtari Kulturore – Preshevë

VESHJA E BURRAVE NË PRESHEVË

Popullata shqiptare e Preshevës, me xhelozitë të madhe dhe mund të madh ruajti traditën e saj të kulturës popullore gjatë shekujve. Si-domos ruajti trashëgiminë kulturore: vallen, këngën dhe veshjen e saj të vjetër popullore.

Presheva e kohës antike i takonte Dardanisë. Presheven në kohëra të ndryshme e sunduan romakët, bizantët, sllavët, turqit, jugosllavët, mirëpo ajo asnjëherë nuk u dorëzua nga autoktonia e vet dhe me dinjitet dhe xhelozitë ruajti traditën e kulturës popullore. Ajo nëpërmjet vallës dhe këngës protestoi, kundërshtoi, por edhe luftoi pozitën e saj të prapambetur shekullore dhe diti që nëpërmjet valles dhe këngës të gëzohet në dasma, gazmende e festa familjare e kombëtare. Presheva ishte e njohur për trimëri, bujari, solidaritet, humanitet, por edhe për kultivimin e valles dhe këngës së pastër popullore shqiptare. Ajo me xhelozitë ruajti dhe mbrojti vallen, këngën e vet popullore dhe veshjen dhe nuk lejoi përzierje me melosin e veshjen e popujve fqinjë.

Presheva, Karadaku, si trevë etnografike, për nga hapësira është i përcaktuar mjaft qartë dhe mjaft mirë, gjithnjë me male e gryka, të cilat e përkufizojnë dhe e ndajnë këtë trevë nga të tjerat, por njëherit këto edhe e bashkojnë me të tjerat duke qenë lidhje komunitarimi midis tyre. Prandaj kjo trevë është përplot tipare etnografike,

*që e dallojnë nga treva të tjera, por që gjithashtu këto inkuadrohen në tiparet themelore të përbashkëta për kulturën gjithëshqiptare.*¹⁰⁷

Treva e Preshevës, pas Luftës së Dytë Botërore, dalëngadalë mbeti pa veshje të mirëfilltë popullore, qoftë veshje burrash, qoftë veshje grash dhe bëri zëvendësim me veshje moderne, e cila ishte shumë e ndikuar nga kulturat e huaja.

Veshja e burrave në Preshevë

Veshjet e burrave të Preshevës e të rrethinës së gjerë kishin një strukturë të plotë kostumore dhe i takonin tipit të veshjes me tirq. Mirëpo, pa mohuar vlerën e një kostumi të plotë, e as rëndësinë kulturore dhe historike të çdo petku kostumor, me këtë rast do të përqëndrohem vetëm në disa pjesë kostumore. Pra, në punimin nuk do të shkruaj për të gjitha pjesët e veshjes të burrave të Preshevës, si veshje e plotë, por vetëm disa nga pjesët e veshjes së burrave të Preshevës.

Veshja si tërësi dhe pjesët kostumore që i marrë në shqyrtim janë karakteristike e burrave të Malësisë, dhe veçanërisht e burrave të Parisë së Preshevës dhe e burrave në vallet e burrave të Preshevës.

Në Malësinë e Karadakut, veshjet e burrave, por edhe te grave ishin prodhime shtëpiake, të endura. Në veshjet përgjithësisht e në vallet e burrave në veçanti, elementi më tipik i veshjes janë tirqit. Tirqit kanë formën e pantallonave të ngushta prej zhguni (shajaku), në të shumtën e rasteve ngjyrë të zezë ose të murme, më rrallë me ngjyrë të bardhë. Atëherë ngjyra e gajtanëve të tirqve, në funksion deko-

¹⁰⁷ Drita Statovci, Mbi disa tipare etnografike të Karadakut, Gjurmime albanologjike, folklor e etnologji, 23-1993, Prishtinë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, fq. 15-16

rues por edhe utilitar për t'i mbuluar qepjet dhe bashkimin e pjesëve formuese të tërësis, ishte e kundërta e ngjyrës së tirqëve.

Përgjithësisht tirqit lidhen poshtë belit, shtrënguar dhe shoqëruar edhe me një brez të leshit, me vija disangjyrëshe, e që në Preshevë si edhe gjerësisht ndër shqiptarë quhet shokë. Gjatësia e saj mund të jetë e ndryshme. Në pjesën e sipërme të trupit vishej një këmishë me mëngë të gjata, me ngjyrë të bardhë dhe fillimisht e pëlhurës së endur në vek e pastaj e materialit të fabrikuar. Mbi këmishë vjen jeleku pa mëngë, me ngjyrë të zezë apo të murme prej shajaku. Në Preshevë tirqit zakonisht janë bartur në vallet e burrave, më rrallë si veshje e përditshme, pos në Karadakun e Preshevës.

Në Preshevë ishte traditë që të vishen tirqit e zi, nga personalitete të njohura dhe të dalluara në veshje, duke filluar nga Emin Kurbaliu, Isa Bina, Ali Rrustemi, e të tjerë. Bile, këta huazonin tirqit valltarëve të Preshevës. Pra, këta burra i takonin Parisë së Preshevës, të cilët visheshin me shije: tirçi e xhamadanë, plis të bardhë, këmishë të bardhë, shokë lara-lara dhe opinga lëkure apo këpucë.



Veshje burrash



Veshje burrash pleq

Autori preshevar Metush Berisha, në librin tij shkruan se duke hulumtuar, ka vërtetuar, nëpërmjet informatorëve se fustanella, deri diku kah fundi i shekullit XIX, ka qenë veshje burrash edhe te Malësorët e Karadakut.¹⁰⁸

Po ashtu, në vallet e burrave përdoret plisi i bardhë, i cili përdoret më rrallë në jetën e përditshme të popullatës shqiptare në Preshevë me rrethinë. “Në Malësinë e Karadakut plisi i bardhë ka qenë pjesë e pandashme e veshjes së burrave. E mbanin të gjitha moshat, burrat dhe fëmijët edhe ate qysh nga mosha e re. Në Malësi nuk mund të shihje burra pa plis. Pa plis nuk dilej nga shtëpia”, shkruan Metush R. Berisha.¹⁰⁹

¹⁰⁸Metush Berisha, Reflektime të traditës kulturore /Karadaku i Preshevës/, Prishtinw, 2013, f.119

¹⁰⁹Po aty, f.122

Në vend të plisit të bardhë, preshevarët shpesh e bartin një kapuç të zi, Akademiku Kadri Halimi lidhur me fenomenin e bartjes së kapuçit të zi e ndërlidhë me gojëdhënën se në shenjë zie, për vdekjen e Skenderbeut fillon të bartet kapuçi i zi¹¹⁰, apo edhe me ndonjë ngjyrë tjetër, të qepur prej pëlhurës së pambukut. Opingat janë pjesë përbërëse e veshjes popullore me traditë të vjetër dhe kanë shtrirje mbarë shqiptare.

Në Preshevë me rrethinë në vallet e burrave përdoren opingat, por popullata më rrallë i përdorë në jetën e përditshme. Po i njëjti autor, Metush Berisha thotë se opingat prej lëkure, si veshje burrash ishin me prejardhje ilire. Lëkura e preferuar për opinga ishte prej kafshëve të trasha. Ato kanë qenë në përdorim deri diku kah gjysma e dytë e shekullit XX.¹¹¹




Grupi i Vallëtarëve i SHKASH "Abdulla Krashnica", Preshevë, më 1956/57

¹¹⁰ Kadri Halimi, Studime Etnologjike, Komplet i veprave, nr.2, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2011, f.197-198

¹¹¹ Metush Berisha, Reflektime të traditës kulturore/Karadaku i Preshevës, Prishtinë, 2013, f.120

Në punimin mbi vallet e burrave të Preshevës shkruaj se në vallen e Miratocit, vallëtarët i mbulojnë veshët dhe lidhin kryet me çevre /shami/. Çevreja mbahet në të gjitha vendbanimet e Preshevës, por është veçanti dhe dukuri specifike dhe e shpeshtë e popullatës së Tërnavës, Strezocit, sidomos e popullatës së Miratocit.



Çevreja e Zejush Ramizit, Gare e Preshevës

Çevreja mbahet në kokë, lidhet—pëstjellohet pjesa e pasme e kokës, mbështillen anët e kokës dhe mbulohen veshët, ndërsa lidhet në ballë të kokës.

Sipas gojëdhënave të banorëve të fshatit Miratoc ekzistojnë disa supozime lidhur me Çevrenë: e para çevreja mbahet për shkak të ftohtit, lidhet dhe mbrohet koka, sidomos çevrenë e mbanin çobanët e fshatit, barinjtë e deleve, të fshatit Miratoc, Tërnavë dhe Strezoc, por edhe të vendbanimeve të tjera. Madje, jo vetëm çoba—

nët, por edhe dërguesit e bukës për çobanët, ishin të detyruar që gjatë kohës së ftohtë t'a lidhin kryetë më çevre dhe t' i mbulonin veshët nga të ftohtit; e dyta me mbajtjen e çevresë në punë, fshatarët formonin hije gjatë punës së vështirë në pikë të verës dhe i fshinin djersët ë punës; e treta: çevreja mbahet edhe në valle, për t'i fshirë djersët gjatë vallëzimit popullor, por edhe pse është pjesë e veshjes popullore dhe për të krijuar imazhe më efektive; dhe e katërta: çevreja mbahet në Miratoc dhe lidhet koka me të, edhe për t'i mbuluar qelet, edhe pse profesori i nderuar, Sami Agushi thotë se njih 4 raste të qytetarëve të Miratocit që nuk mbajnë e as lidhin çevre në kokë, edhe pse i kanë qelet. Çevreja mbahet edhe në hapësira të tjera e gjetiu ndër shqiptarë, si imazh dhe si mbrojtje në dimër ose në verë. Çevreja, pos bartjes së saj në krahinën e Preshevës, bartet edhe në krahina tjera shqiptare. Kështu, çevreja bartet dhe përdoret si bohçe, për të shkuar në treg, ku ajo mbushet me pemë e perime. Ajo, poashtu përdoret edhe për të shkuar në vreshta, për të mbledhur rrush, pastaj përdoret edhe për bartjen e te shave, të cilat lidhen në çevre, sikur bohçe.



Vallja e Miratocit e luajtur nga SHKASHI "A. Krashnica", Belgjikë, 1980

Autori bullgar Gj. Petrov, për mbajtjen e Çevresë në Miratoc shënon një këngë të përhapur në popull:¹¹²

Dum, dum tupani,

Hora Llojani,

Qel Miratoci,

Zhugava Tërriana,

Norça qorça,

Zorraxhi Presheva,

Rahovica kalanica,

.....

Dum, dum Tupani

Budalla Llojani

Qel Miratoca

Zhugava Tërriana

Sallata Presheva

Nasgjargji Rahovica

Harnë Corrotica¹¹³

Këngë të këtilla, që kanë si objektiv përcaktimin e vetive e të karakteristikave të njerëzve, ose të vendeve të ndryshme, ka mjaft dhe

¹¹² Gj. Petrov, Materiali za izucavaneto na Makedonia/Materiale për studim në Maqedoni/, Sofia, 1896, f. 543

¹¹³ E tregoi Hamit Ilinca, në version të shkurtuar

janë të komponuara nga anonimi popullor. Megjithatë në rastin e mbajtjes së çevresë, më e drejtë është të përcaktoheni për funksionin nga mbrojtja e bartësit nga të ftohtit, ose nga të ngrohtit dhe thjesht si një vizualitet më vete. Edhe një e dhënë interesante për veshjën e përshkruar më lartë dhe për Preshevën bujare e kreshnike. Sipas kujtimeve të Mulla Tefik Osmanit nga Presheva, në qershor të vitit 1930, Grupi i Vallëtarëve dhe i Këngëtarëve nga Presheva, ndër të tjerët ishin edhe Selim Osmani dhe Zejdi Ahmeti, vallëtarë dhe këngëtarë, shkojnë në Beograd dhe marrin pjesë në manifestimin kulturor dhe gjimnastikor të organizatës “Soko” të Jugosllavisë Mbretërore të Jugosllavisë. Grupi i vallëtarëve ishte i veshur me veshje kombëtare, tirqi e xhamadanë. Bile tirqit e zezë vallëtarit Selim Osmanit ia siguroi Emin Kurbaliu i Preshevës, i cili vishej rregullisht me tirç të zi dhe mbante me vete çiftelinë. Pjesëmarrjen e Grupit të vallëtarëve dhe këngëtarëve e shënoi edhe shtypi i atëhershëm jugosllav: pjesëmarrjen e grupit e vërteton edhe fjala përshëndetëse e kryetarit të Shkupit, kur thotë, se në këtë manifestim të forcës dhe të disiplinës nacionale, bashkimit dhe përpjekjeve për një të ardhme më të mirë marrin pjesë të gjitha viset e Banovinës së Vardarit me veshjet e tyre kombëtare. Presheva deri më vitin 1945 i takoi kësaj banovine.

REFERENCAT:

1. Berisha, Metush, Reflektime të traditës kulturore /Karadaku i Preshevës/, Prishtinë, 2013
2. Çështja e valles popullore shqiptare në Preshevë dhe rrethinë, Tribunë shkencore e mbajtur në Preshevë, më 24 dhjetor 2010
3. Halimi–Statovci, Drita, Veshjet shqiptare të Kosovës, Prishtinë, 2009

4. Halimi, Kadri, Studime etnologjike, Prishtinë, 1994
5. I njëjti, Studime etnologjike, Komploti i veprave, nr.2, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2011
6. I njëjti, Trajtime dhe studime etnologjike, Prishtinë, 2000
7. Ilinca, Hamit, këngëtar popullor
8. Petrov, Gj., Materiali za izucavaneto na Makedonia/Materiale për studim në Maqedoni/ , Sofia, 1896
9. Plisi i Bardhë, simbol me rëndësi kombëtare që duhet ruajtur dhe trashëguar ndër breza, Gazeta “Bytyçi”, 26 gusht 2011
10. Skoplje i Juzna Srbija, Beograd, Izdanje Profesorskog drustva, 1925.godine
11. Salihu, Xhemaledin, Valle dhe këngë popullore të vjetra, Preshevë, 2010
12. Statovci, Drita, Mbi disa tipare etnografike të Karadakut, Gjurmime albanologjike, folklor e etnologji, 23–1993, Prishtinë Instituti Albanologjik I Prishtinës
13. Xhagolli, Agron, Bogdani, Ramazan, Letërsi folklorike, Prishtinë, 1996

BEKIM RAMADANI

*Fakulteti i Artit Muzikor, Universiteti "Fadil Sulejmani" –
Tetovë*

QERIM ETEMI, MJESHTËR I PRODHIMIT TË VESHJEVE TRADICIONALE

Abstrakt

Në këtë punim bëhet fjalë për jetën dhe veprën e shkupjanit Qerim Etemi i cili përmes punës artizanale ka arritur t'i shërbejë në mënyrën më besnike mbrojtjes së veshjeve tradicionale shqiptare, njëres nga pasuritë më të çmuara të kulturës sonë popullore, nga zhdukja e plotë dhe harresa e përhershme. Gjatë punës 35 vjeçare, ky zejtar pajisi me veshje tradicionale dhjetëra shoqëri kulturore artistike, qindra aktorë dhe po aq dashamirë të folklorit dhe traditave të së kaluarës, duke mos e zhgënjyer shpresën e askujt, sepse përveç materialit dhe qepjes, kujdes të veçantë i kushton edhe modelit, ngjyrave, aksesoreve dhe nuancave të tjera që ndërlidhen me origjinalitetin. Me duar të arta, ky 67 vjeçar, punon edhe në këto kohë zhvillimesh të llahtarshme duke gjetur mundësi që të më rrëfejë me fjalë të ëmbla për hapat e prodhimit të veshjeve tradicionale që nga porosia e deri te realizimi final, pra, për marrëveshjen, për materialin, për prerjen, për qepjen, për makinën qepëse, për veglat e punëtorisë, për çmimet etj.¹¹⁴ Ai flet edhe për

¹¹⁴ Intervistën me zotin Qerim Etemi e zhvilluam, në punishten e rrobaqepësisë përballë xhamisë "Hatunxhuk" aty ku ndodhet edhe shtëpia e tij, me datë 16 prill 2020 (e enjte) në periudhën e gjendjes së jashtëzakonshme të shkaktuar nga pandemia e virusit Covid19. Bashkëbisedimin e frytshëm e ndërpreme diku nga ora 14.30 sepse më duhej të kthehem në Tetovë para orës 16.00, para se të fillonte ora policore. (Shiko fotot me nr. 1 dhe 2)

përkrahjen e fuqishme të zonjës së tij, pastaj për takimet me kostumografë, koreografë dhe artistë të shumtë. Çdo prodhim që del nga punëtorja e tij është pasuri monumentale, sepse e tillë është etnokultura shqiptare, një vlerë që shprehet në trajta shumë të mëdha e përgjithësuese, përmbajtjesore dhe mbresëlënëse, artistike dhe estetike, ashtu siç lë mbresë me madhështinë e vet pronari i kësaj punëtorie, mjeshtri Qerim Etemi.

Fjalët çelës: *Qerim Etemi, punëtori, veshje tradicionale, mjeshtrë, prerje e qepje, makinë qepëse, etnokulturë.*

Studimi i karakteristikave kombëtare të kulturës popullore paraqet interes të shumanshëm. Në këtë kuadër edhe kultura popullore është një fushë gjurmimesh, prej nga mund të nxirren të dhëna me interes. (Andromaqi, 1980, fv. 149–150) Përveç gojëdhënave, poezisë popullore, legjendave, përrallave, anekdotave etj., një pjesë e kulturës popullore ku pasqyrohen drejtpërdrejt jo vetëm vlerat artistike të popullit tonë por edhe specifikat etnike që e dallojnë nga kultura e popujve të tjerë janë padyshim veshjet popullore.

Pjesa më e madhe e veshjeve tona popullore është ruajtur falë të dhënave nga arkivat, nga zbulimet arkeologjike, nga veprat e shkrimtarëve të ndryshëm, nga udhëpërshkruesit që kanë kaluar nëpër trevat tona dhe të cilët përmes lapsit, vizatimit apo fotografisë e kanë mbrojtur kostumin autentik popullor nga harresa e plotë. Përveç këtyre burimeve, përfytyrimin për veshjet popullore të së kaluarës gjithashtu mund ta krijojmë përmes teksteve të këngëve të vjetra epike, baladave etj. Poezi të tilla popullore kanë lënë gjurmë në lidhje jo vetëm me veshjet e ndryshme të kohës, emrin, funksionin dhe materialet e tyre, por edhe me shfaqjen e forcës së

ndërgjegjes kombëtare. “O Vlladika i biri i shkinës / Mos ia ven topat Vraninës / ... Nuk i njoftë fustanllinjt / Se me dor’ t’mbyllin franjit / ... ose vargjet e një kënge tjetër, që shpreh ankimin e një fshatari të thirur nizam, në të cilën thuhet: “Shokë do na xhvishet fustani (fustanella) / Do na vishet shallvari/ ...” (Andromaqi, 1980, f. 177). P.sh. në një këngë tjetër lirike hasim gati të gjitha elementet e veshjes së burrit opojan: “Vish djat tirqit, / me gajtan përmbropa / vishi djat tirqit / me gajton te koma / vishi djat tirqit / me koporanë / kmishen e bardhë / e me mongë të gjonë / vishi djatë qorap e rrogzina”... (Siqeca, a.d.)

Të krijuara me dekada dhe shekuj si pasqyrë e historisë etno-kulturore, veshjet popullore janë, para së gjithash, prodhim i vatrës së shtëpisë. Deri nga fundi i shekullit XIX, veshjet tradicionale janë krijuar me shumë kujdes nga duart e vyeshme të (vajzës) gruas së fshatit te e cila shkrihej mjeshtëria dhe shija, talenti dhe fantazia, e bukura dhe artistikja. Disa elemente i kanë huazuar nga zejtarët ruralë dhe urbanë, ndërkaq veshjet ceremoniale janë qepur nga terzinjtë¹¹⁵ me përvojë, puna këmbëngulëse e të cilëve e ka shënuar traditën e vendit tonë. Ata së bashku me abaxhinjtë¹¹⁶, artizanët dhe zejtarët e tjerë kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në lidhjen mes kulturës popullore dhe paraardhësve tanë. Përmes duarve të arta e kanë mbajtur të gjallë pasurinë materiale dhe jomateriale duke shërbyer si burim i besueshëm për studime të mirëfillta. Deri nga vitet e pesëdhjeta të shekullit të kaluar praktikohet që gjatë

¹¹⁵ Fjala “terzi” rrjedh nga persishtja dhe do të thotë rrobaqepës, zejtar që merret me rrobaqepësi, me prerje, qepje dhe zbukurim të veshjeve të vjetra qytetare, popullore, duke përdorë materiale të veçanta nga leshi, mëndafshi, pambuku, pëlhura etj.

¹¹⁶ “Abaxhi” rrjedh nga fjala arabe aba (që do të thotë pëlhurë nga leshi i ashpër) dhe fjala turke – axhija (mjeshtër, zejtar). Pra abaxhi quhet zejtar i qep kostume popullore kryesisht për masën fshatare.

periudhës së dimrit abaxhinjtë të shkonin nëpër shtëpitë e myshterinjve dhe atje t'ua qepnin veshjet duke qëndruar për disa ditë rresht si mysafirë të angazhuar me detyrë të caktuar.¹¹⁷

Koha moderne i ka mënjeluar ngadalë, por shumë sigurt, terzinjtë dhe abaxhinjtë që shekuj me radhë kanë qepur veshje popullore. Terzinjtë e sotëm që në numër janë fare të paktë, veshjet popullore tradicionale i qepin kryesisht për shoqëritë kulturore dhe artistike, për dashamirët e traditës dhe për të huajt që shfaqin interes të veçantë për kulturën tonë materiale.

Njëri nga ata është shkupjani Qerim Etemi i lindur në Shkup me 14 mars 1953, njëri nga shtatë fëmijët e babait Asan dhe nënës Igballe. Familja Etemi me prejardhje nga fshati Elezaj i komunës së Kaçanikut (Republika e Kosovës) është shpërngulur në Shkup në vitin 1927. Disa anëtarë të kësaj familjeje shpërngulen në Turqi gjatë viteve të pesëdhjeta¹¹⁸, ndërkaq gjatë dekadave në vazhdim, disa të tjerë marrin rrugën e mërgimit duke udhëtuar ca në Evropë e ca në ShBA. Qerim Etemi përkundër vështirësive jetësore i mbetet besnik kryeqendrës dardane dhe së bashku me anëtarët e ngushtë të familjes u bën ballë dallgëve të jetës duke arritur t'i shërbejë ndershëm jo vetëm familjes, por edhe shoqërisë.

Pas mbarimit të shkollës fillore fillon të shërbejë si çirak për vite me radhë në punëtorinë e Iljaz Hoxhës, njërit nga terzinjtë më të njohur të çarshisë së Shkupit. Në vitin 1972 para një komisioni të formuar nga shoqata e zejtarëve të Shkupit me në krye Jovan Kuzmanovski e jep provimin e rrobaqepësisë dhe fillon të punojë

¹¹⁷ Këta ishin zejtarë shëtitës.

¹¹⁸ E njohur si “Koha e Rankoviqit”.

në shtëpi, në mënyrë të pavarur duke qepë sipas kërkesave të kohës (këmisha, kravata, pantallona¹¹⁹ etj.).

Në vitin 1979 martohet me zonjën Mirvete, kushëriri i së cilës i rekomandon që të kyçet në teatrin e kombësive në Shkup. Në vitin 1980 punësohet në teatër si dekorues, ndërkaq dy vite më vonë si rrobaqepës dhe këtë detyrë e kryen me sukses deri në vitin 2017, atëherë kur del në pension.

Teatri i ka mundësuar që të njihet me gjëra e dukuri që gjatë jetës së përditshme nuk do të kishte pasur mundësinë për t'i takuar kurrë. Aty ka qepur gjithçka, nga thasët e thjeshtë të kohës së gurit e deri te veshjet bashkëkohore, varësisht nga nevojat e realizimeve skenike. Në teatër është takuar me regjisorë, kostumografë, skenografë, koreografë dhe aktorë të shumtë nga vise të ndryshme të botës. I kujton me respekt dy udhëheqësit e përgjegjshëm të teatrit: drejtorin e dramës shqipe Muhamed Sherifi dhe drejtorin e dramës turke Firdaus Nebi të cilët i kanë mundësuar që të ndihet më komod në hapësirat e këtij institucioni të rëndësishëm kulturor. Me respekt të madh e kujton edhe kolegen e vet rrobaqepësen Hyreja Sulejmani, pastaj kostumografen Elena Donçeva nga e cila ka mësuar shumë gjëra. Kjo është koha kur porositë bëheshin përmes fotografive, por mbi fotografitë vendoseshin edhe copat e materialit. Kjo është kohë e përgjegjësive të mëdha profesionale, e një profesionalizmi të lartë, sepse gjithçka duhej bërë me kujdes e me përkushtim. Çdo detaj ishte i rëndësishëm, por një detaj i tepruar mund ta prishte tërësinë, shprehet zoti Etemi. Jo rrallë është dashur që të krijosh aty për aty, t'u përgjigjesh shpejtë urdhrave të vetëtimshëm. Aty është ballafaquar me lloj-lloj situatash që kanë

¹¹⁹ Pantallonat e asaj kohe kanë qenë zakonisht nga 40-50 centimetra të gjera në fund të këmbëve dhe janë mbajtur me një lloj nallanesh.

kërkuar zgjidhje të menjëhershme. Duhej shumë shpejtë të gjeje mundësi, teknika dhe forma inovative për t'u dëshmuar si mjeshtër i shquar, thotë zoti Etemi. Me këtë rast, më tregoi edhe një anekdotë. “Kur një student që sapo kishte diplomuar në një shkollë teknike ishte pyetur nga një profesor se ç'do të thotë fjala teknikë, ky ishte përpjekur për të sqaruar duke filluar nga origjina e fjalës greke *tehne* që do të thotë aftësi dhe shkathtësi për të krijuar produkte zejtare, industriale dhe artistike përmes përdorimit të njohurive shkencore e kështu me radhë, me ç'rast profesori e kishte ndërprerë dhe në formë shakaje i kishte thënë që: teknikë do të thotë të të teket, të të vete mendja, të të lind befaz një ide për çështjen e caktuar në momentin e duhur... Dhe, të mos harrosh kurrë se ideja vlerësohet, paguhet dhe shpërblehet”. Zoti Etemi e ka shfrytëzuar çdo çast, çdo komunikim, çdo përvojë, çdo takim për të nxjerrë mësim, andaj jo rastësisht shpeshherë ka marrë detyra për të qepur edhe për teatrot e tjera të Maqedonisë, si për atë të Strumicës, të Shtipit, të Velesit etj.

Në vitin 1991 është takuar me artistin e njohur shqiptar Fehmi Shaqirin i cili gjatë asaj kohe ka qëndruar në Shkup duke zhvilluar aktivitete koreografike me valltarët e SHKA “Emin Duraku”. Ky takim ka qenë i dobishëm dhe shumë frymëzues për punën e mëtejme të zotëri Qerim Etemit, sepse nga kjo periudhë e këtej në punëtorinë e tij do të qepen me qindra e qindra kostume popullore të të gjitha zonave, të të gjitha modeleve, të të gjitha ngjyrave.

Njerëzit që vijnë dhe që porosisin kostume popullore u përkasin shtresave dhe shijeve të ndryshme. Ka nga ata që kërkojnë qepje në dorë, me zbukurime dhe nga materiali i shtrenjtë. Të tillët nuk pyesin për çmim. Ka nga ata që porosisin për grupe, ansamble e formacionesh të ndryshme kulturore—artistike dhe të diktuar nga

rrethanat financiare përpiqen të gjejnë një mesatare në stilin “edhe ujçit e ngopur, edhe dhentë në numër”. Ka nga ata që jetojnë me artin popullor dhe dëshirojnë që në shtëpitë e tyre të kenë kostume ceremoniale, por nuk kanë mundësi për të paguar në mënyrë korrekte, andaj nuk i kushtojnë edhe shumë rëndësi cilësisë. Për ata është me rëndësi dukja. Sidoqoftë një kostum mesatar¹²⁰ përfshirë tirqit, këmishën dhe jelekun sillet rreth 100 Eu, por kur kësaj t’i shtosh edhe opingat, çorapet, brezin, qeleshen dhe ndonjë zbukurim të thjeshtë, arrin shumën 200 Eu. Pastaj, zoti Etemi thotë se nëpër çarshinë e Shkupit mund të hasësh edhe kostume me vlerë 50 – 60 Eu, por ato janë jashtë çdo standardi, janë thjesht imitim i mirë. Ato mund të prishen që pas larjes së parë. Rreth jetëgjatësisë së veshjeve popullore, në popull qarkullon një thënie sipas së cilës “një kostum cilësor e përdorin së paku tri gjenerata”. (Anadolija, 2013) Të mos harrojmë se edhe veshja më cilësore kërkon mirëmbajtje të përgjegjshme. Pas larjes duhet pasur kujdes që të mos thahen në diell të fortë për shkakun se bëhen si kore, ndërkaq duhet të ruhen në ambiente të errëta që të mos e humbin shkëlqimin, por edhe të kihet kujdes që të mos i bren mola.

Zoti Etemi, ka qepur për meshkuj e femra, për të vegjël e të rritur, ka qepur veshje tradicionale dhe ceremoniale, ka qepur për SHKA “Ibe Palikuqi” nga Shkupi, për “Xheladin Zeqiri” nga Tetova, për SHKA “Sharri” nga Hani i Elezit, për SHKA “Bajram Shabani” nga Kumanova, për SHKA “Haki Stërmilli” nga Dibra, për SHKA “Karshiaka” nga Shkupi, për ansamblin “Shota” nga Prishtina, për ansamblin e këngëve dhe valleve popullore shqiptare në RMV etj. Ka qepë edhe për ansamble turke dhe maqedonase, për individë të zonave të ndryshme, për njerëz me nivele të ndryshme kulturore.

¹²⁰ Pa i llogaritur zbukurimet, sepse ato e ndryshojnë dukshëm çmimin.

Ka qepë këmisha, jelekë, xhamadanë, tirqi, ferexhe, gëzofë, fustanella, xhubleta, dollame, lurka, breza etj.

Pronari i punëtorisë, Qerim Etemi, thotë se përdor materiale me cilësi të lartë prej pelushit, leshit, pëlhurës së bardhë, zhgunit, shajakut etj., të cilat i porosinë nga burime të ndryshme, por furnizimin kryesor e ka nga fabrika “Teteks” e Tetovës. Materialin e zakonshëm që e përdor në pjesën më të madhe të veprimtarisë së tij është i përbërë nga 75 % lesh dhe 25 % sintetikë, një lëndë me të cilën shërbehen edhe bukëpjekësit kur e mbulojnë brumin për të ardhur sa më shpejtë buka. (Shiko fotot me nr. 3 dhe 4)

Qerim Etemi ka qepur shumë lloje të veshjeve popullore, por është shumë i bindur kur thotë se shqiptarët kanë një thesar të jashtëzakonshëm të veshjeve tradicionale saqë është e pamundur të qepen brenda një jete njeriu të gjitha variantet dhe nënvariantet.

Veshja popullore shqiptare është jashtëzakonisht e larmishme, me një prerje elegante, me kombinime të guximshme, me lloj-lloj ngjyrash, me zbukurime, aksesore dhe shtojca të ndryshme.

Ato karakterizohen me pasuri të madhe të ngjyrave, detale të llojllojshme dhe ornamente të tjera që krijohen nga ndikimi i rrethanave socio-shoqërore dhe lidhjeve me kulturat fqinje.

Larmia e veshjeve popullore është e përcaktuar nga një numër faktorësh objektivë si zhvillimi ekonomik e shoqëror, niveli kulturor, shtresëzimi shoqëror, kushtet e veçanta gjeografike dhe ekonomike të zonave dhe nënzonave, përkatësia fetare, zonat e lidhjeve martesore etj. (Shkurti, 1980, f. 180)

Mjetet që i përdorë mjeshtri Qerim Etemi në veprimtarinë e tij prej rrobaqepësi janë: metri, gërshërët, gjilpëra, vizoret, makina

qepëse,¹²¹ “ovërlaku”¹²², hekuri, tavolina për hekurosje etj. (Shiko foton me nr. 5) Sot mund të takosh edhe punëtori që përdorin teknologji të sofistikuar të qepjes duke prodhuar në seri dhe në mënyrë fabrikative, por asnjëherë nuk mund ta zëvendësojnë artin e të qepurit në dorë, sepse produktet artizanale sikur kanë një shkëlqim tjetër. Ngjashëm sikur nënat, gratë e motrat tona që më së shumti i parapëlqejnë dimitë e punuara në dorë sesa ato që janë produkt i makinave qepëse, ndodh edhe me të gjitha veshjet tjera të traditës, shprehet mjeshtri Etemi. Gratë dhe vajzat, kryesisht në dasma dhe festa shpesh bëhen pasionante të përdorimit të veshjeve të traditës, ndërsa, për burrat ajo përdoret shumë rrallë, e jo vetëm kaq, por në ato raste që vishet, duket se e ka humbur origjinalitetin e saj. (Parllaku, 2015)

Veshjet popullore, tipat e variantet apo pjesët e tyre punohen me dorë e me kreativitet. Gjatë punimit të tyre shprehet ndjenja për të bukurën... (Kostumografia, a.d.), por ja që zhvillimet ekonomike e diktojnë edhe këtë veprimtari. Sot është vështirë të qepësh në dorë, andaj Zoti Etemi ka zgjedhur një mes ndërmjet arkaikes dhe bashkëkohores. Në fund të fundit, edhe në çdo veshje popullore hasen elemente tradicionale mbi të cilat janë shtresëzuar elemente të reja. (Shiko foton me nr. 6)

Modifikimi i pjesshëm i elementit tradicional dhe pasurimi me elemente të reja, në përputhje me kërkesat e kohës, përbën një detyrë me rëndësi gjurmimi dhe evidentimi për studiuesin. Të dy

¹²¹ Nga markat e shumta të makinave qepëse, zoti Etemi e preferon prodhimin “Singer” edhe atë me motor mekanik sepse, siç thotë, mund ta kontrollojë më lehtë procesin, sidomos gjatë qepjes së gajtanëve.

¹²² Ovërlak është një mjet të cilin rrobaqepësit e përdorin për t’i kaluar rrethet (skajet) e copave të prera. Serbët dhe maqedonasit e quajnë Overllak, kurse anglezët Overlock.

këto momente, d.m.th tradicionalja dhe e reja, të veçuara qartë në procesin e studimit dhe të analizës, ndihmojnë jo vetëm për të ndjekur historinë e veshjes në përgjithësi, por edhe atë etnike në veçanti. (Shkurti, 1980, f. 186)

Terziu Etemi thotë se “kjo punë nuk është fitimprurëse, por është frymëzuese në kuptimin shpirtëror. Ajo më plotëson aq shumë dhe kjo më jep kënaqësi kur dikush vesh një veshje të cilën e kam qepur unë. Punoj për para, por paraja nuk është gjithçka për mua. Shumë rrallë ka ndodhur që dikush të bëhet i pasur përmes gjilpërës.” Shumëkush që e ushtron këtë zeje thotë se marrja me artin popullor është më tepër pasion sesa profesion. (Njegomir, 2017)

Sidoqoftë, zeja e rrobaqepësit është një veprimtari në zhdukje e sipër, aq më tepër kur bëhet fjalë për veshjet popullore, sepse pjesa dërmuese e njerëzve të kohës sonë kërkojnë mundësi për të arritur shumë shpejt te paraja. “Me këtë punë nuk bëhesh i pasur, por mund të bësh një jetë të ndershme. Përmes kësaj veprimtarie manifaktuarale arrita që t’i rrisë e t’i shkollojë të tre fëmijët. Dy vajzat, Sibeli dhe Suhera kanë diplomuar, njëra në shkollën e lartë pedagogjike e tjetra në fakultetin ekonomik, ndërkaq djali, Visar Etemi, u bë aktor dhe është i angazhuar në teatrin ku unë punova rreth 4 dekada” thotë në fund të bisedës zoti Qerim Etemi duke falënderuar edhe një herë njerëzit që e frymëzuan më së shumti për t’u futur në botën e etnokulturës shqiptare si: Alush Hamiti, kryetar i ShKA “Ibe Palikuqi”, Emin Gaxha, koreograf i SHKA “Emin Duraku”, Fehmi Shaqiri, artist i merituar nga Shqipëria, Hadi Kasami, ish kryetar i SHKA “Xheladin Zeqiri”, Huzri Osmani, ish koreograf i SHKA “Karshiaka” nga Shkupi, Burhan Balla, ish



Foto 2 Autori i shkrimit gjatë bisedës me z. Qerim Etemin



*Foto 3 Materiali më i përdorshëm për
qepjen e veshjeve popullore*



Foto 4 Gajtani i zi



Foto 5 Mjetet që i përdorë gjatë punës terziu Qerim Etemi



Foto 6 Disa nga veshjet e gepura në punëtorinë e z. Qerim Etemit

Bibliografia

Anadolija, A. (2013, 5 18). *Porodica Rakočević izradom narodne nošnje čuva tradiciju od zaborava*. Gjetur në TRT – bosanski: <https://www.trt.net.tr/bosanski/region/2013/05/18/porodica-rakocevic-izradom-narodne-nosnje-cuva-tradiciju-od-zaborava-19783>

Andromaqi, G. (1980). Specifika etnike në veshjet popullore. *Probleme të zhvillimit të folklorit bashkëkohor*.

Cooley, C. H. (2018, 9 18). *15 realnih citata o umetnosti i umetnicima*. Gjetur në Ananas Magazin.

Kostumografia. (a.d.). Gjetur në Veshjet tradicionale shqiptare: <https://veshjettradicionale.weebly.com/kostumografia.html>

Njegomir, T. (2017, 1 9). *PREDUZETNIČKA PRIČA: Narodna umetnost kao strast i kao biznis*. Gjetur në BIZLife: <https://www.bizlife.rs/preduzetnistvo/preduzetnicka-prica-narodna-umetnost-kao-strast-kao-biznis/>

Parllaku, A. (2015, 10 18). *Illyria*. Gjetur në Burrat e Lumës, tradicionalisht çfarë vishnin: <http://illyriapress.com/burrat-e-lumes-tradicionalisht-çfare-vishnin/>

Paylaş, Y. (a.d.). *Atatürk'ün Sanatçı Kişiliğinin Sanata ve Sanatçıya Bakışına Etkileri*. Gjetur në Iste Atatürk: <https://isteataturk.com/g/kategori/sanat>

Shkurti, S. (1980). Mbi shkaqet historiko-shoqërore të larmisë në veshjet popullore. *Probleme të zhvillimit të folklorit bashkëkohor*.

Siqeca, S. (a.d.). *Veshjet kombëtare dhe tekstilet e regjionit të Opojës në kompleksin monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*. Gjetur në www.sa-kra.ch: <http://www.sa-kra.ch/veshjekomopojare1.htm>

SALI ISLAMI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

BUNJAMIN XHEMAILI

Muzeu Arkeologjik i Maqedonisë së Veriut

VESHJE ILIRE NË DISA GJETJE ARKEOLOGJIKE PARA PUSHTIMIT ROMAK

Abstrakt

Ilirët ndër vite kanë qenë temë e diskutimeve ndërmjet studiuesve të ndryshëm. Disa prej tyre janë marrë me etnogjenezën e tyre, disa me gjuhën e tyre, por pak prej tyre janë marrë me veshjen e dhe përditshmërinë e ilirëve. Kjo për vet faktin që kemi shumë pak informacione në lidhje me këtë pjesë jo pak të rëndësishme të ilirëve. Prandaj është shumë e rëndësishme që ato pak të dhëna që i kemi, t'i interpretojmë në mënyrë të duhur. Në ndihmë na vjen etnologjia dhe arkeologjia, me anë të së cilës ne do të mundohemi të hedhim pak dritë, mbi atë se si janë veshur ilirët. Fokusi jonë do të jenë periudhat arkaike, klasike dhe helenistike. Prandaj në këtë punim do të përmbledhim vetëm disa gjetje arkeologjike të gjetura në Gadishullin Ballkanik, e që lidhen me Ilirët. Edhe pse në shikim të parë mund të duket që nuk ka shumë lidhje me veshjet tradicionale shqiptare, gjithsesi ne do të paraqesim ato pak elemente që i njohim. Padyshim se do të na ndihmojnë gjetjet arkeologjike (figurina, buste, stela, etj.), por edhe inventaret e varreve e sidomos stolitë, e që janë të shumta si: fibulat, qaforet, kapëset, gjilpërat, vathët, byzylykët, etj.

Fjalët çelës: *Ilirët, veshje, këmisha, qelesnja, periudha, hekuri, Romake, etj.*

Të gjitha të dhënat që kemi sot për ilirët i kemi nga disa burime. Burimi i parë është i autorëve antik që kanë shkruar për ilirët, burimi i dytë është nga linguistët, burimi i tretë por jo më pak i rëndësishëm është arkeologjia. Të dhënat arkeologjike për ilirët i kemi të shumta, kryesisht nga gërmimet arkeologjike të kryera nëpër vendbanime ilire por edhe nga nekropleet.

Sot kemi shumë informacione për territorin ku shtriheshin ilirët, kemi informacione për fiset kryesore, për luftërat që i kanë bërë, për mënyrën e jetës, për kultet e tyre, por nuk kemi shumë të dhëna për veshmbathjen e tyre. Për veshjen ilire ne sot në masë të madhe mund vetëm të supozojmë. Perandoria Romake, sigurisht që përveç se në aspektin politik, ajo ndikoi edhe në aspektin shoqërorë të ilirëve pra detyrimisht edhe në veshje, bazuar nga plastika dekorative e gurit. Prandaj në këtë punim ne do të mundohemi t'i shmangemi periudhës Romake, për arsye sa ka shumë punime artistike, si skulptura, buste, statuja, stela, reliefi, me motive të ndryshme dhe se është gati e pamundur të veçojmë ndonjë element autokton. Ne do të fokusohemi në periudhën e *Hekurit, periudhënarkaike, klasike dhe helenistike*. Nuk duhet harruar të përmendim pavarësisht se ne do të tentojmë të flasim për veshjen ilire si tërësi, ajo ndryshon nga zona në zonë. Pra, ilirët në viset jugore sigurisht që u ndikuan nga qytetërimi helen dhe se visheshin ndryshe nga ilirët e viseve perëndimore e veriore, pa harruar edhe sundimin Romak, e dyndjet tjera të fiseve që kanë ndikuar në jetën sociale duke bërë që kjo të ndikojë edhe në stilin e veshjes së ilirëve. Burimi kryesor për njohjen e veshjes ilire janë

monumentet nga periudha Romake¹²⁴. Por kemi edhe shembuj akoma më të vjetër duke filluar nga shekulli IV para Kr. Gjatë gjërmineve arkeologjike në nekropole, ne hasim në material të lëvizshëm arkeologjik, e kryesisht qeramikë, mirëpo ka raste kur ne zbulojmë edhe ndonjë pjesë të veshjes, si fjala bie: fibula, togëza, kapëse, pulla, etj. Në territorin e Ilirisë të njohura janë varrezat tumulare, në të cilat ilirët i varrosnin të vdekurit edhe me rroba, duke i shoqëruar me inventar të ndryshëm. Do të flasim në pika të shkurta për llojet e veshjes që ne njohim sot, e pastaj do të japim një pasqyrë më të detajuar për disa objekte arkeologjike, që do të na ndihmojnë për të kuptuar stilin dhe llojin e veshjes që është përdorur ndër shekuj. E pse jo eventualisht të bëjmë ndonjë krahasim me veshjet tradicionale shqiptare. Veshja e burrave dhe grave ka dalluar. Burrat janë veshur më thjesht pa ndonjë stilizim të theksuar, ndërsa gratë kanë pas një shumë llojshmëri të veshjes. Veshjet kanë qenë më të stilizuara, më me shumë detaje dhe me shumë stoli. Si veshje të zakonshme të burrave kanë qenë, guna, këmisha, kësulata, qafore qelibari, ndërsa udhëheqësit ilir kanë mbajtur qafore bronzi, etj. Ndërsa si veshje më e zakonshme e grave ka qenë shalli-shamia (që ka mbuluar kokën dhe shpatullat), manteli. Një lloj i veshjes te gratë ishte veshja e cila binte deri tek këmbët, sipër vishej një mantel me mëngë të gjatë, me rripa te beli. Një veshje tjetër interesante që edhe sot ruhet në veri të Shqipërisë dhe Kosovës, që ishte lloj fustani në formë të kambanës, e që shoqërohej edhe me kapelë¹²⁵.

Ilirët kanë mbajtur shumë stoli e bizhuteri, apo siç thotë J. Wilkes, ilirët kanë mbajtur çdo lloj, e madhësi të varëseve, qaforeve,

¹²⁴ John Wilkes, *The Illyrians*, 1996, fq. 227

¹²⁵ John Wilkes, *The Illyrians*, 1996, fq. 229

fibulave, etj.¹²⁶. Për nga dekorimi dominon dekorimi me rathë koncentrikë të stilizuar por jo vetëm. E kjo vërehet shumë mirë me gërmimet arkeologjike të kryera në Maqedoni (Trebenisht, Lisiçin Doll– Marvinci, etj), Shqipëri (Dimal, Maliq, etj), Kosovë (Pejë, tumat e Gllarevës, tumat e Ponoshecit, etj), por edhe më gjerë. Kështë gjetur një numër i konsiderueshëm i stolive. Duke u bazuar nga materiali arkeologjik që është gjetur në Maqedoni dhe Kosovë, më poshtë do të paraqesim disa nga veshjet kryesore ilire.

Këmisha: Nga rrobat ilire më së shpeshti kemi hasur në këmishën, mbi të cilën mbahej edhe guna¹²⁷. Gërmimet arkeologjike të kryera në lokalitetin Ribiq të Bihaçit, për herë të parë kanë dhënë një ide se si është dukur kjo këmishë, e datuar nga shekulli V–IV para Kr.¹²⁸. Pamje të tjera të kësaj këmishe shfaqen edhe në lokalitetin Zenicë, në një monument varri, e datuar në shekullin IV para Kr.¹²⁹. Ishte kjo këmishë që gjatë shekullit II para Kr., hyri në përdorim edhe në Romë, më vonë duke u bërë edhe rrobë e perandorëve, e në fund u bë rrobë liturgjike në kishën katolike dhe që ruhet edhe sot e kësaj dite¹³⁰.

Kësulat: Kemi disa lloje të kësulave që mendohet se kanë mbajtur ilirët. Më e përhapura është me formë të rrumbullakët, pak e shumë e ngjashme me plisin (qeleshen) që mbajnëshqiptarët sot¹³¹, si rasti me altarin nga Zenica, i datuar gjatë shekullit IV para Kr., e që

¹²⁶ Po aty, fq. 232

¹²⁷ Po aty,

¹²⁸ Dimitrije Sergejski, Japodske urne, *Glasnik Zemaljkog muzeja* 4-5, 1949-50, fq. 83

¹²⁹ Dimitrije Sergejski, Spatantike Denkmaler aus Zenica, *Glasnik Zemaljkog muzeja* 44, 1932, fq. 48-50

¹³⁰ Aleksandar Stipčević, Ilirët, Historia, Jeta, Kultura, Simbolet e kultit, Tiranë 2002, fq. 88-89

¹³¹ Po aty, fq. 89-90

paraqet një relief me katër burra të cilët mbajnë kapelë shumë të ngjashme me qeleshen shqiptare¹³². Rast të ngjashëm kemi edhe me gurin mbi-varror i gjetur në Crnobuk të Manastirit edhe ky i datuar gjatë shekullit IV para Kr., në të cilin paraqitet një relief me disa burra që në kokë mbajnë kapelë të ngjashme me plisin.

Mbathjet – opingat: Punoheshin nga lëkura që kthehej nga këmba dhe lidhej me lidhëza lëkure. Ato fillojnë të paraqiten qysh në shekullin V–IV para Kr., e duke vazhduar edhe gjatë periudhës Romake. Më vonë sllavët i kanë marrë nga ilirët duke i quajtur opanci¹³³.

Guna: Nga periudha Romake kemi edhe një monument të valltarit, e gjetur në Zaoztrogun, ku paraqitet guna e cila është e hedhur mbi krahun e majtë¹³⁴. Ndërsa gratë gunat i kishin me kapelë ose ndryshe si quheshin nga autorët antik cucullus bardaicus¹³⁵, e që nënkupton gujë me kapelë e veshur nga fisi i liburnëve ose dardæi¹³⁶. E që me shumë gjasë të ketë qenë e bërë nga leshi.

Pantallonat: Duke u bazuar nga monumentet e periudhës Romake, e ku ilirët paraqiteshin si robër kemi paraqitje të pantallonave, por që nuk mundë të themi me siguri të plotë se ilirët kanë veshur pantallona¹³⁷.

Stolitë: Element shumë i rëndësishëm i veshjes ilire kanë qenë edhe stolitë. Në fakt si dëshmi fizike i kemi vetëm stolitë, me anë të së

¹³² John Wilkes, *The Illyrians*, 1996, fq. 229

¹³³ Po aty,

¹³⁴ Dujë Rendic-Miocevic, *Antikni reljef plesaca is Zaoztroga u Dalmaciji*, Tkalciev zbornik 1, Zagreb 1955, fq. 11-12

¹³⁵ Aleksandar Stipčević, *Ilirët, Historia, Jeta, Kultura, Simbolet e kultit*, Tiranë 2002, fq.91

¹³⁶ Anthony Rich, Jun. B.A., *The Illustrated Companion to the Latin Dictionary and Greek Lexicon*, London 1849, fq.80

¹³⁷ Aleksandar Stipčević, *Ilirët, Historia, Jeta, Kultura, Simbolet e kultit*, Tiranë 2002, fq.89

cilave ne sot mundë të rikrijomë skena të jetës së përditshme dhe veshjes ilire. Nga gërmimet arkeologjike kemi nxjerrë njëqindtë të dhëna në lidhje me stolitë ilire. E parë në shtrirje gjeografike në ato territore ku shtriheshin ilirët, stolitë janë pak a shumë të ngjashme, si për nga forma, ashtu edhe nga dekorit. Në vazhdim do të përmendim disa nga elementet që përbënin stolit ilire. Fibulat janë përdorur për kapjen e rrobave. Kemi disa lloje të fibulave, si fibulat gjyzykore e përbërë nga gjilpëra dhe dy disqe spirale, fibulat harkore, fibulat konike, fibulat me trajtë kafshësh, fibulat latene, etj. Stoli shumë e përhapur ishin edhe varëset, të cilat dekoroheshin me elemente gjeometrike por edhe zoomorfe. Rrathët koncentrik, apo spirala dominojnë si dekorë, por kemi edhe paraqitje të figurave tjera gjeometrike, svastikës (që simbolizonte diellin), e figurave antropomorfe e zoomorfe si pjesë e dekorit. Sigurisht që përveç karakterit praktik, e dekorues, disa nga këto stoli kanë pasur edhe karakter religjioz. Këtu veçojmë ‘priftëreshën Pajone’, Trebenishtin, etj. Stolitë mashkullore, dallohen nga ato femërore. Si stoli mashkullore më së shumti kemi fibula, kapëse, togëza rripi, etj., ndërsa stolit femërore kemi më shumë si: fibula, kapëset, paftat, rruazat, varëset, byzylykët, qaforet, unazat, vathët, tokëzat, etj. Vërehet se ilirët u kanë kushtuar shumë rëndësi detajeve të stolive, sepse përveç bronzit e hekurit, kemi stoli të arit e argjendit, e që të gjitha janë të dekoruara në forma e mënyra të ndryshme.

Dëshmi arkeologjike

Menada

Menadat janë krijesa mitologjike të cilat e kanë shoqëruar Perëndinë Dionis gjatë ahengejeve të tij. Ato shpesh herë paraqiten afër Dionisit, duke vallëzuar. Deri më sot janë gjetur vetëm dy

menada në territorin tonë, njëra në Prizren e tjetra në Tetovë. Mendatat janë figurina prej bronzi, të cilat si duket kanë shërbyer si vegjë të ndonjë enë (krater) bronzi, ose kanë qenë të ngjitura në të si pjesë e dekorit.

Vrapuesja e Prizrenit

Vrapuesja e Prizrenit (*foto1*) aktualisht gjendet në Muzeun Britanik¹³⁸. Ku është paraqitur një figurë vajze që vrapon dhe duke e mbajtur fustanin e saj lartë në dorë, ajo ka të veshur xhubletë me palosje duke i rënë nga krahu i djathtë. Gjirin e djathtë e ka të zbuluar, flokët i bien paralel nga prapa¹³⁹. Vrapuesja e Prizrenit është datuar gjatë *periudhës arkaike* (shek. VI para Kr.¹⁴⁰).

Menada e Tetovës

Gjatë vitit 1933 në Tetovë (*foto2*) është gërmuar një varr i periudhës arkaike, ku përveç materialit të shumtë arkeologjik është gjetur edhe një figurinë bronzi (Menada). Menadën e Tetovës është e datuar gjatë *periudhës arkaike* (shek. VI para Kr.¹⁴¹).

Kjo menadë është më e bukur artistikisht dhe më shumë e stilizuar. Këtu paraqitet një femër me duart e ngritura lartë, me flokë të gjata, kaçurrele, të cilat i bien pas. Menada ka një diademë dhe mban të veshur një hiton dhe rrip¹⁴², sipër hitonit ka nebris (lëkurë panteri), e dekoruar me rrathë koncentrik si dhe me putrat e panterit që rijnëvarur si zbukurim.

¹³⁸Milot Berisha, Guida arkeologjike e Kosovës, 2012, fq.55

¹³⁹Po aty,

¹⁴⁰Edi Shukriu, Kosova Antike, Prishtinë 2004 fq. 53

¹⁴¹Светозар Радојчић, Менада из Тетова, *ГЛАСНИК СКОПСКОГ НАУЧНОГ ДРУШТВА XII* 1933, fq. 250, Иван Микулчић, Античките градови во Македонија -книга 8, Скопје 1999, fq. 126

¹⁴² Светозар Радојчић, Менада из Тетова, *ГЛАСНИК СКОПСКОГ НАУЧНОГ ДРУШТВА XII* 1933, fq. 245

Motivi Dardanës

Afër kalasë së Dardanës (Kamenicë) – Kosovë, në shpatin jugor të saj gjatë punimit të tokës është gjetur një relief guri (*foto.3*). Guri është i thyer në dy pjesë, ku në të dyja pjesët kemi paraqitje të figurave njerëzore. Në pjesën e sipërme paraqitet një ritual mortor, ku i vdekuri është i shtrirë, ndërsa anësh ka gra e burra, e kafshëqë e përcjellin. Duket se burrat janë veshur me pantallona, ndërsa gratë me fustane. Ndërsa pjesa e poshtme e gurit, paraqet një kornizë të kufizuar me një shkrim, ndërsa pjesa tjetër paraqitet një njeri duke pirë nga briri i një kafeje, një enë (amforë) dhe një palë veshmbathje (opinga). Për datimin e këtij reliefi janë dhënë disa mendime: Sipas Edi Shukriut datohet gjatë *periudhës klasike–helenistike* (shek. V–III para Kr¹⁴³), ndërsa E. Dobruna–Salihu mendon se i takon *periudhës Romake*¹⁴⁴. Ekspeditat që i ka ndërmarrë Instituti Arkeologjik i Kosovës këto vitet e fundit, kanë dëshmuar që ky vendbanim ka vazhduar të banohet edhe gjatë periudhës klasike dhe helenistike, kjo e dëshmuar edhe nga materialet e importit të periudhave të lartcekura¹⁴⁵.

Varret e Trebenishtit

Gjendet në afërsi të qytetit të Ohrit, në regjionin e Lynhidit antik. Janë gërmuar shumë varre me shumë material të pasur arkeologjik gjithsej 825 objekte arkeologjike¹⁴⁶. Edhe pse në thelb nuk kemi të bëjmë me veshje si dukuri në këtë nekropolë, qëllimi ynë është t'i

¹⁴³ Edi Shukriu, *Ancient Kosova*, 2018 fq. 25

¹⁴⁴ Exhlale Dobruna-Salihu, *Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake*, Prishtinë 2005, fq. 798-799

¹⁴⁵ Grup autorësh, *Harta Arkeologjike e Kosovës III*, Prishtinë 2017, fq. 245 (*Pjesë e këtyre gërmimeve ka qenë edhe Sali Islami*)

¹⁴⁶ Паско Кузман, *Архајскиот период во Македонија, МАКЕДОНИЈА милениумски културно-историски факти*, Скопје 2013, fq. 433

përmendim disa stoli ari dhe argjendi që janë gjetur nëpër varre. Si fjala vjen: vathë, unaza, santaleone, fibula, tokëza, pafta, kopse, byzylyk, maskat e arit, doraza e arit, sandalet e arit, e shumë objekte arkeologjike, që janë një tregues i rëndësishëm për karakterin dhe rolin e të vdekurve. Për datimin e kësaj kulture janë dhënë shumë mendime por që të gjithë janë dakord se kulmin e zhvillimit e ka pasur gjatë shekujve VI–V para Kr¹⁴⁷, pra gjatë *periudhës arkaike*.

Priftëresha pajone

Bëhet fjalë për një varr të *periudhës së Hekurit të zhvilluar* (shek. VII para Kr.), i gërmuar në lokalitetin Llisiçin dol të Valandovës, në të cilin ka qenë e varrosur një grua (priftëreshë) e shoqëruar me rreth 400 objekte bronzi¹⁴⁸. Quket priftëreshë sepse në varrin e sajë përveç shumë elementeve që janë përdorur në nevojat ditore të sajë, kemi edhe disa objekte bronzi, karakteri i të cilëve lidhet me kult, apo rite. Në këtë varrë janë gjetur vathë, fibula gjyslykore, qafore, byzylyk, enë qeramike atj. Me rëndësi janë objektet tjera që janë gjetur në këtë varrë dhe që tregojnë për karakterin dhe rolin e gruas së vdekur që ka pasur në shoqëri si: pllaka e bronzit që është gjetur mbi barkun e sajë, rripi me shumë pulla dhe shumë objekte tjera të bronzit e që duhen të kenë vetëm karakter kulti, prandaj mendohet se kemi të bëjë me ndonjë priftëreshë¹⁴⁹.

¹⁴⁷ Mixhait Polozhani, Aspektet estetike të maskave prej arit të Trebenishtit, *Iliria dhe Ilirët (konferencë shkencore ndërkombëtare 2009)*, Prishtinë 2018, fq. 75

¹⁴⁸ Никос Чаусидис, A “Priestess from Marvinci” or a “Harnessed Wife”? Semiotics of the Iron Age Cheek-Pieces from the Group of “Macedonian Bronzes” / „Свештеничка од Марвинци” или „впрегната сопруга”? За семиотиката на железнодобните псалии од кругот на „македонските бронзи”, *Poznańskie Studia Slawistyczne 13*, Poznań 2017, fq. 338

¹⁴⁹ Драги Митревски, Гробот на пажонската свештеничка од Марвинци-прилог кон вреднување на пажонската религија на железното време-, *Macedoniae acta archaeologica 15*, Скопје 1996-97, fq. 79

Varret e Likovës

Në vendin e quajtur Uji Thartë në fshatin Likovë, janë kryer disa fushata arkeologjike. Në vitin 1957 rastësisht zbulohen tri varre, pastaj gërmime janë ndërmarrë në vitin 1963, 1968 dhe 1998, nga të cilat kemi fare pak të dhëna. Duke mos harru faktin që nga tetë mumiet e gërmuara, shtatë prej tyre nuk u dihet fati. Edhe pse kjo temë kërkon trajtesë të veçantë, ne do të përmendim shumë shkurt veshjen e një mumie që është gjetur në fshatin Likovë gjatë viteve 1963. Këtu do t'i referohemi dy artikujve të Ivan Mikulçiqit. Bëhet fjalë për një trup burri, i veshur me një këmishë pëlhure me ngjyrë të kaltër, me jakë të kuqe dhe pantallona të shkurta prej kërpi¹⁵⁰. Ndërsa në artikullin tjetër ai përmend se kjo mumie ishte e veshur me këmishë liri dhe brekë të gjata¹⁵¹. Sa i përket datimit, I. Mikulçiq e daton gjatë *periudhës klasike* (shek. V–IV para Kr.). Si do që të jetë, vetëm një mumie sot gjendet në objektin e Mjekësisë Ligjore në Shkup dhe se akoma askush nuk është marrë me të.

Përfundimi

Ilirët u kushtonin shumë rëndësi veshjes. Edhe pse nuk kemi shumë dëshmi arkeologjike të veshjes, kemi mbajtur dëshmi të stolive dhe gjërave që u vendoseshin rrobave. Detajet, stilizimi, motivet e shumë elemente tjera na bëjnë që të kuptojmë që Ilirët, si pjesë identifikuese të tyre i kishin edhe stolit. Natyrisht që një pjesë e këtyre stolive kishte karakter kulti, përveç efekteve praktike.

¹⁵⁰ Иван Микулчиќ, Кисела вода, Липково, праисториска некропола, *Археолошки преглед* 5, Београд 1963, fq. 54

¹⁵¹ Иван Микулчиќ, Античките градови во Македонија – книга 8, Скопје 1999, fq. 127

Nuk ka një unifikim të veshjes ilire, për vet faktin që kontaktet me kulturat e fiset tjera, ka bërë që të kemi shumë elemente të huazuara, e të importuara, sidomos pas pushtimit romak të Ballkanit. Por që në kontekstin e përgjithshëm, i gjithë territori ku janë shtrirë fiset ilire, padyshim që ka dhënë shumë elemente të përbashkëta të veshjes ilire. Dhe me të drejtë themi se disa tipe të stolive janë tipike për ilirët. Veshja dhe stoli sikur edhe sot, duket se ka treguar diferencim shoqëror. Kemi varre që janë shumë të pasura (Trebenisht) me stoli të të vdekurit, ku tregon që kemi të bëjmë me ndonjë pari ose udhëheqësi, dhe kemi raste ku varret janë shumë të varfra të shoqëruar me ndonjë stoli të thjeshtë. E përmendëm që veshjet ilire kanë ndryshuar edhe ato ndërmjet burrave dhe grave. Gratë janë veshur më bukur dhe më me stil e shije. Disa veshje janë trashëguar tek shqiptarët si: qeleshja-plisi, i cili edhe sot akoma përdoret nëpër vise të ndryshme ku jetojnë shqiptarët, guna, fustanela, etj. Poashtu edhe motivet e dekoreve e që dominojnë rrathët koncentrik, dielli, gjarpri, etj., janë elemente që akoma përdoren ndër shqiptarët. Për të bërë lidhje ndërmjet ilirëve dhe shqiptarëve nuk mundemi të mos e përmendim arbit, e konkretisht kulturën e Komanit. Një lokalitet arkeologjik në Shqipëri i *mesjetës së hershme* shek. VI–IX., ku përveç mënyrës dhe llojit të varrimit, aty ka edhe shumë elemente që janë trashëguar nga ilirët, si fibulat, varëset me trajtë shpezësh, byzylykët me kokë gjarpri, gjarpri si kult, etj. E duke e marrë për bazë kulturën e Komanit, si pikë reference për periudhën Mesjetare, gjetjet arkeologjike të kësaj periudhe janë të ngjashme apo edhe njëjtat si në Kosovë (Matiçan), si në Maqedoni (Sveti Erazmo, Ciganski Grobishta, etj.), pra në të gjithë hapësirën ku shtriheshin ilirët–arbit. Për ta përmbyllur mundë të themi që ato pak objekte arkitektonike, si dhe gjetjet tjera arkeologjike që janë gjetur nëpër

viset ilire na ndihmojnë që të krijojmë një pasqyrë (edhe pse në këtë fazë shumë të dobët), të veshjes së ilirëve.



Foto1. Vrapuesja e Prizrenit



Foto 2. Menada e Tetovës



Foto 3. Motivi i Dardanës (E nxjerrë nga Harta Arkeologjike e Kosovës III)




Foto 4. Trebenisht, varri VI,
(sipas Fillow 9, fig.8).




Foto 5. Trebenisht, Varri VIII,
(sipas Bynuň 1932, 7, figura. 3).



Foto 6. Dy nga pesë maskat e arit, të gjetura në Trebenisht (nxjerrur nga interneti).



Foto 7. Rikonstruim i varrit të priftëreshës pajone (foto nga ekspozita arkeologjike në Muzeun arkeologjik të Maqedonisë së Veriut)




Foto 8. Priftëresha pajone, varri 15 rikonstruim
(sipas Kilian-Dirlmeier-2012-173-Abb-75)



Foto 9. Mumia e Likovës, e zbuluar në vitin 1957. Gjendet në Institutin për Mjekësisë Ligjore. (Foto e nxjerrur nga interneti)




Foto 10. Modele veshje nga kultura ilire e Matit dhe kultura Arbërore
(sipas Sekender Anamalit)

Literatura e shfrytëzuar:

- Berisha Milot, *Guida arkeologjike e Kosovës*, Prishtinë, 2012
- Dobruna–Salihu Exhlale, *Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake*, Prishtinë 2005
- Grup autorësh, *Harta Arkeologjike e Kosovës III*, Prishtinë 2017
- Polozhani Mixhait, *Aspektet estetike të maskave prej arit të Trebenishtit*, Iliria dhe Ilirët (konferencë shkencore ndërkombëtare 2009), Prishtinë 2018
- Rendic–Miocevic Duje, *Anticki reljef plesaca is Zaostroga u Dalmaciji*, Tkalciëv zbornik 1, Zagreb 1955
- Rich Jun Anthony, B.A., *The Illustrated Companion to the Latin Dictionary and Greek Lexicon*, London 1849
- Sergejski Dimitrije, *Japodske urne*, Glasnik Zemaljkog muzeja–sveska 4–5, Sarajevo 1949–50
- Sergejski Dimitrije, *Spatantike Denkmaler aus Zenica*, Glasnik Zemaljkog muzeja 44, Sarajevo 1932

- Stipčević Aleksandar, *Ilirët, Historia, Jeta, Kultura, Simbolet e kultit*, Tiranë 2002
- Shukriu Edi, *Ancient Kosova*, Prishtinë 2018
- Shukriu Edi, *Kosova Antike*, Prishtinë 2004
- Wilkes John, *The Illyrians*, London 1996
- Кузман Паско, *Архајскиот период во Македонија*, МАКЕДОНИЈА милениумски културно–историски факти, Скопје 2013
- Митревски Драги, *Гробот на пајонската свештеничка од Марвинци – прилог кон вреднување на пајонската религија на железното време – Macedoniae acta archaeologica 15*, Скопје 1996–97
- Микулчиќ Иван, *Кисела вода, Липково, праисториска некропола, Археолошки преглед 5*, Београд 1963
- Микулчиќ Иван, *Античките градови во Македонија – книга 8*, Скопје 1999
- Радојчић Светозар, *Менада из Тетова*, Гласник скопског научног друштва XII, Скопје 1933
- Чаусидис Никос, *A “Priestess from Marvinci” or a “Harnessed Wife”? Semiotics of the Iron Age Cheek–Pieces from the Group of “Macedonian Bronzes” / „Свештеничка од Марвинци” или „впрегната сопруга”?* *За семиотиката на железнodobните псалии од кругот на „македонските бронзи”*, *Poznańskie Studia Slawistyczne 13*, Poznań 2017

BOTUES:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP

SCUPI, vëllimi 29 – 2020

Kryeredaktor: Sefer Tahiri
Përgjegjës i botimit: Sevdail Demiri
Redaktor teknik: Naser Fera

Shtypi: Focus Print – Shkup
Rr. Pellagonia 3 – Shkup

Tirazhi: 500 copë

*Ky edicion i SCUPI-t botohet me vendimin e Këshillit të
ITSHKSH-Shkup, nr. 0201-95/4, të datës 19.02.2020, si pjesë e
programit të punës së Institutit për vitin 2020.*

CIP - Katalogjizimi në publikim, gjendet në Bibliotekën Nacionale dhe Universitare
"Shën Klimenti i Ohrit" - Shkup